

Shpjegimi i 40 Haditheve të Imam Neueuiut dhe shtesës së Ibn Rexhebit.



د ت ف ي و ق ل ا ي ن ت ل م ا ف ي
ح ر ش ي ن ع ب ر ل ا

Titulli original: د ت ف ي و ق ل ا ي ن ت ل م ا ف ي ح ر ش ي ن ع ب ر ل ا

Autori: Shejkhu i nderuar ‘Abdul-Muhsin bin Hamed el-‘Abbad

Përktheu: Fatjon Isufi

Redaktoi: Sashenka Jaupi

Faqosja dhe kopertina: Rajan Alliu

Boton Qendra Islame “Udha e Besimtarëve” © www.udhaebesimtareve.com

Tiranë 2014

Përmbajtja:

Hadithi 01 - Veprat janë sipas qëllimeve

Hadithi 02 - Ardhja e Xhibrilit tek muslimanët për t'u mësuar çështjet e fesë së tyre.

Hadithi 03 - Islami është i ndertuar mbi pesë shtylla.

Hadithi 04 - Secili prej jush krijohet në barkun e nënës së tij.

Hadithi 05 - Kush shpik në fenë tonë çfarë nuk është prej saj, është e refuzuar.

Hadithi 06 - Hallalli është i qartë dhe harami është i qartë.

Hadithi 07 - Feja është këshillë.

Hadithi 08 - Jam urdhëruar që t'i luftoj njerëzit derisa.

Hadithi 09 - Çfarë ua kam ndaluar largohuni prej saj.

Hadithi 10 - Allahu është i mirë dhe nuk pranon diçka tjetër veç të mirës.

Hadithi 11 - Largoju të dyshimtës dhe përmbaju asaj që nuk është e dyshimtë.

Hadithi 12 - Nga Islami i mirë i njeriut.

Hadithi 13 - Nuk beson ndonjëri prej jush derisa të dojë për vëllain e tij atë që do për vete.

Hadithi 14 - Nuk lejohet gjaku i muslimanit përveç në tre raste.

Hadithi 15 - Kush i ka besuar Allahut dhe Ditës së Fundit le të flasë mirë.

Hadithi 16 - Mos u zemëro.

Hadithi 17 - Allahu e ka obliguar mirësinë në çdo gjë.

Hadithi 18 - Ki frikë Allahun kudo që të jësh.

Hadithi 19 - Ruaje Allahun që të të ruajë ty.

Hadithi 20 - Nëse nuk ke turp, bëj ç'të duash.

Hadithi 21 - Thauj: I kam besuar Allahut, dhe përmbaju kësaj.

Hadithi 22 - Si mendon nëse i fal pesë namazet dhe e agjëron Ramazanin.

Hadithi 23 - Pastërtia është gjysma e besimit.

Hadithi 24 - O Robërit e Mi! Unë ia kam ndaluar vetes padrejtësinë.

Hadithi 25 - Na i morën të pasurit të gjitha shpërblimet.

Hadithi 26 - Për çdo nyje të trupit duhet dhënë sadaka.

Hadithi 27 - Devotshmëria është morali i mirë.

Hadithi 28 - U porosis me devotshmëri dhe moral të mirë.

Hadithi 29 - Adhuroje Allahun duke mos i bërë shok asgjë.

Hadithi 30 - Allahu ka obliguar disa faerze, prandaj mos i lini pas dore.

Hadithi 31 - Mos lakmo në këtë dunja që të të dojë Allahu.

Hadithi 32 - Nuk duhet të ketë dëm për asnjërën palë.

Hadithi 33 - Pretenduesi duhet të sjellë fakte dhe dëshmi, ndërsa pala mbrojtëse mjaftohet me betim.

Hadithi 34 - Kush sheh një të keqe le ta ndryshojë me dorën e tij.

Hadithi 35 - Mos kini zili njëri tjetrit, mos u armiqësoni, mos u konfliktoni.

Hadithi 36 - Kush ia lehtëson një brengë vëllait të tij në këtë dunja.

Hadithi 37 - Allahu i ka ndarë të mirat dhe të këqijat.

Hadithi 38 - Kush e armiqëson një nga të dashurit e Mi, i kam shpallur luftë.

Hadithi 39 - Allahu ia ka falur umetit tim ato që bëhen nga gabimi dhe harresa.

Hadithi 40 - Të jesh në këtë dunja si i huaj apo udhëtar.

Hadithi 41 - Nuk beson dikush derisa dëshirat e tij të pasojnë sheriatin tim.

Hadithi 42 - O biri i Ademit! Per sa kohë që me lutesh dhe shpreson tek Unë.

Hadithi 43 - Jepini të drejtat atyre që u takojnë.

Hadithi 44 - Gjdhënia bën të ndaluar njësoj si nga gjaku.

Hadithi 45 - Allahu dhe i Dërguari i Tij e kanë ndaluar shitblerjen e alkoolit.

Hadithi 46 - Çdo pije dehëse është e ndaluar.

Hadithi 47 - S`ka mbushur biri i Ademit enë më të keqe se barkun e tij.

Hadithi 48 - Katër cilësitë e hipokritit.

Hadithi 49 - Sikur t`i mbeshteteshit Allahut me bindje të patundur.

Hadithi 50 - Të mos pushojë gjuha jote nga të përmendurit e Allahu.

Parathënie:

Falënderimet i takojnë vetëm Allahut për dhuratat e panumërta dhe mirësitë e plota! Dëshmoj dhe deklaroj se nuk ka të adhuruar të vërtetë, përpos Allahut, Ai është i Vetëm dhe i Pashok, i njohur për mirësinë dhe mëshirën e Tij! Gjithashtu, dëshmoj se Muhamedi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) është rob dhe i Dërguari i Tij, udhëheqësi i arabëve dhe i të huajve, njeriu që Allahu e veçoi dhe i zbriti fjalët përmbledhëse! O Zoti ynë, nderoj dhe begatoje familjen e tij, e cila shquhej për fisnikërinë, moralin dhe shokët që ndriçojnë si yjet errësirat. Ata që Allahu i nderoi, duke i bërë njerëzit më të mirë mes popujve. Këto, përshëndetje ia dërgoj çdokujt që erdhi pas tyre, ndoqi gjurmët e tyre dhe e pastroi zemrën nga çdo lloj mllëfi për besimtarët.

Ndër temat që kanë shkruar dijetarët në fushën e hadithit të Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) është edhe libri **“Dyzet hadithet.”** Në të vërtetë, libri është një përmbledhje, ku autori përmend dyzet hadithe të Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), e kjo, duke u bazuar në një hadith që është transmetuar për vlerën e të mësuarit përmendësh të dyzet haditheve nga Profeti.

Në parathënien e librit të tij **“Dyzet hadithet”**, shkrimtari përmend nëntë prej shokëve të Profetit, të cilët e përcillnin këtë hadith. Pasi rradhit emrat e tyre, citon: **“Dijetarët e hadithit janë të një mendimi se ai është hadith i dobët, edhe pse rrugët e tij të transmetimit janë të shumta.”**

Ai na rikujtoi se në shkrimin e librit të dyzet haditheve nuk ishte mbështetur mbi këtë hadith, por mbi disa hadithe të tjera, siç është hadithi i Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“Ai që është prezent, le t`ia përcjellë (fjalët e mia) atij që mungon”, apo fjala e Profetit që thotë: “Allahu ia ndriçoftë fytyrën atij njeriu që dëgjon një prej thënieve të mia dhe e kupton atë.”** Më pas, ai përmend trembëdhjetë prej dijetarëve që kanë shkruar dyzet hadithe, ku nga të

parët ishte Abdullah bin Mubarek dhe i fundit Ebu Bekr el Bejhaki. Pas përmendjes së tyre ai thotë: **“E shumë të tjerë, të cilët nuk mund të numërohen prej të parëve dhe të gjithëve që erdhën më pas.”**

Neveviu, më pas vijon: **“Disa dijetarë kanë mbledhur dyzet hadithe që flasin për bazat e fesë e disa të tjerë për çështje të dorës së dytë. Disa kanë mbledhur rreth Xhihadit, Zuhdit, moralit, e disa rreth hytbeve, por që të gjitha përmbajnë qëllime shumë të mira. Allahu qoftë i kënaqur me ata që kanë pasur këto qëllime! Ndërsa unë mendova të mbledh dyzet hadithet më të rëndësishme nga të gjitha çështjet që u përmendën sepse ato janë dyzet hadithe që i përmbledhin të gjitha çështjet e mësipërme. Çdo hadith përmban një rregull të madh të kësaj feje, e disa dijetarë kanë vlerësuar se Islami sillet rreth këtyre haditheve, apo se janë gjysma, apo një e treta e Islamit etj. U kujdesa që këto dyzet hadithe të ishin të sakta dhe numri më i madh i tyre gjendet në Sahihun e Buhariut dhe Muslimit. Ato i kam përmendur pa zinxhire transmetuesish, me qëllim që të lehtësohet mësimi i tyre përmendësh dhe dobia të jetë më e madhe në dashtë Allahu! Kushdo që e kërkon ahiretin duhet t’i mësojë këto hadithe dhe çështje të domosdoshme, po ashtu edhe disa çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me adhurimet e që janë të dukshme për cilindo që mediton rreth tyre.”**

Hadithet që mblodhi Neveviu (RahimehUllah) janë dyzet e dy hadithe, por ai i quajti dyzet, për të përmendur numrin më të madh dhe në formë përmbledhese. Ky libër, bashkë me **“Rijadu es Salihin”** ka hasur një pranim të pazakontë tek njerëzit. Këto hadithe patën një popullaritet të madh dhe njerëzit tregonin kujdes të madh për to. Mund të them se libri i parë që të vjen nëpër mend e që i udhëzon fillestarët në kërkimin e hadithit, janë këto dyzet hadithe të Neveviut (RahimehUllah). Këtyre haditheve Ibn Rexheb el Hanbeli (RahimehUllah), u shtoi edhe tetë hadithe, të cilat konsiderohen prej fjalëve përmbledhëse të Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Në këtë mënyrë, plotësoi numrin pesëdhjetë të haditheve. Ato i komentoi në një libër që e titulloi: **“Xhamiul ulumi uel hikem fi sherhi hamsine hadithen min xheuamiul kelim.”**

Komentet rreth këtij libri janë shtuar shumë. Ndër to ka me komente të shkurtra, por edhe të zgjeruara. Mund të them se komenti më i zgjeruar është ai i Ibn Rexhebit (RahimehUllah). Gjithashtu, komentet e këtyre haditheve dhe shtojcës së Ibn Rexhebit mendova t’i përmbledh në një komentim që i afrohet komentit të shkurtër, ku përmend hadithin në fraza e në mbyllje, si dhe moralin që nxjerrim nga hadithi. Në komentin tim të hadithit jam bazuar në

komentet e Neveviut, Ibn Dekik el Ijdit, Ibn Rexhebit, Ibn Utthejminit, librit Fet’hul Barit me autor Ibn Haxher el Askalanin. Atë e titullova: **“Fet’hul kaujil metin fi sherhi el erbain ue tetimetul hamsin li Neueui ue Ibn Rexheb”**, (RahimehUllah) Metin është emër i Allahut, të cilin e përmend Allahu në Kuran kështu: **“Vërtet, Allahu është Furnizuesi i vetëm, i Fuqishmi, i Plotpushtetshmi.”** (Suretu Dharijat, 58)

Që do të thotë i Fuqishmi, ashtu siç është komentuar në librat e tefsirit. Me këtë rast, unë i këshilloj nxënësit e dijes që t’i mësojnë përmendësh këto pesëdhjetë hadithe që vlerësohen si fjalë përmbledhëse e Profetit, (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i lutem Allahut të Madhëruar që ky koment të jetë i dobishëm, ashtu siç janë të dobishëm hadithet e tij. Vërtet Allahu i dëgjon lutjet dhe u përgjigjet atyre! Dhe në fund: Mëshira dhe bekimi i Allahut qofshin mbi robin dhe të Dërguarin e Tij, Muhamedin, familjen dhe gjithë shokët e tij!

01 - Veprat janë sipas qëllimeve.

Prijësi i besimtarëve Ebu Hafs Umer bin Hatabi (radijAllahu ‘anhu) transmeton se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) të ketë thënë: **“Veprat vlerësohen sipas qëllimeve, dhe çdo njeriu i takon ajo që ai ka patur për qëllim. Ndaj, kush shpërngulet (bën hixhret) për hir të Allahut dhe për të Dërguarin e Tij, atëherë edhe shpërblimin do ta ketë tek Zoti dhe i Dërguari i Tij. Ndërsa ai që shpërngulet për të fituar ndonjë të mirë të kësaj bote, apo të martohet me ndonjë grua, ai do të marrë atë shpëblim që ka patur për qëllim.”** Këtë hadith e transmetuan dy imamët e mëdhenj të hadithit Ebu Abdullah Muhamed bin Ismail bin Ibrahim bin Berdize el Buhari dhe Ebul Husejn Muslim bin Haxhaxh bin Muslim el Kushejri en Nejsaburi në dy Sahihët e tyre, të cilët konsiderohen si librat më të saktë të hadithit.

1 - Këtë hadith e transmetuan Buhariu, Muslimi, autorët e Suneneve **(Tirmidhiu, Ebu Daudi, Nesaiu dhe Ibn Maxheh)** etj. Për transmetimin e tij nga Omeri është veçuar Alkame bin Uekas el Lejthi, e prej tij e transmeton Muhamed bin Ibrahim et Tejmi, ndërsa në transmetimin prej tij është veçuar Jahja bin Seid el Ensari dhe më pas u shtuan transmetuesit që e përcollën prej tij. Ky hadith është prej haditheve Garibe **(Është hadithi që ka një transmetues të vetëm gjatë gjithë zinxhirit të transmetimit. Sh p)** në

Sahihun e Buhariut. Me të, Buhariu ka bërë hyrjen në librin e tij. I ngjashëm me të është edhe hadithi, me të cilin Buhariu mbyll Sahihun e tij. Është pikërisht hadithi që transmeton Ebu Hurejra: **“Dy fjalë janë shumë të dashura tek Mëshiruesi...”**, i cili është gjithashtu prej haditheve Garibe në Sahih.

2 - Neveviu librin **“Dyzet Hadithet”** i nisi me këtë hadith, madje një hapje të tillë u kanë bërë edhe dijetarët e tjerë librave të tyre. Një prej tyre është Buhariu, i cili Sahihun e tij e filloi me këtë hadith. Abdul Gani el Makdesi librin e tij **“Umdetul Ahkam”** e nisi me këtë hadith; Begaviu dy librat e tij të titulluar **“Mesabihu Suneh”** dhe **“Sherhu Suneh”** i nisi me këtë hadith. Gjithashtu, Sujuti librin e tij **“El Xhamiu sagir”** e hapi me këtë hadith. Ndërsa Neveviu në hyrjen e librit të tij **“El Mexhmu Sherh el Muhedheb”** (1/35) vendosi një temë dhe e titulloi: **“Temë rreth sinqeritetit, çiltërsisë dhe preokupimit me njetin (qëllimin), në të gjitha veprat e dukshme dhe të padukshme.”**

Në këtë temë, ai përmendi tri ajete nga Kurani Famëlartë dhe u bashkangjiti hadithin: **“Veprat vlerësohen sipas qëllimeve.”** Më pas pohoi: **“Ky është një hadith për saktësinë e të cilit është rënë dakord. Të gjithë janë të një mendimi për madhështinë dhe vendin e lartë që zë ai. E themi këtë sepse është njëri prej bazave të besimit, shtylla e parë dhe më e kërkuar.”** Shafi'u duke folur mbi këtë hadith ka thënë: **“Ky hadith përfshihet në shtatëdhjetë kapituj të Fikhut.”** Një herë tjetër, ai është shprehur kështu: **“Ai zë vendin e një të tretës së dijes”**, e fjalë të ngjashme kanë shprehur edhe të tjerë veç tij. Ai është njëri prej haditheve, rreth të cilit sillet feja Islame. Dijetarët kanë rënë në polemikë për numrin e këtyre haditheve, disa kanë thënë ato janë tri hadithe, e disa të tjerë kanë thënë katër, e të tjerë dy hadithe. Ka edhe disa që kanë thënë se është vetëm një hadith. Unë i kam mbledhur që të gjitha në një libër të veçantë me titull: **“Dyzet hadithet.”** Çdo musliman duhet patjetër që t'i njohë këto hadithe sepse të gjitha janë të sakta, esenca e të gjitha rregullave Islame, duke nisur nga çështjet bazë, degëzimet, asketizmin, mirësjelljen, moralin e lartë etj.

Unë e bëra hyrjen e librit tim me këtë hadith, duke marrë si shembull imamët dhe dijetarët tanë të hershëm (radij-Allahu 'anhum). Me këtë hadith e filloi imami i ehli hadithit Ebu Abdullah Buhari Sahihun e tij. E disa të tjerë përcollën se të parët tanë të mirë pëlqenin që librat e tyre t'i fillonin me këtë hadith, me qëllim që t'u mësonin nxënësve përmirësimin e njetit si dhe kërkimin e kënaqësisë së Allahut, me anë të punëve të dukshme dhe atyre që nuk duken. Transmetohet se imam Ebu Seid AbduRrahman bin Mehdi, (RahimehUllah) ka thënë: **“Nëse do të shkruaja një libër, çdo temë të tij do**

ta filloja duke përmendur këtë hadith.” Gjithashtu, transmetohet se ai ka thënë: **“Kush dëshiron të shkruaj një libër, le ta nisë me këtë hadith.”** Ndërsa imam Ebu Sulejman Hamed bin Muhamed bin Ibrahim bin El Hatab el Hatabi, njëri nga dijetarët Shafi, (RahimehUllah), në librin e tij **“El Mealim”** shprehet duke thënë: **“Mësuesve tanëmë të hershëm u pëlqente që t’i jepnin përparësi hadithit; “Veprat vlerësohen sipas qëllimeve” para fillimit të çdo gjëje që ka të bëjë me çëshjtet e fesë, duke u nisur dobia e përgjithshme për të, në të gjitha aspektet e fesë.”**

Ibn Rexhebi në librin e tij **“Xhamiul Ulumi uel Hikem”** (1/61) thotë: **“Dijetarët janë të një mendimi rreth saktësisë dhe pranimit të këtij hadithi.”** Buhariu me këtë hadith bëri hapjen e librit të tij **“Sahihul Buhari”** dhe e vendosi si parathënie, për të treguar se çdo punë me të cilën nuk synohet arritja e kënaqësisë së Allahut, ajo është e dështuar dhe nuk vlen as për në këtë botë e as për në botën tjetër.”

3 - Ibn Rexhebi ka thënë: **“Ky është njëri nga hadithet, rreth të cilit sillet e gjithë feja.”** Transmetohet se Shafi ka thënë: **“Ky hadith është një e treta e dijes dhe përfshihet në shtatëdhjetë kapituj të Fikhut.”** Ndërsa imam Ahmedi ka thënë: **“Bazat e Islamit janë të ndërtuara mbi tri hadithe: Hadithin e Omerit; “Veprat vlerësohen sipas qëllimeve”, hadithin e Aishes; “Kush shton në fenë tonë diçka që nuk është prej saj ajo është e refuzuar”, si dhe hadithin e Numan bin Beshirit; “Hallalli është i qartë dhe harami është i qartë.”** Në një pjesë tjetër (1/71), Ibn Rexhebi, duke komentuar fjalën e Imam Ahmedit thotë: **“E gjithë feja kthehet në praktikimin e urdhërave, braktisjen e të ndaluarave dhe distancimin nga të dyshimtat.”**, çështje të cilat i ka përfshirë hadithi i Numan bin Beshirit. Por e gjithë kjo realizohet vetëm duke pasur parasysh dy gjëra.

E para: Kur puna në pamje të jashtme duket në përputhje me Sunetin, gjë të cilën e përfshiu hadithi i Aishes që thotë: **“Kush shton në fenë tonë diçka që nuk është prej saj ajo është e refuzuar.”**

E dyta: Kur puna në thelb bëhet për të kërkuar kënaqësinë e Allahut të Madhëruar, ashtu sikurse u sqarua në hadithin e Omerit; **“Veprat vlerësohen sipas qëllimeve.”**

Pas kësaj, Ibn Rexhebi (1/61-63) transmetoi fjalët e disa prej dijetarëve që flasin për hadithet rreth të cilave sillet Islami dhe se prej tyre ka pasur nga ata që kanë thënë: **“Ato janë dy hadithe”,** e të tjerë që kanë thënë **“janë katër hadithe”,** ka pasur edhe të tjerë që kanë pretenduar që janë pesë. Hadithet që ai tregoi, duke i shtuar dhe tri hadithet e mësipërme, janë: **“Vërtet, çdonjëri**

nga ju formohet në mitrën e nënës së tij...”, gjithashtu hadithi; “Prej Islamit të mirë të një njeriu është t’i lërë gjërat që nuk i interesojnë”, hadithi; “Allahu është i Mirë dhe nuk pranon vetëm se të mirën!”, hadithi: “Nuk beson asnjë nga ju, derisa të dojë për vëllanë e tij atë që do për vete”; hadithi: “Nuk lejohet të dëmtosh veten apo të tjerët!”, hadithi: “Kur t’ju urdhëroj për diçka, praktikojeni sa të keni mundësi!”, hadithi: “Mos i kushto rëndësi (kënaqësive) kësaj bote që të të dojë Allahu, gjithashtu mos i kushto rëndësi asaj që njerëzit posedojnë me qëllim që të të duan njerëzit”; si dhe hadithi: “Feja është këshillë.”

4 - Për fjalët e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“Veprat vlerësohen sipas qëllimeve”**, thuhet se trajta e shquar e fjalës **“veprat”** ka për qëllim vetëm veprat që të afrojnë tek Allahu. Por, disa të tjerë kanë thënë se kjo fjalë është përmbledhëse për çdo punë, kështu që, për çdo vepër që të afron tek Allahu praktikuesi i saj shpërblehet dhe çdo vepër tjetër që përfshihet tek nevojat e përditshme si; të ngrënët, të pirët, të fjeturit etj., njeriu mund të shpërblehet nëse ka për qëllim që të forcohet për kryerjen e adhurimeve.

Nijet në gjuhën arabe do të thotë qëllim. Nijeti përdoret për të bërë dallimin e adhurimeve mes njëra- tjetrës, siç është dallimi i farzeve nga njëri-tjetri, si dhe farzit nga nafilet. Nijeti, gjithashtu, vlen për të bërë dallimin ndërmjet adhurimeve dhe nevojave, siç është rasti i marrjes së gusulit nga xhunubllëku, apo marrjes së gusulit që bëhet për freskim apo pastrim.

5 - Për sa i përket fjalëve të Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“...ai do të marrë atë që ka patur për qëllim”**, Ibn Rexhebi (1/65) thotë: **“Me këtë ai na tregon se njeriu përfiton nga puna e tij vetëm atë që ka pasur për qëllim. Nëse ka patur për qëllim të mirën, atëherë do fitojë çdo të mirë, por nëse ka patur për qëllim të keqen, atëherë do fitojë çdo të keqe. Kjo fjali nuk është përsëritje e mirfilltë e fjalisë së parë, sepse fjalia e parë pohon se: saktësia apo pasaktësia e një pune varet nga nijeti që e shoqëron atë. Ndërsa fjalia e dytë pohon se; shpërblimi i një punëtori për punën e tij të mirë varet tek nijeti i mirë dhe se ndëshkimi për punën e tij varet nga nijeti i tij i keq. Ndodh që nijeti dhe puna e tij të jenë të pëlqyeshme, por njeriu nuk merr shpërblime dhe as ndëshkime. Kështu që saktësia, pasaktësia apo lejueshmëria e punës, në thelb, varen nga nijeti, i cili e shtyn njeriun ta bëjë atë punë të pranishme. Ndërsa; shpërblimi, ndëshkimi dhe shpëtimi i një njeriu, varen përsëri nga nijeti, me të cilin ai e kthen punën në punë të mirë, të keqe apo thjesht të lejuar.”**

6 - Lidhur me fjalët e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“Prandaj, kush shpërngulet (bën hixhret) për hir të Allahut dhe për të Dërguarin e Tij, atëherë edhe shpërblimin do ta ketë tek Zoti dhe i Dërguari i Tij. Ndërsa ai që shpërngulet për të fituar ndonjë të mirë të kësaj bote, apo të martohet me ndonjë grua, ai do të marrë atë që ka patur për qëllim.”**

Hixhreti vjen nga fjala Hexhër që do të thotë braktisje. Hixhreti nënkupton braktisjen e vendeve ku zotëron frika dhe të shkuarit drejt vendeve ku zotëron siguria, ashtu siç ndodhi me muslimanët, të cilët u shpërngulën nga Meka për në Abisini. Hixhret quhet edhe shpërngulja nga vendet e kufrit, drejt vendeve Islame, siç ishte shpërngulja prej Mekës drejt Medines. Shpërngulja drejt Mekës ka përfunduar që në kohën kur u çlirua Meka, ndërsa shpërngulja prej vendeve të kufrit, drejt vendeve Islame është shpërngulje që do të mbetet deri në fundin e kësaj bote. Në fjalën e Profetit ku thuhet: **“Prandaj, kush**

shpërngulet (bën hixhret) për hir të Allahut dhe për të Dërguarin e Tij, atëherë edhe shpërblimin do ta ketë tek Zoti dhe i Dërguari i Tij.” u

bashkua kushti me shpërblimin edhe pse në origjinë ato duhet të ndryshojnë.

Kjo do të thotë se: Kushdo që shpërngulet për tek Allahu dhe i Dërguari i Tij, me nijet, atëherë shpërngulja e tij për tek Allahu dhe i Dërguari i Tij do ketë shpërblime, pra ka dallim. Ibn Rexhebi (1/72) thotë: **“Në kohën kur Profeti**

(sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) përmendi se: punët vlerësohen sipas nijeteve dhe se njeriu që punon do ketë për pjesë nga puna e tij nijetin e mirë apo të keq që ka pasur, - këto janë dy fjali dhe dy rregulla

përmbledhëse, jashtë të cilave nuk mund të dalë asgjë. Pas kësaj, ai

përmendi një shembull prej shembujve të punëve që kanë një paraqitje,

por që saktësia apo pasaktësia e tyre ndryshon sipas nijeteve. E kështu ai

duket sikur thotë: “Të gjitha veprat e tjera i bazohen këtij shembulli.”

Në një vend tjetër Ibn Rexhebi (1/73) citon: **“Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) lajmëroi se ky hixhret ndryshon me ndryshimin e nijeteve. Prandaj, kush shpërngulet drejt vendeve Islame, për shkak të dashurisë së Allahut dhe të Dërguarit të Tij, me dëshirën që të mësojë fenë Islame dhe për ta shfaqur atë lirshëm në një kohë kur nuk mundej ta shfaqte në vendet e kufrit, ky është muhaxhiri i vërtetë tek Allahu dhe i Dërguari i Tij. Atij i mjafton si nder dhe krenari realizimi i qëllimit që kishte në hixhretin e tij, i cili është shpërblimi që do gjejë tek Allahu dhe tek i Dërguari i Tij. Duke u nisur nga ky kuptim, ai u mjaftua me përmendjen e këtij kushti, duke mos e përsëritur me të njëjtat fjale, sepse arritja e synimit me anë të hixhretit është qëllimi final si në këtë botë ashtu dhe në botën tjetër.”**

Ndërsa ai që shpërngulet nga vendet e shirkut drejt vendeve islame, për të kërkuar kënaqësitë e kësaj bote, apo për t'u martuar me ndonjë grua në vendet islame, atëherë shpërngulja e tij është për atë qëllim që është shpërngulur. I pari konsiderohet tregëtar, ndërsa i dyti dhëndërr, por asnjëri prej tyre nuk mund të quhet muhaxhir.

Në fjalën e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) që thuhet: **"...ai do të marrë atë që ka patur për qëllim"**, vihet re përçmimi i asaj që ka kërkuar prej gjërave të kësaj bote sepse ai nuk e tregoi atë që ka fituar. Gjithashtu, shpërngulja për hir Allahut dhe të Dërguarit të Tij është diçka e mirfilltë, me të cilën nuk mund të përzihen gjëra të tjera. Kjo ishte edhe arsyeja që Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) e përsëriti përgjigjen në formë kushti. Shpërngulja për gjëra të kësaj bote nuk mund të kufizohet sepse nganjëherë, njeriu mund të emigrojë për të kërkuar diçka të lejuar nga kjo botë, apo të ndaluar në raste të tjera.

Gjithashtu, edhe personat tek të cilët njerëzit shpërngulen nuk mund të kufizohen, për këtë arsye Profeti në hadith tha: **"...ai do të marrë atë që ka patur për qëllim"**, d.m.th. kushdo qoftë ai.

7 - Ibn Rexhebi (1/74-75) thotë: **"Është përhapur shumë ndodhia e njeriut që emigroi për Umu Kajsin, për të cilin thonë se arsyeja e fjalëve që tha Profeti: "Ndërsa ai që shpërngulet për të fituar ndonjë të mirë të kësaj bote apo të martohet me ndonjë grua." Këtë e përmendën shumë prej dijetarëve të mëvonshëm në librat e tyre, por ne nuk kemi gjetur ndonjë origjinë me zinxhirë transmetuesish të saktë që ta pohojë atë, e për këtë Allahu e di më mirë."**

8 - Vendi i nijetit është zemra, ndërsa shqiptimi i tij është bidat **(risi)**. Nuk lejohet që nijeti të shqiptohet me zë në ndonjë adhurim, me përjashtim të Haxhit apo Umres. Në këtë rast njeriut i lejohet që gjatë telbijes (shprehjes që thuhet me rastin e hyrjes në ritet e Haxhit ose Umres) të shfaqë atë që ka për nijet, qoftë për llojet e Haxhit; Kiran, Ifrad ose Temetu dhe të thotë: **"O Zot, të përgjigjem Ty me Umre ose me Haxh"** - ose të thotë; **"Të përgjigjem me Haxh"**, ose të përgjigjem me Umre. E themi këtë sepse Suneti e ka pohuar vetëm në këtë rast dhe jo në adhurimet e tjera.

9 - Disa prej dobive që përfitojmë nga ky hadith janë:

1 - Nuk ka punë pa nijet.

2 - Punët merren në konsideratë sipas nijeteve.

3 - Shpërblimi i një njeriu për punën e tij varet nga nijeti i tij.

4 - Dijetari duhet të japë shembuj për arsye sqarimi.

5 - Vlera e hixhretit është vepër, të cilën e ka praktikuar edhe Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Në Sahihun e Muslimit me nr. 192 transmetohet nga Amër bin Asi se Profeti ka thënë: **“A nuk e di ti se Islami i fshin mëkatet e mëparshme, hixhreti i shkatërron mëkatet e mëparshme, dhe se Haxhi i fshin ato?”**

6 - Njeriu shpërblehet, dënohet dhe privohet nga ndonjë e mirë, për shkak të nijetit të tij.

7 - Veprat mund të ndryshojnë në varësi të nijeteve, për të cilat ato kryhen. Një vepër mund të jetë e lejuar në origjinë, por mund të kthehet në adhurim nëse njeriu e bën me nijet të mirë, të tilla si: të ngrënët apo të pirët, nëse ai me këtë ka për qëllim që të forcohet në kryerjen e adhurimeve.

8 - Një punë për një njeri mund të ketë shpërblim, ndërsa për një tjetër mund të jetë privim nga një e mirë.

02 - Ardhja e Xhibrilit tek muslimanët për t’u mësuar çështjet e fesë së tyre.

Gjithashtu Umeri (radijAllahu ‘anhu) transmeton: “Një ditë kur ishim ulur tek i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), papritur u shfaq një njeri me rroba shumë të bardha dhe flokë shumë të zinj. Në pamjen e tij nuk dukeshin shenja udhëtari dhe askush nga ne nuk e njihte. Ai u ul pranë Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), afroi gjunjët e tij me të Profetit, vendosi duart mbi gjunjët e tij dhe filloi ta pyeste: **“O Muhamed! Më trego çfarë është Islami?”** Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) u përgjigj: **“Islami është të dëshmosh se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Tij, të falësh namazin, të japësh Zekatin, të agjërosh muajin e Ramazanit dhe të vizitosh shtëpinë e shenjtë (Kaben), nëse ke mundësi”**. Njeriu i huaj tha: **“Të vërtetën the!”** Umeri (radijAllahu ‘anhu) tha: **“Ne mbetëm të habitur nga mënyra se si ai pyeste dhe vetë i miratonte fjalët e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).”** Më pas vazhdoi: **“Më trego**

çfarë është imani (besimi)? Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) tha: **“Të besosh Allahun, engjëjt e Tij, librat që Ai zbriti, profetët e dërguar, Ditën e fundit dhe të besosh Kaderin, qoftë i mirë apo i keq.”** Njeriu i huaj përsëri tha: **“Të vërtetën ke thënë!”** Pastaj pyeti: **“Më trego çfarë është ihsani?”** Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) tha: **“Ihsani është ta adhurosh Allahun sikur ti e sheh Atë sepse edhe pse ti nuk e sheh, Ai me të vërtetë të shikon ty.”** Njeriu i huaj tha: **“Më trego kur do të ndodhë Dita e Gjykimit?”** Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) iu përgjigj: **“I pyeturi nuk ka njohuri më shumë nga ai që pyet.”** Tha: **“Atëherë më trego për shenjat që lajmërojnë afrimin e saj.”** Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) tha: **“Do të ndodhë atëherë kur robëresha të lindë zotërinë e saj, dhe kur të shikosh barinjte e varfër, të zbathur e të leckosur, të cilët ndërtojnë ndërtesa të larta.”** Umeri (radijAllahu ‘anhu) vazhdoi të tregonte: **“Më pas, ky njeri u largua dhe pas një kohe të gjatë, Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) më tha: “A e di kush ishte ai që pyeste o Umer?”** Iu përgjigja: **“Allahu dhe i Dërguari i Tij e njohin më mirë.”** Atëherë Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) më tha: **“Ai ishte Xhibrili, erdhi t’ju mësojë fenë tuaj.”** Transmeton Muslimi.

1 - Në transmetimin e hadithit të Xhibrilit të transmetuar nga Umeri është veçuar Muslimi kundrejt Buhariut. Por transmetimet e tyre rreth këtij hadithi janë përputhur në kohën kur e transmetuan nga Ebu Hurejra. Imam Neveviu (RahimehUllah) librin e tij **“Dyzet hadithet”** e nisi me hadithin e Umerit **“Veprat vlerësohen sipas qëllimeve”**, i cili është hadithi i parë në Sahihun e Buhariut. Pas tij, shënoi përsëri hadithin e Umerit që tregon ardhjen e Xhibrilit tek Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), e që është hadithi i parë në Sahihun e Muslimit. Kështu veproi para tij edhe imam El Begavi, i cili dy librat e tij me tituj: **“Sherhu Suneh”** dhe **“Mesabihu Suneh”**, i filloi me këto dy hadithe. Këtë hadith e kam trajtuar në një koment të veçantë, i cili është shumë më i gjerë se komenti që do përmendim këtu.

2 - Ky është hadithi i parë në kapitullin e Imanit të Sahihut të Muslimit dhe atë e tregon Abdullah bin Umeri nga babai i tij. Transmetimi i këtij hadithi përmban një ndodhi, të cilën Muslimi e përmend para këtij hadithi nga Jahja bin Jamer, i cili transmeton duke thënë: **“Njeriu i parë që mohoi kaderin ishte Mabed el Xhuheni nga qyteti i Basras. Në atë kohë unë dhe Humejd bin AbduRrahman el Humejri u nisëm për Haxh ose për Umre.”** Atje i thamë njëri-tjetrit: **“Sikur të takonim ndonjë nga shokët e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe ta pyesnim për fjalët e këtyre njerëzve që flasin për kaderin. Rastësisht, aty hasëm Abdullah bin Umerin, i cili po hynte në xhami.”** Shkuam tek ai dhe e rrethuam një nga ana e djathtë dhe një nga e

majta. Unë e dija se shoku im do më linte mua të flisja, prandaj nisa ta pyjes: **“O babai i AbduRahmanit! Tek ne janë shfaqur disa njerëz, të cilët e lexojnë Kuranin dhe e kërkojnë dijen (dhe përmend shumë cilësi të tyre), por ata pretendojnë se nuk ekziston Kaderi dhe se Dija e Allahut nuk i përfshin punët që kanë për të bërë njerëzit në të ardhmen!”** Ibn Umeri (radijAllahu ‘anhu) kur i dëgjoi këto fjalë tha: **“Nëse të bie rasti t'i takosh ata njerëz, atëherë lajmëroi se unë jam larg nga mendimet e tyre dhe ata janë larg prej meje. Betohem në Allahun, se nëse ndonjë prej tyre ka një mal me flori sa ai i Uhudit dhe e jep lëmoshë, Allahu kurrë nuk do e pranojë këtë vepër, derisa ai të besojë në Kader.”** Më pas vazhdoi të tregonte: **“Babai im, Umer bin Hatabi, më ka treguar...”** - dhe tregoi hadithin për t'u argumentuar me të për besimin në Kader. Nga kjo ndodhi kuptojmë se risia **(bidati)** e mohimit të Kaderit për herë të parë u shfaq në Basra **(Qytet në Irak)**, në kohën e sahabëve dhe pikërisht në kohën e Ibn Umerit (radijAllahu ‘anhu), i cili ka ndërruar jetë në vitin 73H.

Gjithashtu mësojmë kujdesin që tregonin tabiinët për t'i pyetur shokët e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) në çështje që kanë të bëjnë me fenë, e kjo është shumë e domosdoshme që të kthehemi tek dijetarët në çdo kohë sepse Allahu i Madhëruar thotë: **“E nëse nuk dini, atëherë pyesni njerëzit e ditur.”** (Suretu Enbija, 7)

Mësojmë gjithashtu se bidati i Kaderive (mohuesve të paracaktimit të Allahut) është bidati më i keq, këtë e themi duke u bazuar në fjalët goditëse që tha Ibn Umeri për këtë bidat. Ndërsa kur myftiu përmend një gjykim, duhet që atij t'i bashkangjisë edhe argumentin përkatës.

3 - Hadithi i Xhibrilit pohon faktin se kur engjëjt vijnë tek njerëzit, shndërrohen në formën e njerëzve. Diçka e tillë është përmendur edhe në Kuran, p.sh.; ardhja e Xhibrilit (alejhis-selam) te Merjemja në formën e një burri, apo takimi që bënë engjëjt me Ibrahimin dhe Lutin (‘alejhimus-salatu ues-selam). Pra, ata me fuqinë që iu ka dhënë Allahu i Madhëruar kanë mundësi të ndryshojnë formën e tyre nga ajo engjëllore, në atë njerëzore.

Allahu i Madhëruar në Librin e Tij kur tregon për krijimin e engjëjve thotë: **“Falënderimet i përkasin vetëm Allahut, Krijuesit të qiejve e të tokës, Sajuesit të engjëjve me nga dy palë, tri palë dhe katër palë krahë. I zgjodhi ata si ndërmjetësues (ndërmjet njerëzve dhe Allahut). Ai shton në krijimin e Tij çfarë të dojë.”** Ndërsa në Sahihun e Buhariut me nr. 4 857 dhe të Muslimit me nr. 280, transmetohet se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e ka parë Xhibrilin të kishte gjashtëqind krahë.

4 - Nga ardhja e Xhibrilit dhe ulja e tij pranë Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), kuptojmë se si duhet të jetë morali i nxënësit të dijes me mësuesin e tij dhe se ai që pyet, nuk duhet të mjaftohet vetëm duke pyetur për gjërat që nuk ka njohuri. Përkundrazi, ai duhet të pyesë edhe për çështjet që mund t'i dijë shumë mirë, me qëllim që të pranishmit të përfitojnë nga përgjigja që do të jepet.

Për këtë arsye, Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) në fund të hadithit këtë mësim ia atribuon Xhibrilit, duke thënë: **“Ai ishte Xhibrili, erdhi t’ju mësojë fenë tuaj.”** Në të vërtetë mësimdhënia u krye nga Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), por iu atribua Xhibrilit sepse ai qe nxitësi për të dhënë atë mësim.

5 - **“O Muhamed, më trego çfarë është Islami!”**, Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) iu përgjigj: **“Islami është; të dëshmosh se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë, përveç Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij, të falësh namazin, të japësh Zekatin, të agjërosh muajin e Ramazanit dhe të vizitosh shtëpinë e shenjtë (Kaben), nëse ke mundësi.”**

Pyetjes së parë të Xhibrilit për Islamin, Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) i përgjigjet, duke përmendur veprat e dukshme të njeriut, ndërsa kur u pyet për imanin, Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) përmendi veprat e padukshme të njeriut.

Imani dhe Islami janë dy fjalë që kur përmenden së bashku, secila prej tyre merr kuptimin përkatës. Në këtë hadith Islami dhe Imani erdhën të radhitura dhe secila mori kuptimin e saj. Pra, Islami ka të bëjë me veprat e dukshme të njeriut dhe është shumë i përshtatshëm me kuptimin gjuhësor të tij, për shkak se Islam do të thotë: **“Dorëzim dhe bindje ndaj Allahut të Madhëruar.”** Ndërsa Imani merr kuptimin veprave të padukshme të njeriut, i cili është gjithashtu shumë i përshtatshëm me kuptimin gjuhësor të tij: **“Besim dhe pranim.”**

Islami dhe Imani mund të vijnë edhe të ndarë nga njëri tjetri, gjë që e bën secilin prej tyre të përmbajë kuptimin e tjetrit (d.m.th. veprat e dukshme dhe ato të padukshme). Ja një shembull konkret ku përmendet vetëm Islami; Allahu i Madhëruar thotë: **“E kush kërkon fe tjetër përveç Islamit, atij kurrsesi nuk ia pranojmë dhe në Ditën e Gjykimit ai mbetet i dështuar.”** (Suretu Ali Imran, 85)

Ndërsa shembulli që përmend vetëm Imanin është fjala e Allahut të Madhëruar: **“Ai i cili mohon imanin ka shkatërruar punën e tij dhe në Ditën e Gjykimit do të jetë nga të dështuarit.”** (Suretu Maide, 5)

Fjalë të ngjashme me këto **(Islamin dhe Imanin)** janë edhe: i varfëri dhe nevojtar, bamirësia dhe tekvaja **(devotshmëria)** etj.

Gjëja e parë me të cilën përmbledhet Islami është dëshmia: **“Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë, përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Tij.”** Këto dy dëshmi janë shumë të lidhura me njëra-tjetrën, prandaj kërkohet që ta pranojë çdo njeri apo xhind, duke filluar nga dita kur u dërgua si profet Muhamedi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), e deri në Ditën e Gjykimit. Ai që nuk beson në profecinë e Muhamedit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) do të jetë nga banorët e zjarrit. Argument për këtë është fjala e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) që thotë: **“Betohem në Atë, i Cili ka në dorë shpirtin tim, se çdo njeri, qoftë çifut apo i krishterë që dëgjon për mua dhe vdes, duke mos i besuar profecisë me të cilën u dërgova, ai do të jetë nga banorët e zjarrit.”** (Transmeton Muslimi me nr. 240)

Fjala **“LA ILAHE ILA ALLAH”** do të thotë: **“Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut.”** Kjo fjali është e ndërtuar nga dy pjesëza: njëra shpreh mohim të përgjithshëm në fillim të fjalisë **“LA ILAHE”** dhe tjetra pohim të veçantë në fundin e saj **“ILA ALLAH”.** Që do të thotë se te pjesa e parë mohohet çdo adhurim që i kushtohet dikujt tjetër përveç Allahut, ndërsa pjesa tjetër pohon vetëm adhurimin që i bëhet Allahut, sepse vetëm Ai e meriton diçka të tillë. Nuk është e saktë të thuhet: **“Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut”** kjo për faktin se zotëra të kotë njerëzit kanë plot, por ajo që duhet të mohohet **(në këtë dëshmi)** është adhurimi i vërtetë, që duhet t`u mohohet të gjithëve përveç Allahut, dhe në të njëjtën kohë ky adhurim i vërtetë të pohohet vetëm për Allahun.

Kuptimi i pjesës së dytë të Shehadetit **“MUHAMEDUN RESULULLAH”** është ta duash Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) më shumë se çdo krijesë tjetër, t`i bindesh në gjërat që ai urdhëron dhe të largohesh nga gjërat që ndalon. Të besosh lajmet që sjell, qofshin për kohën e tij, për të ardhmen, apo për të tashmen, edhe nëse nuk shihen e arrihen, dhe ta adhurosh Allahun në përputhje me udhëzimin e tij.

Singeriteti në kryerjen e një vepre për hir të Allahut dhe pasimi i rrugës profetike, formojnë atë që quhet dëshmi: **“La ilahe ila Allah Muhamedun Resulullah.”**

Për këtë arsye, një vepër që të pranohet tek Allahu duhet të plotësojë dy kushte:

a) - të kryhet me singeritet për hir të Allahut,

b) - të kryhet në përputhje me Sunetin (**rrugën, traditën**) e të Dërguarit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem). Nëse një vepër nuk kryhet me sinqeritet për hir të Allahut, atëherë ajo refuzohet dhe tek Allahu nuk pranohet. Allahu i Madhëruar në Librin e Tij thotë: **“Ne do i kthehemi veprave që bënë ata dhe do i bëjmë ato hi e pluhur.”** (Suretu Furkan, 23)

Gjithashtu, në një hadith Kudsij (**të shenjtë**) Allahu I Madhëruar ka thënë: **“Unë jam më i panevojshmi për ortak. Prandaj kush kryen një vepër duke më shoqëruar ortak, Unë do ta braktis atë dhe ortakun e tij.”** (Transmeton Muslimi me nr. 2 985)

Nëse një vepër nuk kryhet në përputhje me rrugën e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), atëherë edhe kjo punë refuzohet. Argument është hadithi i Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) i cili thotë: **“Kush shpik në fenë tonë diçka që nuk i përket asaj, atëherë ajo vepër nuk pranohet (nga Allahu).”** (Transmeton Buhariu me nr. 2 698)

Ndërsa në versionin që transmeton Muslimi, Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Kush bën një vepër që nuk përputhet me fenë tonë, ajo do t'i refuzohet.”** (Transmeton Muslimi me nr. 1 718)

Fjala e dytë është më përgjithësuese se e para sepse përfshin çdokënd që praktikon ndonjë bidat, pasi e ka shpikur vetë, gjithashtu edhe atë që e praktikon ndonjë bidat duke ndjekur dikë tjetër që e praktikon atë.

Rreth namazit, zekatit, agjërimit dhe Haxhit, do të flasim kur të përmendim hadithin e Ibn Umerit ku thuhet: **“Islami është i ndërtuar mbi pesë shtylla”**, radhitja e të cilit është menjëherë pas hadithit që po komentojmë.

6 - **“Të vërtetën the o Muhamed.”** Umeri tha: **“Ne mbetëm të habitur nga mënyra se si ai pyeste dhe në të njëjtën kohë miratonte fjalët e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem).”**

Kjo habi vjen duke qene se në shumicën e rasteve ai që pyet nuk e di përgjigjen e pyetjes sepse ai pyet për të arritur tek përgjigja. Si i tillë pyetësi nuk duhej që t'i miratonte përgjigjen: **“Të vërtetën the”** sepse tregon që pyetësi e di përgjigjen para se ta tregonte i pyeturi. Për këtë arsye, sahabët mbetën të habitur nga miratimi që bëri pyetësi, e që ishte i huaj.

7 - **“Më trego çfarë është imani (besimi)?”** Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) tha: **“Të besosh Allahun, engjëjt e Tij, librat që Ai zbriti, profetët e dërguar, Ditën e Fundit, si dhe të besosh kaderin, qoftë i mirë apo i keq.”**

Përgjigja e dhënë nga Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) përmbledh gjashtë shtyllat e besimit. Shtylla e parë dhe më e rëndësishmja është besimi në Allahun e Madhëruar. E themi këtë sepse të besuarit është baza e çdo besimi që duhet besuar, për këtë arsye bashkë me të u përmendën edhe besimi në engjëjt, librat dhe profetët. E ai që nuk beson te Allahu, ai nuk i ka besuar edhe shtyllave të tjera të besimit.

Besimi te Allahu përmbledh besimin në ekzistencën e Tij (**teuhidi rububijeh**), besimi i sigurtë se vetëm Ai meriton të adhurohet (**teuhidi uluhijeh**) dhe së fundi besimi në emrat dhe cilësitë e Tij (**teuhidi esma ue sifet**). Allahu është i cilësuar me të gjitha cilësitë e plota që i përkasin vetëm Atij, e nga ana tjetër është i Pastër nga çdo e metë. Për këtë arsye kërkohet që Allahu të njehet në rububijen, uluhijen, në emrat dhe cilësitë e Tij.

Njësimi i Allahut në teuhidin rububijeh, në kuptim më të gjerë do të thotë: të besosh se Allahu është i Vetëm në veprat që bën. Pra, Ai nuk ka ortak në atë që vepron p.sh.; në krijim, furnizim, në dhënien jetë apo vdekjen e krijesave, në kontrollin absolut të gjithësisë, e shumë çështje të tjera, të cilat kanë lidhje me rububijen e Tij.

Teuhidi uluhijeh do të thotë: Njësimi i Allahut në veprat e krijesave. Shembull për këtë lloj teuhidi është; lutja, frika, shpresa, të mbështeturit vetëm tek Allahu, kërkimi i ndihmës dhe mbrojtjes vetëm nga Ai, të bësh kurban dhe të zotohesh vetëm me emrin e Tij, e shumë adhurime të tjera, për të cilat kërkohet kategorikisht t’ia kushtojmë vetëm Atij. Në këtë mënyrë, asnjë prej adhurimeve nuk duhet t’i drejtohet dikujt tjetër veç Allahut të Madhëruar, edhe nëse ai është engjëll i afërt, apo profet i dërguar, e jo më për krijesa apo objekte.

Teuhidi esma ue sifet do të thotë: Të pohosh çdo gjë që Allahu ka pohuar për Vetën e Tij, apo atë që Profeti ka pohuar për emrat dhe cilësitë e Tij, në mënyrën që përshtatet dhe i përket përsosmërisë dhe madhështisë së Tij, pa i shëmbëllyer ato me të krijesave dhe pa i shtrembëruar, interpretuar apo mohuar. Duhet të kemi parasysh që Allahun ta veçojmë nga të gjitha gjërat që nuk kanë të bëjnë me Të, ashtu siç thotë Allahu i Madhëruar në librin e Tij: **“Asnjë send nuk i ngjan Atij, ndërsa Ai është Dëgjuesi, Shikuesi.”** Në këtë ajet Ai bashkoi mes pohimit dhe përsosmërisë. Pohimi vërehet në fjalën e Allahut që thotë: **“Ai është Dëgjuesi, Shikuesi.”**

Ndërsa përsosmëria vërehet në fjalën e Tij kur thotë: **“Asnjë send nuk i ngjan Atij.”**

Pra, Allahu i Madhëruar ka dëgjim dhe shikim që nuk ngjason me atë të krijesave. E njëjta gjë është për të gjitha emrat dhe cilësitë e pohuara për Allahun e Madhëruar.

Besimi tek engjëjt do të thotë të besosh se janë krijesa të Allahut të krijuara prej dritës, ashtu siç transmetohet në Sahihun e Muslimit se i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Engjëjt janë krijuar nga drita, xhindët nga zjarri, ndërsa Ademi është krijuar nga ajo që u është cilësuar (nga balta).”** (Transmeton Muslimi me nr. 2 996)

Ata janë të pajisur me krahë, ashtu siç është përmendur në ajetet e para të Sures **“Fatir”**, ndërkohë që Xhibrili (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) posedon gjashtëqind krahë, sikurse është saktësuar në një hadith të Profetit, të cilin e kemi përmendur më parë.

Engjëjt janë krijesa të panumërta. Numrin e tyre nuk e di askush përveç Allahut të Madhëruar. Ajo që e pohon këtë është se Bejtul Meamurin (**shtëpinë e shenjtë në qiell**) që ndodhet në qiellin e shtatë; **“e vizitojnë çdo ditë nga shtatë dhjetë mijë engjëj, të cilëve nuk iu bie më radha ta vizitojnë herë tjetër (për shkak të numrit të madh të tyre).”** (Transmeton Buhariu me nr. 3 207 dhe Muslimi me nr. 259)

Muslimi në Sahihun e tij transmeton nga Abdullah bin Mesudi (radijAllahu ‘anhu) se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Ditën e Gjykimit, Xhehenemi do të sillet me shtatëdhjetë mijë zinxhirë dhe në krye të çdo zinxhiri do të ketë shtatëdhjetë mijë engjëj që do ta tërheqin.”** (Transmeton Muslimi me nr. 2 842)

Engjëjt bëjnë punë të ndryshme. Disa janë të preokupuar me çështjet e shpalljes (**uahjit**), disa me çështjet e shiut, disa me ecurinë e foshnjës në mitrën e nënës dhe disa të tjerë me marrjen e shpirtrave, me Xhenetin dhe Zjarrin etj. Engjëjt janë të përlurur dhe të nënshtruar ndaj urdhërave të Allahut. Ata veprojnë sipas asaj që janë urdhëruar.

Në Librin e Allahut dhe në Sunetin e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) janë përmendur disa emra të engjëjve, p.sh.: Xhibril, Mikail, Israfil, Malik, Munker dhe Nekir. Është detyrë të besojmë në ekzistencën e engjëjve, si atyre që iu përmenden emrat, ashtu edhe atyre që nuk iu përmenden. Gjithashtu, është detyrë të besojmë çdo gjë që ka zbritur për ta në ajetet kuranore dhe hadithet profetike.

Të besosh në librat e Allahut do të thotë të pranosh dhe të besosh çdo libër të zbritur te profetët nga Allahu I Madhëruar. Madje, duhet të jemi të bindur se janë të vërtetë, janë Fjalë e Allahut dhe nuk janë të trilluar. Librat e Allahut përmbajnë gjithçka që është e nevojshme për t`u sjellë lumturi njerëzve **(popujve)** ku kanë zbritur ato libra. Ata që kapen fort pas tyre janë të sigurt dhe fitimtarë, ndërsa ata që nuk i zbatojnë kanë humbur dhe janë shkatërruar.

Disa nga këta libra janë përmendur e disa të tjerë jo. Librat që janë përmendur janë: Kurani, Teurati, Inxhili, Zeburi, fletushkat e Ibrahimit dhe Musait. Këto të fundit janë përmendur në dy vende në Kuran, në suren Nexhm (Në ajetin 36 - 37, ku Allahu i Madhëruar thotë: **“Vallë, a nuk ka dëgjuar ai për atë që thuhet në Shkrimet e Musait dhe të Ibrahimit - i cili i plotësoi detyrimet.”**) dhe Ala (Në ajetin 18-19, ku Allahu i Madhëruar thotë: **“Vërtet kjo këshillë gjendej edhe në broshurat e para. Në broshurat e Ibrahimit dhe të Musait.”**) Po ashtu, edhe Zeburi është përmendur në dy vende; në suren Nisa (Në ajetin 163, ku Allahu i Madhëruar thotë: **“Ndërsa Daudit i patëm dhënë Zeburin.”**) dhe Isra. (Në ajetin 55, ku Allahu i Madhëruar thotë: **“Prandaj Daudit i dhamë Zeburin.”**)

Teurati dhe Inxhili janë përmendur shumë herë në Kuran. Libri që është përmendur më shumë është Teurati, ndërkohë, edhe profeti që është përmendur më shumë është Musai (alejhis-selam). Libri që iu shpall Musait është përmendur me emra të ndryshëm, si p.sh.; Teurat, El Kitab **(libri)**, El Furkan **(dalluesi)**, Ed Dija **(drita)** dhe Edh Dhikr **(përkujtimi)**.

Prej gjërave që e dallojnë Kuranin nga librat e tjerë është se Kurani është mrekullia e përhershme, Allahu e ka marrë përsipër ruajtjen e tij, ai është i pastër nga cdo lloj shtrembërimi dhe se ka zbritur pjesë-pjesë.

Të besosh te profetët do të thotë; të pranosh dhe të jesh i bindur se Allahu i Madhëruar ka zgjedhur disa njerëz **(profetë)**, të cilët i udhëzojnë njerëzit në rrugën e drejtë dhe i nxjerrin ata nga errësirat në dritë.

Allahu i Madhëruar në Librin e Tij thotë: **“Allahu zgjedh të dërguar nga melaiket dhe nga njerëzit.”**

Në mesin e xhindëve nuk ka pasur profetë, por vetëm këshillues. Për këtë Allahu i Madhëruar në librin e Tij thotë:

“Përkujto kur disa xhindë i drejtuam te ti për të dëgjuar Kuranin dhe kur u afruan dhe e dëgjuan atë, I thanë njëri - tjetrit: **“Heshtni!”** Kur mbaroi u kthyen te populli i tyre dhe e këshilluan duke iu thënë: **“O populli ynë! Ne**

dëgjuam një libër të shpallur (të zbritur) pas atij të Musait, i cili e vërteton atë, udhëzon për në të vërtetën dhe për në rrugën e drejtë. O populli ynë! Përgjigjuni thirrësit të Allahut dhe besojini atij, sepse Allahu i fal mëkatet tuaja dhe ju shpëton nga dënimi i rëndë. Ai që nuk i përgjigjet atij që thërret për në rrugën e Allahut, ai nuk është i pamposhtur në tokë. Të tillët janë në humbje të qartë!” (Suretu Ahkaf, 29 - 32)

Në këtë ajet xhindët nuk përmendën ndonjë profet që të jetë dërguar prej tyre e as ndonjë libër, përkundrazi, ata përmendën dy libra të zbritur tek Musai dhe Muhamedi (‘alejhimus-salatu ues-selam). Ata nuk e përmendën Inxhilin, i cili ka zbritur pas Musait, kjo për shkak se shumë dispozita që përmenden në Inxhil janë të përmendura në Teurat.

Ibn Kethiri duke komentuar këto ajete thotë: **“Ata nuk e përmendën Isain sepse libri i shpallur tek ai përmban vetëm këshilla, morale dhe shumë pak ligje. Inxhili në të vërtetë është plotësim i Teuratit, pra baza është Teurati.”**

Për këtë arsye xhindët thanë: **“Ne dëgjuam një libër të shpallur pas atij të Musait.”**

Profetët e Allahut janë të urdhëruar për kumtimin dhe sqarimin e shpalljeve që u janë zbritur. Për këtë, Allahu i Madhëruar në Librin e Tij thotë: **“Ne i dërguam të Dërguarit tanë me dokumente të qarta dhe me ta zbritëm Librin dhe drejtësinë.”** (Suretu Hadid, 25) Libri i përmendur në ajet është emër i përgjithshëm dhe përfshin të gjithë librat. Profetët ishin ata që u urdhëruan të kumtojnë legjislacionin e një profeti para tyre, siç thotë Allahu i Madhëruar: **“Ne kemi dërguar Teuratin, në të cilin janë udhëzimet dhe drita. Sipas tij, profetët që ia kishin dorëzuar veten Allahut i gjykonin hebretjtë, por edhe të diturit dhe rabinët kështu vepronin sepse atyre iu qe besuar mbrojtja e librit të Allahut.”** (Suretu Maide, 44)

Ata e kyen më së miri detyrën që ju caktoi Allahu i Madhëruar sepse e kumtuan në formën më të mirë dhe më të plotë atë që u shpalli Allahu. Argument për këtë është fjala e Allahut që thotë: **“A mos kanë obligim tjetër të Dërguarit, përveç se t’i njoftojnë njerëzit qartë?”** (Suretu Maide, 99)

Gjithashtu, në një ajet tjetër thotë: **“E ata që nuk besuan vijnë grupe - grupe në Xhehenem dhe kur arrijnë aty dyert e tij hapen dhe roja i tij thotë: “A nuk u erdhën të dërguar nga mesi juaj, t’ju lexojnë shpalljet e Zotit tuaj dhe t’ju këshillojnë për ballafaqimin e kësaj dite?” Ata thonë: “Po, por vendimi për dënim bëhet realitet ndaj jobesimtarëve.”** (Suretu Zumer, 71)

Imam Zuhriu ka thënë: **“Allahu i Madhëruar zbret shpalljen e Tij dhe i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) është i detyruar ta kumtojë atë, ndërsa për ne nuk mbetet gjë tjetër vetëm se ta pranojmë.”** Këto fjalë, Buhariu i përmendi në Sahihun e tij bashkë me **“Fet’hul Barin”** (13/503) në kreun e Teuhidit dhe pikërisht në komentin e ajetit: **“O ti i dërguar, kumtoje atë që t’u zbrit nga Zoti yt, e nëse nuk e bën, atëherë nuk e ke kumtuar shpalljen e Tij.”**

Disa profetë janë përmendur me emra në Kuran, ndërsa disa të tjerë jo. Allahu i Madhëruar thotë: **“Dhe (dërguam) të dërguar më parë që të rrëfyem për ta, dhe të tjerë për të cilët nuk të rrëfyem.”** (Suretu Nisa, 164)

Profetët që janë përmendur në Kuran janë njëzet e pesë, tetëmbëdhjetë prej të cilëve janë përmendur në suren E’nam: **“Këto janë argumentet Tona që ia dhamë Ibrahimit kundër popullit të tij, Ne ngremë në shkallë të lartë atë që duam. Zoti yt çdo gjë e vë në vendin e vet dhe Atij asgjë nuk mund t’i fshihet. Ne atij (Ibrahimit) i falëm Is’hakun dhe Jakubin dhe secilin prej tyre e udhëzuam. Më parë edhe Nuhun e patëm udhëzuar. E nga pasardhësit e tij (Ibrahimit) udhëzuam Daudin, Sulejmanin, Ejubin, Jusufin, Musain dhe Harunin. Ne kështu i shpërblejmë bamirësit. Shpërblyem edhe Zekerian, Jahjan, Isain dhe Iljasin, të gjithë këta ishin prej të mirëve të përsosur. Shpërblyem edhe Ismailin, Eljesan, Junusin dhe Lutin dhe të gjithë këta i veçuam mbi njerëzit e tjerë.”** (Suretu E’nam, 83 - 86) Ndërsa shtatë të tjerët janë: Ademi, Idrisi, Hudi, Salihu, Shuajbi, Dhulkifli dhe Muhamedi (‘alejhimus-salatu ues-selam).

Besimi në Ditën e Gjykimit do të thotë: besimi dhe miratimi i çdo lajmi që është transmetuar në Kuran apo Sunet për gjërat që do ndodhin pas vdekjes. Allahu i Madhëruar ka përgatitur për njerëzit dy botë: botën në të cilën po jetojmë dhe botën tjetër. Ajo që i ndan këto dy botë nga njëra - tjetra është vdekja dhe fryrja e Surit, i cili do të vdesë çdo krijesë. Për çdo njeri që vdes është bërë Kiameti sepse ai është transferuar nga bota e veprave, në botën e shpërblimit.

Bota tjetër është e ndarë në dy pjesë: jeta në berzah (**varr**), e cila fillon me vdekjen dhe mbaron me ringjalljen e të gjithë njerëzve dhe jeta pas ringjalljes. Se çfarë do të ndodhë pas vdekjes dhe pas ringjalljes, askush nuk e di përveç Allahut të Madhëruar. Të gjitha këto bëjnë pjesë në jetën pas vdekjes dhe secila tregon për shpërblimet që njerëzit do marrin për veprat që kanë bërë. Kështu që njerëzit e lumtur do të shpërblehen në varre me kënaqësitë e Xhenetit, ndërsa të këqinjët do të dënohen me dënimet e zjarrit.

Besimi në botën tjetër përfshin dhe besimin në ringjalljen dhe tubimin e njerëzve para Allahut, besimi në ndërmjetësimin, haudin **(rezervuarin që Allahu i ka dhuruar Profetit sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem)**, llogarinë, peshimin e veprave, Siratin, Xhenetin, Xhehenemin, e shumë shpërblime të tjera që janë përmendur në Kuran dhe Sunet. Besimi në paracaktimin e Allahut do të thotë: Të besosh se Allahu ka paracaktuar çdo gjë që do të ndodhë deri në Ditën e Fundit.

Besimi në Kaderin e Allahut ka disa shkallë:

E para: Dituria e hershme e Allahut, e cila përfshin çdo gjë që do të ndodhë.

E dyta: Shkrimi i çdo gjëje që do të ndodhë në librin Leuhi Mahfudh, pesëdhjetë mijë vjet, para se Allahu të krijonte qiejt dhe Tokën.

E treta: Vullneti dhe dëshira e Allahut për çdo send që do të ndodhë.

E katërta: Krijimi i çdo gjëje me vullnetin e Allahut e që është në përputhje të plotë me atë që Ai di, të cilat i ka shkruar dhe e ka dashur ekzistencën e tyre.

Ndaj kërkohet që të besojmë në këto që u përmendën, duke pasur në mendje se çfarë do Allahu patjetër që ajo do të ekzistojë, ndërsa atë që nuk e do Allahu, kurrë nuk mund të ekzistojë. Kjo është në përputhje të plotë me fjalën e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) që thotë: **“Dije se ajo që nuk të ka goditur, nuk do të mund të të godiste, ndërsa ajo që të ka goditur nuk ka qenë e mundur të mos të të godiste”**, të cilin do e sqarojmë në hadithin e nëntëmbëdhjetë.

8 - Në fjalët e hadithit: **“Më trego çfarë është ihsani?”** Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) tha: **“Ihsani është ta adhurosh Allahun sikur ti e sheh Atë, sepse edhe pse ti nuk e sheh, Ai me të vërtetë të shikon ty.”** Ihsani është shkalla më e lartë, pas tij vjen imani e më pas Islami. Çdo besimtar është musliman, çdo Muhsin **(Në termin gjuhësor do të thotë: Bamirës, por në termin fetar ai merr kuptimin që i dha profeti me fjalët e tij: “Ihsani është ta adhurosh Allahun sikur ti e sheh Atë, sepse edhe pse ti nuk e sheh, Ai me të vërtetë të shikon ty.” Sh. p)** është besimtar dhe musliman, por jo çdo musliman mund të jetë besimtar dhe muhsin. Për këtë arsye në suren Huxhurat thuhet: “Arabët e shkretëtirës deklarojnë se: **“Ne besojmë.”** Thuaju: **“Ju nuk keni besuar! Por më mirë thoni: “Ne përulemi”, pasi besimi ende nuk ka hyrë (si duhet) në zemrat tuaja.”** (Suretu Huxhurat, 14)

Në hadith tregohet shkalla e lartë që gëzon ihsani, e pikërisht në fjalën e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“...ta adhurosh Allahun sikur ti e sheh**

Atë", që do të thotë: ta adhurosh Allahun sikur po qëndron para Tij dhe po e shikon Atë. Nëse njeriu e praktikon këtë gjë, adhurimi i tij do të jetë i rregullt dhe i plotë. Ndërsa ai që nuk e ndien diçka të tillë, le të mendojë se Allahu i Madhëruar po e shikon dhe kurrë nuk mund t'i fshehë Atij asgjë. Të ruhet që Allahu të mos e shohë në gjërat që ia ka ndaluar dhe të punojë për gjërat që Ai kërkon ta shohë në zbatimin e tyre.

9 - **"Më trego kur do të ndodhë dita e Gjykimit?"** Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) iu përgjigj: **"I pyeturi nuk ka njohuri më shumë se ai që pyet."**

Allahu i Madhëruar është i Vetmi që e di se kur do të ndodhë Kiameti, prandaj Ditën se kur do të ndodhë Dita e Gjykimit nuk e di askush tjetër përveç Allahut.

Allahu i Madhëruar në Librin e Tij thotë: **"S'ka dyshim se vetëm Allahu e di se kur do të ndodhë Kiameti. Ai e di kur e lëshon shiun dhe Ai di se çka në mitra. Askush nuk e di përveç Tij se çfarë mund t'i ndodhë nesër dhe se kur do të vdesë. Allahu është më i Dijshmi, më i Njohuri."** (Suretu Lukman, 34)

Gjithashtu thotë: **"Çelësat e fshehtësisë janë vetëm tek Ai dhe atë (fshehtësinë) nuk e di askush përveç Tij."** (Suretu Enam, 59)

Një nga këta çelësa është edhe Dita e Gjykimit. Argument për këtë është hadithi i Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) që thotë: **"Çelësat e fshehtësisë janë pesë..."** - dhe më pas lexoi ajetin e sures Lukman: **"S'ka dyshim se vetëm Allahu..."** (Transmeton Buhariu me nr. 4 778 nga Abdullah bin Umeri)

Dhe në një ajet tjetër Allahu i Madhëruar thotë: **"Të pyesin ty (Muhamed) për Kiametin se kur do të ndodhë."**

Thuaj: **"Atë e di vetëm Zoti im dhe momentin e tij askush nuk mund ta zbulojë përveç Tij."** Çështja e Kiametit është preokupim i rëndë në qiej dhe në tokë, e ai nuk u vjen ndryshe vetëm se befas. Të pyesin sikur ti di për të. Thuaj: **"Për të di vetëm Allahu, por shumica e njerëzve nuk e dinë (pse është e fshehtë)."** (Sutetu Araf, 187)

Është transmetuar në hadithet e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) se Kiameti do të ndodhë Ditën e Xhuma. Në çfarë viti, muaji, apo në cilën të Xhuma të muajit, nuk e di askush tjetër përveç Allahut të Lartësuar.

Ebu Daudi në Sunenin e tij transmeton nga Ebu Hurejra se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Dita më e mirë në të cilën lind dielli është dita e Xhuma. Në këtë ditë u krijua Ademi, në këtë ditë zbriti (nga Xheneti në tokë), në këtë ditë iu pranua pendimi, në këtë ditë ka ndërruar jetë dhe në këtë ditë do të bëhet Kiameti. Nuk ka asnjë kafshë që të mos frikësohet ditën e Xhuma; që nga koha kur hyn mëngjesi, e deri në lindjen e diellit, nga frika se mos ndodh Kiameti, me përjashtim të njerëzve dhe xhinëve, të cilët janë të vetmit që nuk frikësohen.”** (Transmeton Ebu Daudi me nr. 1 046 dhe Nesaiu me nr. 1 430. Hadithi është i saktë)

Ky hadith është i saktë dhe burrat që kanë transmetuar zinxhirin e tij kanë transmetuar në gjashtë librat e hadithit, duke përjashtuar Kanabiun, prej të cilit nuk ka transmetuar askush me përjashtim të Ibn Maxhes.

Fjalët e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“I pyeturi nuk ka njohuri më shumë se ai që pyet”**, do të thotë se krijesat nuk e dinë se kur do të ndodhë Kiameti dhe çdo njeri që pyet apo pyetet ndodhet në të njëjtën gradë njohurish dhe kurrsesi nuk kanë si ta dinë të fshehtë e saj.

10 - **“Atëherë më trego për shenjat që lajmërojnë afrimin e saj?”** Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) tha: **“Do të ndodhë atëherë kur robëresha të lindë zotërinë e saj dhe kur të shikosh barinjtë e varfër, të zbathur e të leckosur, të cilët do të ndërtojnë ndërtesa të larta.”**

Shenjat e Kiametit ndahen në dy grupe: Në grupin e parë bëjnë pjesë ato shenja që janë shumë afër kohës kur do të ndodhë Kiameti, p.sh.; lindja e diellit nga perëndimi, dalja e dexhalit, dalja e jexhuxhëve dhe mexhuxhëve, zbritja e Isait (alejhis-selam) nga qielli etj., ndërsa në grupin e dytë bëjnë pjesë ato shenja që do të ndodhin para shenjave që përmendëm, p.sh.; këto dy shenja që përmenden në hadith.

Kuptimin e tekstit: **“Atëherë kur robëresha të lindë zotërinë e saj”**, disa dijetarë e kanë komentuar me shtimin e robërshave të luftës, të cilat lindin fëmijë nga zotërinjtë e tyre. Ato, më pas, bëhen nëna të fëmijëve të tyre dhe këta fëmijë bëhen sikur të ishin zotërijtë e tyre. Kjo ndodh për shkak se ata e fitojnë lirinë, ndërsa nënat e tyre mbeten robëresha.

Disa të tjerë e kanë komentuar me ndryshimin që do të pësojnë njerëzit, deri në atë masë sa që fëmijët nuk do t’i respektojnë më prindërit, por do t’i shtypin dhe poshtërojnë, duke u sjellë sikur të ishin zotërijtë e prindërve të tyre.

Kuptimi i tekstit: **“Kur të shikosh barinjtë e varfër, të zbathur e të leckosur që bëjnë ndërtesa të larta”**, është se të varfërit (ata që nuk kanë të ardhura) dhe ata që ruajnë bagëtitë do të ndryshojnë (**do të pasurohen**). Ata do shpërngulen nga shkretëtirat për në qytete, madje do të ndërtojnë dhe pallate të larta.

Këto dy shenja që përmendëm janë realizuar.

11 - Fjalët në hadith: **“Më pas ky njeri u largua dhe pas një kohe të gjatë Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) më tha: “A e di se kush ishte ai që pyeste o Umer?” Thashë: “Allahu dhe i Dërguari i Tij e njohin më mirë.”** Atëherë Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) tha: **“Ai ishte Xhibrili, erdhi t’ju mësojë fenë tuaj.”** Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i lajmëroi shokët për njeriun e huaj menjëherë pas largimit të tij. Ndërsa Umerin (radijAllahu ‘anhu) thuhet se e ka lajmëruar pas tri ditëve. Kjo që përmendëm nuk bie në kundërshtim me hadithin, sepse kur Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) u tregoi shokëve që ishin të ulur aty, Umeri (radijAllahu ‘anhu) nuk ishte me ta, por ishte larguar menjëherë. Ai e takoi Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) pas tri ditëve dhe atëherë ai i tregoi se kush ishte njeriu i huaj që e kishte pyetur.

12 - Disa prej përfitimeve që kemi nga ky hadith janë:

1 - Njeriu që pyet për të mësuar, mund të pyesë edhe për të përfituar të tjerët, kështu ai mund të pyes për diçka që ka njohuri për të me qëllim që njerëzit të dëgjojnë përgjigjen.

2 - Engjëjt e ndryshojnë formën e tyre dhe paraqiten në forma njerëzish. Por kjo nuk e bën të lejuar atë që quhet sot teatër e që është përhapur në masë sepse ajo është lloj truku. Ndërsa ajo që i ndodhi Xhibrilit ishte me ndihmën dhe lejen e Allahut të Madhëruar.

3 - Në hadith pasqyrohen disa norma të nxënësit para mësuesit.

4 - Kur Islami dhe imani vijnë të renditura së bashku, atëherë Islami komentohet me gjërat e dukshme të njeriut ndërsa imani me gjërat e fshehta.

5 - Duhet të fillohet me gjërat më të rëndësishme, sepse Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e filloi me dy dëshmitë kur tregoi për Islamin, e gjithashtu e filloi me besimin në Allahun atëherë kur sqaroi imanin.

6 - Shtyllat e Islamit janë pesë ndërsa bazat e besimit janë gjashtë.

- 7 - Besimi, duke përfshirë gjashtë bazat e tij, përfshihet në besimin në të fshehtë.
- 8 - Në hadith sqarohet ndryshimi ndërmjet Islamit, imanit dhe ihsanit.
- 9 - Në hadith vërehet grada e lartë që gëzon ihsani.
- 10 - Koha se kur do të ndodhë Kiameti është një çështje, për të cilën vetëm Allahu ka njohuri.
- 11 - Në hadith tregohen disa prej shenjave të Kiametit.
- 12 - Ai që pyetet për diçka që nuk e di, duhet të thotë: **“Allahu e di më mirë.”**

03 - Islami është i ndërtuar mbi pesë shtylla.

Ebu AbduRrahman Abdullah bin Umer bin Hatabi (radijAllahu ‘anhu) transmeton se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) të ketë thënë: **“Islami është i ndërtuar mbi pesë (shtylla): Mbi dëshminë se nuk ka të adhuruar të vërtetë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut, mbi kryerjen e namazit, dhënien e zekatit, vizitën e Kabes dhe në agjërimin e muajit të Ramazanit.”** Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

1 - Fjala e Profetit që thotë: **“Islami është i ndërtuar mbi pesë (shtylla)”**, pasqyron vlerën e madhe që kanë këto shtylla dhe se Islami është i ndërtuar mbi to. Hadithi është një shprehje figurative e krahasur me një ndërtesë, sepse ashtu sikurse një ndërtesë, në të vërtetë, mund të qëndrojë vetëm se duke u mbështetur në shtyllat e saj, në të njëjtën mënyrë edhe Islami është i ngritur mbi këto pesë shtylla. Ai u mjaftua me përmendjen e pesë shtyllave sepse ato janë bazë, ndërsa të tjerat i ndjekin ato.

2 - Neveviu e renditi këtë hadith menjëherë pas hadithit të Xhibrilit, i cili i përmbante këto pesë thylla. Ai e bëri këtë për të treguar rëndësinë e këtyre pesë shtyllave dhe se ato janë bazat, mbi të cilat ngrihet Islami. Ndaj në hadith ekziston një përmbajtje shtesë, përtej asaj që u përmend në hadithin e Xhibrilit.

3 - Këto pesë shtylla, mbi të cilat është ndërtuar Islami nisin me dy dëshmitë që janë themeli bazë, ndërsa shtyllat e tjera janë të ndërrvarura dhe i ndjekin

ato. Këto shtylla, apo edhe vepra të tjera nuk vlejnë nëse nuk janë të ndërtuara mbi dy dëshmitë, të cilat janë të lidhura ngushtësisht me njëra-tjetrën. Për këtë arsye, kërkohet që njeriu të dëshmojë se Muhamedi është i Dërguari i Allahut, bashkë me dëshminë se nuk ka të adhuruar të vërtetë përveç Allahut. Ajo që kërkon dëshmia **“La ilahe ila Allah”** është që të mos adhurohet askush tjetër përveç Allahut. Ndërsa ajo që kërkon dëshmia **“Muhamedun Resulullah”** është që një adhurim duhet të jetë në përputhje të plotë me atë që solli i Dërguari i Allahut. Këto dy baza duhet të jenë gjithmonë të pranishme me qëllim që çdo vepër që kryen njeriu të pranohet, pra e përsërisim edhe një herë se kërkohet singëritet vetëm për Allahun dhe ndjekje e mirfilltë e traditës së të Dërguarit të Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

4 - Hafidh Ibn Haxheri në librin e tij **“Fet’hul Bari”** (1/50) thotë: **“Nëse dikush pyet se përse në hadith nuk është përmendur besimi tek pejgamberët, melaiket etj, ashtu siç i përfshiu hadithi i Xhibrilit (alejhis-selam), iu përgjigjemi se qëllimi i dëshmisë është pranimi i çdo gjëje që vjen nga Profeti, për këtë arsye kërkohet që të besojnë çdo gjë që është përmendur rreth besimit. Ismaili, në një fjalë të tij thotë: “Kjo përfshihet në atë që quhet emërtimi i diçkaje me një pjesëz të saj, siç mund të thuash: Lexova “Elhamin (Fatihanë)” dhe ke për qëllim të gjithë Fatihanë. E njëjta gjë thuhet p.sh.: Dëshmova për profetësinë e Muhamedit dhe ke për qëllim të gjitha ato që u përmendën. Allahu e di më së miri.”**

5 - Shtylla më e rëndësishme që renditet pas dy dëshmimeve është namazi. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e ka cilësuar atë si shtyllë të Islamit, siç është transmetuar në hadithin e porosisë që Profeti i jep Muadh bin Xhebelit (radijAllahu ‘anhu), i cili është hadithi i njëzetë e nëntë në renditjen e këtyre dyzet haditheve. Gjithashtu, Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) na ka lajmëruar se namazi është gjëja e fundit që do të humbasë kjo fe, vepra e parë për të cilën do të pyeten njerëzit përpara Allahut të Madhëruar dhe ai që e dallon muslimanin nga jomuslimani. **(Për më tepër, shih në “Sahihun” e Muslimit hadithin me nr. 134. Gjithashtu “Vargu i haditheve të sakta” i Shejh Albanit (RahimehUllah) me nr. 1 739, 1 358, 1 748)**

Kryerja e namazit bëhet në dy mënyra. Mënyra e parë është e detyrueshme dhe do të thotë të realizosh të paktën detyrimin, i cili largon nga ti përgjegjësinë dhe llogarinë. Mënyra e dytë është ajo e preferuara, e cila nënkupton plotësimin e tij **(namazit)** me çdo gjë që është e pëlqyeshme të veprohet në namaz.

6 - Zekati gjithmonë vjen i shoqëruar me namazin, si në ajetet kuranore, ashtu edhe në hadithe. Allahu i Madhëruar thotë në Librin e Tij: **“...dhe nëse ata**

pendohen, e falin namazin dhe e japin zekatin, atëherë lërinin të lirë.”

(Suretu Teube, 5)

Dhe thotë: **“...dhe nëse ata pendohen, e falin namazin dhe e japin zekatin, atëherë janë vëllezërit tuaj në fe.”** (Suretu Teube, 11) Ndërsa në një ajet tjetër thotë: **“Ata nuk i urdhëruam me gjë tjetër vetëm se të adhuronin Allahun me adhurim të sinqertë, të largoheshin nga çdo besim i kotë, të falnin namazin dhe të jepnin zekatin, sepse kjo është feja e drejtë.”**

(Suretu Bejine, 5)

Zekati është adhurim material, dobia e të cilit u shkon edhe të tjerëve. Allahu i Madhëruar e ka obliguar atë për të pasurit, në atë mënyrë që të përfitojnë edhe të varfërit. Zekati, kurrsesi nuk e dëmton të pasurin, kjo për shkak se nga pasuria e tij jepet një përqindje shumë e vogël e një sasive shumë të madhe parash.

7 - Agjërimi i muajit të Ramazanit është adhurim trupor i fshehtë midis njeriut dhe Krijuesit dhe atë nuk e njeh askush përveç Allahut të Madhëruar. Ka njerëz që ti mendon se agjërojnë, por në të vërtetë nuk agjërojnë e po ashtu, ka njerëz që agjërojnë nafie dhe njerëzit mendojnë se ai nuk agjëron. Për këtë arsye, në një hadith të saktë është transmetuar: **“Njeriu shpërblehet për punën e tij të mirë, dhjetë, deri në shtatëqindfish.”** Allahu i Madhëruar tha: **“Me përjashtim të agjërimin, i cili kryhet vetëm për Mua dhe Unë shpërblej për të (pa llogari).”** (Transmeton Buhariu me nr.1 894 dhe Muslimi me nr.164) Të gjitha veprat e njeriut duhet të kryhen për hir të Allahut. Allahu i Madhëruar në librin e Tij thotë: **“Thuaj; namazi im, kurhani im, jeta dhe vdekja ime, janë vetëm për Allahun, Zotin e botëve. Ai nuk ka shok. Kështu jam urdhëruar dhe jam i pari i muslimanëve.”** (Suretu Enam, 162) Por, në këtë hadith u veçua agjërimi për shkak të fshehtësisë që ka ky adhurim, të cilin nuk e njeh askush, përveç Allahut.

8 - Haxhi (**vizita e shtëpisë së shenjtë**) është një adhurim material dhe trupor njëkohësisht, të cilin Allahu i Madhëruar ia ka obliguar çdo njeriu një herë të vetme në jetë.

Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) në një prej haditheve të tij, duke treguar për rëndësinë e tij ka thënë: **“Kush e kryen Haxhin, duke mos e përzier atë me fjalë të pista ose vepra të ndaluara, kthehet sikur ta kishte lindur nëna e tij edhe një herë.”** (Transmeton Buhariu me nr.1 820) Gjithashtu ka thënë: **“Kryerja e Umreve njëra pas tjetrës i fshin mëkatet ndërmjet tyre, ndërsa Haxhi i pranuar tek Allahu, nuk ka shpërblim tjetër përveç Xhenetit.”** (Transmeton Muslimi me nr.1 349)

9 - Ky hadith me fjalitë e tij e rendit Haxhin para agjërimit. Me këtë renditje e transmetoi edhe Buhariu në fillimet e kapitullit të imanit në Sahihun e tij dhe në bazë të tij, ai renditi librin e tij **“El Xhamiu Sahih” (Përmbledhja e haditheve të sakta)**, duke i dhënë përparësi kapitullit mbi Haxhit kundrejt kapitullit të agjërimit. Ndërsa në Librin e saktë të **“Muslimit”** është transmetuar ky hadith me nr. 19, dhe ka renditur agjërimin para Haxhit, si dhe në një version tjetër ka renditur Haxhin para agjërimit. Në versionin e parë Ibn Umeri pohon se ajo që ka dëgjuar nga Profeti (sal-Allahu ‘alejhi ue sel-lem) është renditja e agjërimit përpara Haxhit. Duke u nisur nga ky fakt themi se renditja e Haxhit para agjërimit është bërë nga transmetuesit, të cilët mund ta kenë transmetuar hadithin me nënkuptim. Ndërsa hadithi i Ibn Umerit në Sahihun e Muslimit vjen në këtë mënyrë: **“Islami është i ndërtuar mbi pesë (shtylla); mbi njësimin e Allahut, kryerjen e namazit, dhënien e zekatit, agjërimit dhe muajit Ramazan dhe kryerjen e Haxhit.”** Dikush pyeti: **“Haxhi dhe më pas agjërimi i Ramazanit?”** Ai iu përgjigj: **“Përkundrazi agjërimi i Ramazanit dhe Haxhi, kështu e kam dëgjuar nga i Dërguari i Allahut (sal-Allahu ‘alejhi ue sel-lem).”**

10 - Pesë shtyllat e Islamit janë përmendur të radhitura sipas rëndësisë që ka secila prej tyre. Në fillim vjen Shehadeti, i cili është bazë e çdo veprë që të afron tek Allahu i Madhëruar. Më pas renditet namazi, i cili falet pesë herë gjatë një ditë - nate, pra është një lidhje e fortë ndërmjet njeriut dhe Krijuesit. Më pas vjen zekati, i cili obligohet vetëm atëherë kur pasuria arrin një vlerë të caktuar sipas Sheriatit, duke qenë e palëvizshme gjatë një viti, sepse dobia e saj u kalon edhe të tjerëve. Pastaj vjen agjërimi, i cili obligohet vetëm një muaj në vit. Dhe në fund përmendet Haxhi, i cili është detyrë vetëm një herë në jetë.

11 - Në Sahihun e Muslimit transmetohet se Ibn Umeri e tregoi këtë hadith në kohën kur dikush e pyeti dhe ai iu përgjigj: **“A nuk shkon në luftë?”** - E më pas tregoi hadithin. E bëri këtë për të treguar se Xhihadi nuk është prej shtyllave të Islamit, kjo për faktin se këto pesë shtylla janë të pandara për çdo njeri, ndryshe nga Xhihadi i cili është farz kifaje (**Farzi kifaje është ai obligim kolektiv të cilin nëse e kryen një grup njerëzish, bie detyrimi ndaj të tjerëve**), i cili nuk ndërmerret në çdo kohë.

12 - Ndër përfitimet që kemi nga ky hadith janë:

1 - Rëndësia e këtyre pesë shtyllave, duke qenë se Islami është ndërtuar mbi to.

2 - Përdorimi i shprehjeve figurative kundrejt shembujve realë, me qëllim që të fiksohen më mirë nga njerëzit.

- 3 - Gjithçka duhet nisur nga gjërat më të rëndësishme, e kështu me radhë.
- 4 - Dy dëshmitë janë bazë në vetvete dhe bazë për gjërat e tjera. Për këtë arsye nuk pranohet një vepër, nëse ajo nuk është e ndërtuar mbi këto dy dëshmi.
- 5 - Shihet prioriteti që i jepet namazit krahas veprave të tjera sepse ai është një lidhje e ngushtë mes robit dhe Zotit të tij.

04 - Secili prej jush krijohet në barkun e nënës së tij.

Ebu AbduRrahman Abdullah bin Mesudi (radijAllahu ‘anhu) transmeton kështu: “I Dërguari i Allahut, ai që fliste gjithmonë të vërtetën e që është i besueshëm na ka treguar: **“Çdo njeri formohet në mitrën e nënës së tij, duke qëndruar dyzet ditë si pikë e lëngshme (nutfetun), pastaj, po për aq ditë bëhet copëz gjaku (alekatun), e më pas, po për aq kohë bëhet copë mishi, pas kësaj i dërgohet një engjëll që e frymëzon me shpirt dhe këtij engjëlli i urdhërohet që të shkruajë katër gjëra: Të shkruajë riskun e fëmijës, exhelin (sa do të jetojë), veprat (për këtë botë) dhe fatin. Beto hem në Allahun që s’ka të adhuruar me të drejtë përveç Tij, se disa nga ju do të bëjnë vepra të banorëve të Xhenetit, derisa ndërmjet tyre dhe Xhenetit t’i ndajë një parakrah dhe aty do të ngadhënjejë ajo që është shkruar, e kështu do fillojnë të praktikojnë vepra të njerëzve të zjarrit, derisa të hyjnë në të. Gjithashtu disa nga ju do të kryejnë punë të banorëve të zjarrit, derisa ndërmjet tyre dhe zjarrit të ketë vetëm një parakrah hapësirë, e aty do të ngadhënjejë ajo që është shkruar, e si rrjedhojë do punojë vepra të njerëzve të Xhenetit dhe do të hyjë në të.”** Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

1 - Fjala e Ibn Mesudit: **“Ai që fliste gjithmonë të vërtetën e që është i besueshëm”**, do të thotë i sinqerti, i vërteti kur fliste dhe i besueshmi në atë që i kumtohej prej shpalljes. Ibn Mesudi i tha këto fjalë sepse çështjet që trajton ky hadith kanë të bëjnë me gjëra të gajbit **(të fshehta)**, të cilat njihen vetëm nëpërmjet shpalljes.

2 - Falët e hadithit: **“Çdo njeri formohet në mitrën e nënës së tij”**, disa i kanë komentuar me fjalët: **“Lëngu i burrit bashkohet me atë të gruas në mitrën e saj dhe prej tyre krijohet njeriu”**, ashtu siç thotë Allahu i

Madhëruar në librin e Tij: **“Është krijuar prej një lëngu që hidhet.”** (Suretu Tarik, 6)

Gjithashtu thotë: **“A nuk ju kemi krijuar nga një pikë lëngu të shpërfillur, të cilën e vumë në një vend të sigurt (mitër)”** (Suretu Murselat, 20-21)

Kuptimi i fjalës krijim është lënda prej së cilës është krijuar njeriu sepse në Sahihun e Muslimit me nr. 1 438 transmetohet se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Fëmija nuk krijohet nga i gjithë lëngu.”**

3 - Në këtë hadith përmenden etapat e krijimit të njeriut, të cilat vijnë të radhitura në këtë formë: Së pari kur është pikë e lëngshme, pra sasi shumë e vogël. Së dyti copëz gjaku, pra është gjak i trashë dhe i ngjizur. Së treti copëz mishi, në atë masë sa mund ta përtypë një njeri që ushqehet. Allahu i Madhëruar këto tri etapa i ka përmendur në fjalën e Tij ku thotë: **“O njerëz, nëse ju dyshoni në ringjalljen, mendoni si Ne ju kemi krijuar prej dheut, pastaj prej pikës së farës, pastaj prej droçkave të gjakut, pastaj prej një cope mishi me trajtë të plotë ose jo të plotë.”** (Suretu Haxh, 5)

Që do të thotë të formuar ose të paformuar. Prej ajeteve që i trajtojnë më së shumti etapat e krijimit të njeriut është fjala e Allahut të Lartësuar në suren Muminun: **“Me të vërtetë Ne e kemi krijuar njeriun prej palcës së baltës, e pastaj e bëmë atë pikë fare dhe e vumë në një vend të sigurt (mitër). E mandej, pikën e farës e bëmë droçkë gjaku, e pastaj e bëmë copëz mishi pa formë; mandej, me atë mish bëmë eshtrat, pastaj i veshëm eshtrat me mish dhe pastaj e bëmë atë (njeriun) krijesë tjetër (duke i futur shpirtin). I lartësuar qoftë Allahu, Krijuesi më i përsosur!”** (Suretu Muminun, 12-14)

4 - Në hadith thuhet se pasi të kalojnë këto tri etapa e që llogariten të jenë 120 ditë, pas kësaj i frymëzohet shpirti, e kështu bëhet njeri i gjallë, e para kësaj ai ishte i vdekur. Në Kuranin famëlartë tregohet se njeriu ka dy jetë dhe dy vdekje, siç thotë Allahu i Madhëruar kur flet për mohuesit: **“Ata thanë: O Zoti ynë, na dhe vdekje dy herë dhe na ngjalle dy herë!”** Vdekja e parë është koha para se njeriu të frymëzohet me shpirt, ndërsa jeta e parë është kur i frymëzohet shpirti, e derisa të arrijë exhelin (**afatin e caktuar**). Vdekja e dytë është që pas vdekjes e deri në ringjallje dhe kjo vdekje nuk bie ndesh me jetën e varrit që është e pohuar në Kuran dhe Sunet. Ndërsa jeta e dytë është jeta pas ringjalljes e cila është e përhershme dhe e pafund. Këto katër gjendje të njeriut i ka sqaruar Allahu me fjalën e Tij: **“Ai ju dha jetë dhe pastaj do t’ju bëjë të vdisni, e më vonë do t’ju ringjallë. Me të vërtetë, njeriu është mosmirënjohës.”** (Suretu Haxh, 66) Gjithashtu thotë: **“Si mund ta mohoni Allahun, ndërkohë që keni qenë të pajetë e Ai ju dha jetën?! Pastaj Ai do**

t'ju bëjë të vdisni, më pas do t'ju ringjallë, e në fund do të ktheheni tek Ai?!” (Suretu Bekare, 28)

Nëse foshnja lind i vdekur pasi i është frymëzuar shpirti, atëherë mbi të kryhen të gjitha dispozitat e lindjes së një fëmije, kjo duke e larë dhe duke i falur namazin. Gjithashtu, gruaja e përfundon me këtë lindje afatin e saj që pret sido që të jetë foshnja; vajzë apo djalë. Gjithashtu, nëna konsiderohet lehonë. Por, nëse foshnja lind para kësaj kohe, atëherë për të nuk kryhen këto dispozita.

5 - Pasi që engjëlli shkruan riskun, exhelin, gjininë dhe fatin, qysh në këtë moment gjinia e foshnjës nuk konsiderohet ndër të fshehtat që di vetëm Allahu, për arsye se engjëlli tashmë e di atë. Kësisoj, nuk është e pamundur që të mësohet gjinia e foshnjës.

6 - Paracaktimi i Allahut është vendosur për çdo gjë që do të ndodhë. Ajo që merret parasysh për lumturinë apo shkatërrimin e njeriut është gjendja e njeriut gjatë vdekjes.

7 - Gjendjet e njerëzve, përsa i përket fillimit dhe mbarimit të jetës janë katër:

E para: Ai që fillimin dhe mbarimin e jetës e ka pasur të mirë.

E dyta: Ai që fillimin dhe mbarimin e jetës e ka pasur të keq.

E treta: Ai që fillimin e jetës e ka pasur të mirë, por fundin të keq, siç është rasti i një njeriu që rritet nën bindjen ndaj Allahut dhe para se të vdesë, heq dorë nga Islami dhe vdes si mohues.

E katërta: Ai që fillimin e ka pasur të keq, ndërsa fundin të mirë, siç ishte rasti i magjistarëve të Faraonit, të cilët besuan në Zotin e Harunit dhe Musait, apo siç ishte rasti i jehudiut që i shërbeu Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Atë e vizitoi i Dërguari i Allahut në kohën që ishte i sëmurë dhe i tregoi për Islamin dhe ai e pranoi atë. Pas kësaj i Dërguari i Allahut tha: **“Falënderimi i qoftë Allahut që e shpëtoi nga zjarri.”** Ky hadith transmetohet në Sahihun e Buhariut me nr. 1 356. Për dy rastet e fundit flet hadithi, të cilin po e komentojmë.

8 - Hadithi pohon se njeriu bën ato vepra që i sjellin lumturinë ose shkatërrimin me vullnetin e tij të plotë, e megjithatë ai nuk mund të dalë nga dëshira dhe vullneti i Allahut. Kështu që, ai është i lirë në kuptimin që vepron me dëshirën e tij dhe është i komanduar në kuptimin që nuk ndodh gjë prej tij nëse atë nuk e ka dashur Allahu. Ky hadith i ka pohuar të dyja rastet sepse

para vdekjes ndodh që të ngadhënjejë ajo që është shkruar e kështu ai kryen vepra të banorëve të Xhenetit ose vepra të banorëve të zjarrit.

9 - Njeriu duhet të jetojë mes frikës dhe shpresës, sepse njeriu gjatë jetës mund të bëjë shumë vepra të mira, por mund të ndodhë që fundin e jetës ta ketë shumë të keq. Gjithashtu, ai nuk duhet ta shuajë shpresën sepse njeriu mund të kryejë vepra të këqija për një kohë të gjatë e më pas, Allahu ta begatojë duke i dhuruar udhëzimin, e në këtë mënyrë të udhëzohet në fund të jetës së tij.

10 - Neveviu, duke e komentuar këtë hadith, shprehet kështu: “Nëse dikush citon fjalët e Allahut të Madhëruar: **“Sa për ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, sigurisht që Ne nuk do t’ua humbim shpërblimin punëmirëve.”**

(Suretu Kehf, 30) Nga kjo kuptohet se puna e mirë që bëhet nga njeriu i sinqertë pranohet, e nëse arrin të pranohet edhe nga Allahu me këtë rast ky njeri sigurohet nga përfundimi i keq. Ne këtyre fjalëve u përgjigjemi në dy forma:

E para: Mundet që kjo të jetë e lidhur me kushtet e pranimi dhe përfundimit të mirë, por mundet të jetë edhe fakti se ai që beson dhe veprat e tij i kryen me sinqeritet, gjithmonë ky njeri do ta ketë përfundimin të mirë.

E dyta: Përfundimi i keq është për ata që i prishin punët, duke i përzier të mirat me lloje të ndryshme të syfaqësisë. E për këtë tregon hadithi tjetër që thotë: **“Vërtet ndonjëri nga ju kryen vepra të banorëve të Xhenetit për syfaqe të njerëzve”,** d.m.th. në atë që njerëzit shohin nga devotshmëria e jashtme, edhe pse gjendja e tij e brendshme është e keqe dhe jo e pastër, e për këtë Allahu e di më mirë.”

11 – Disa nga përfitimet që nxjerrim nga ky hadith janë:

1 - Hadithi shpjegon etapat e krijimit të njeriut në barkun e nënës.

2 - Frymëzimi i shpirtit kryhet pas 120 ditëve dhe pas kësaj periudhe konsiderohet krijese njerëzore.

3 - Disa engjëj janë caktuar me ecurinë e foshnjës në mitrën e nënës.

4 - Besimi në Gajb **(të fshehtën).**

5 - Besimi në paracaktimin e Allahut dhe se me dijen e Tij ka përfshirë çdo gjë që do të ndodhë.

6 - Lejohet që njeriu të betohet, edhe pse nuk i kërkohet diçka e tillë, e kjo për të përforcuar fjalën që thotë.

7 - Veprat vlerësohen sipas përfundimeve.

8 - Njeriu duhet të bashkojë mes frikës dhe shpresës. Ai që vepron mirë duhet të ketë frikë nga përfundimi i keq, ndërsa ai që bën keq nuk duhet ta humbasë shpresën nga mëshira e Allahut.

9 - Veprat janë shkak për hyrjen në Xhenet ose në Xhehenem.

10 - Nëse për dikë është shkruar të jetë i pafat, askush në këtë botë nuk mund të ketë dijeni, e njëjta gjë është edhe për atë që është shkruar të jetë me fat.

05 - Kush shpik në fenë tonë çfarë nuk është prej saj, është e refuzuar.

Nëna e besimtarëve Umu Abdilah, Aisha (radijAllahu ‘anha) transmeton se i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Kush shpik në fenë tonë diçka që nuk i përket asaj, atëherë ajo punë nuk pranohet (nga Allahu).”** Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

Ndërsa Muslimi në versionin e tij transmeton: **“Kush kryen një punë që nuk përputhet me fenë tonë, ajo do t’i refuzohet.”**

1 - Ky hadith është bazë mbi të cilin peshohen veprat e dukshme të njeriut. Ato nuk merren parasysh vetëm se atëherë kur janë në përputhje të plotë me legjislacionin Islam. Ashtu sikurse edhe hadithi: **“Veprat vlerësohen sipas qëllimeve”**, i cili është bazë për veprat e fshehta të njeriut. Prandaj, çdo punë me të cilën njeriu afrohet tek Allahu duhet të jetë e pajisur me singëritet për hir të Allahut dhe nijeti i tij të merret në konsideratë.

2 - Nëse disa adhurime siç janë: abdesi, gusuli nga xhunubllëku, namazi etj., kryhen në kundërshtim me legjislacionin, atëherë ato konsiderohen të papranuara dhe nuk merren në konsideratë. Gjithashtu, nëse diçka merret me marrëveshje të pavlefshme, në mënyrë të paligjshme, padrejtësisht, atëherë ajo gjë duhet t’i kthehet të zotit dhe nuk mund ta ketë në pronësinë e tij. Këtë që thamë e pohon ndodhia e Asifit ku i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue

sel-lem) i drejtohet babait të tij (**Asifit**) duke i thënë: **“Përsa u përket qengjave dhe deleve ato të përkasin ty.”** (E transmeton Buhariu me nr. 2 695 dhe Muslimi me nr. 1 697)

3 - Gjithashtu, hadithi pohon se cilido që shpik një bidat që nuk ka bazë në fe, i kthehet mbrapsht dhe meriton dënimin e Allahut, sepse i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem)duke folur për Medinën ka thënë: **“Kush shpik në të ndonjë bidat apo strehon një bidatçi, mbi të qoftë mallkimi i Allahut, engjëjve dhe i gjithë njerëzve.”** (E Transmeton Buhariu me nr. 1 870 dhe Muslimi me nr. 1 366)

4 - Versioni i dytë që shënohet tek Muslimi është më i përgjithshëm se transmetimi që shënohet në dy librat e saktë (**Të Buhariut dhe Muslimit**).

E themi këtë sepse ai përfshin çdo njeri që e praktikon bidatin sido që të jetë; e ka shpikur vetë, apo e kanë shpikur të tjerët para tij ose edhe kur është ndjekës i atij që e ka shpikur.

5 - Kuptimi i fjalës në hadith **“e refuzuar”** do të thotë i kthehet mbrapsht. Me fjalë të tjera; ajo është vepër e kotë dhe nuk merret në konsideratë.

6 - Hadithi nuk i përfshin interesat që përdoren në ruajtjen e fesë, apo që ndihmojnë në kuptimin dhe mësimin e saj, ashtu siç ishte rasti i tubimit të Kuranit në libra, shkrimi i njohurive të gjuhës e gramatikës, etj.

7 - Hadithi pohon refuzimin e çdo vepre që bie ndesh me legjislacionin, edhe nëse qëllimi i praktikuesit është i mirë. Argument për këtë është edhe hadithi që tregon për sahabin që theri kurbanin e tij para namazit të Bajramit dhe Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i tha: **“Kafsha jote pati vlerë vetëm për mish.”** (E Transmeton Buhariu me nr. 955 dhe Muslimi me nr. 1 961)

8 - Ky hadith me frazat e tij pohon se çdo vepër që nuk është në përputhje me legjislacionin është e refuzuar. Ndërsa në aspektin kuptimor pohon se çdo vepër që kryhet në përputhje me të nuk është e refuzuar. Kjo do të thotë se ajo vepër, e cila është kryer në përputhje me dispozitat legjislative është e pranuar, ndërsa ato që qëndrojnë jashtë këtyre normave janë të refuzuara.

9 – Përfitimet që kemi nga ky hadith janë:

1 - Ndalohen risitë në fe.

2 - Një vepër që është e ndërtuar mbi një bidat, nuk pranohet.

3 - Ndalimi i një veprë nënkupton se ajo është e refuzuar **(nuk pranohet tek Allahu).**

4 - Nëse një punë e mirë nuk kryhet në formën e lejuar, siç janë namazet vullnetare në kohën e ndaluar nëse falen pa ndonjë arsye, apo agjërimi i ditëve të Bajramit, etj. konsiderohen të kota dhe nuk merren në konsideratë.

5 - Gjykimi i një gjykatësi nuk e ndryshon realitetin që fshihet lidhur me një çështje të caktuar, e kjo, duke u bazuar në fjalën e Profetit: **“Që nuk përputhet me fenë tonë.”**

6 – Marrëveshja e pavlefshme nuk merret në konsideratë dhe është e kotë, ndaj atij që i është marrë diçka në këtë mënyrë duhet t'i kthehet mbrapsht siç u theksua në hadithin e Asifit.

06 - Hallalli është i qartë dhe harami është i qartë.

Ebu Abdullah en Numan bin Beshiri (radijAllahu ‘anhu) transmeton duke thënë: “E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) të ketë thënë: **“Vërtet e lejuara (hallalli) është e qartë, po ashtu edhe e ndaluara (harami) është e qartë. Ndërmjet tyre qëndrojnë punët e dyshimta që shumë njerëz nuk kanë njohuri rreth tyre. Ai që ruhet nga punët e dyshimta me këtë veprim ka ruajtur fenë dhe nderin e tij, ndërsa ai që nuk ruhet nga punët e dyshimta, si rrjedhojë bie edhe në vepra të ndaluara (haram). Si shembulli i një bariu që ruan kopenë përreth vendit (kullotës) të ndaluar, ku kopeja mund t'i iki dhe të kullosë në të. Ta dini se çdo sundues e cakton kufirin e ndaluar për të tjerët, ndërsa kufiri që ka vënë Allahu janë ndalesat (haramet) e Tij. Vini re! Në trup ndodhet një organ, i cili kur është i shëndetshëm, gjithë trupi është i shëndetshëm, e kur sëmuret ai, atëherë i tërë trupi sëmuret. Ai organ është zemra!”**

Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

1 - Fjalët e Profetit: **“Vërtet e lejuara (hallalli) është e qartë, po ashtu edhe e ndaluara (harami) është e qartë. Ndërmjet tyre qëndrojnë vepra të dyshimta që shumë njerëz nuk kanë njohuri rreth tyre.”** tregojnë për ndarjen e veprave në tri grupe:

Grupi i parë: Hyjnë veprat e lejuara të qarta siç janë: drithërat, frytet, kafshët dhe bagëtitë, gjithmonë nëse njeriu nuk i fiton ato jo në rrugë të ndaluar.

Grupi i dytë: Hyjnë veprat e ndaluara të qarta, siç janë: pirja e alkoolit, ngrënia e ngordhësirës, martesë me individë që ka ndaluar Allahu. Këto dy grupe janë të njohura nga të gjithë njerëzit.

Grupi i tretë: Hyjnë veprat e dyshimta që ndodhen mes hapësirës së veprave të lejuara dhe atyre të ndaluara, pra nuk konsiderohen vepra të lejuara qartësisht, e as të ndaluara qartësisht. Për këtë fakt, shumë njerëz nuk kanë dijeni, por ka prej tyre që dinë.

2 - Fjalët e Profetit: **“Ai që ruhet nga veprat e dyshimta, ka ruajtur kështu, fenë dhe nderin e tij, ndërsa ai që si pasojë e kryerjes së veprave të dyshimta, përfundon në vepra të ndaluara (haramë). Si shembulli i një bariu që ruan kopenë përreth vendit (kullotës) të ndaluar, e ku kopeja mund të kullosë edhe në të. Ta dini se çdo sundues e cakton kufirin e ndaluar për të tjerët, ndërsa kufiri që ka vënë Allahu janë veprat e ndaluara (haramet) prej Tij.”**

Fjala e mësipërme i referohet grupit të tretë që ka të bëjë me veprat e dyshimta, prej të cilave njeriu duhet të distancohet. Nëse vepron kështu ai me këtë ruan fenë që ka mes tij dhe Allahut, si dhe ruan nderin që ka mes tij dhe njerëzve. Në këtë mënyrë njerëzit nuk do të gjejnë mënyrë për të folur në nderin e tij. Por nëse ai tregohet tolerant duke rënë në gjëra të dyshimta, kjo gjë e shpie atë drejt haramëve të qarta. I Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) solli shembullin e një bariu që kullot bagëtinë përreth një vendi të ndaluar, e nëse ai do qëndronte larg këtij vendi atëherë edhe bagëtia e tij do ruheshin dhe nuk do shkonin në kullotën e ndaluar. Por nëse ai qëndron afër saj atëherë edhe bagëtia e tij do kullosin në vendin e ndaluar, pa e kuptuar ai. Qëllimi i kufirit është ajo që vendosin sunduesit apo të tjerët për të ruajtur tokat pjellore, dhe për t'i ndaluar të tjerët që t'u afrohen. Prandaj ai që kullot bagëtinë afër tyre pritet që bagëtia të kullosë aty e në këtë mënyrë ta çojë veten drejt ndëshkimit. Ndërsa kufijtë e Allahut janë të ndaluarat e tij prandaj njeriut i kërkohet që të largohet prej tyre, si dhe nga gjërat e dyshimta të cilat e shpien njeriun drejt të ndaluarave.

3 - Fjalët e Profetit: **“Vini re! Në trup ndodhet një (mudgah) organ, i cili kur është i shëndetshëm, i tërë trupi nuk sëmuret, e ku nuk është i shëndetshëm, atëherë i tërë trupi sëmuret. Ai organ është zemra!”**

Termi Mudgah i përmendur në hadith përkthehet: një copëz mishi në madhësinë e kafshatës që mund të përtypë njeriu. Këtu vërehet rëndësia e madhe e zemrës për trupin, duke konsideruar organin kryesor për nga

rëndësia dhe se trupi përmirësohet me përmirësimin e saj dhe përkeqësohet me përkeqësimin e saj.

4 - Neveviu ka thënë: **“Në fjalën e Profetit: “Ndërsa ai që bie në vepra të dyshimta, si rrjedhojë bie edhe në vepra të ndaluara (harame)”**, nënkuptojmë dy gjëra:

E para: Besimtari bie në haram, duke menduar se ajo vepër nuk është haram.

E dyta: Besimtari i është afruar shumë haramit, me qëllim për të rënë në haram, ashtu sikurse është thënë: **“Mëkatet shpien drejt kufrit.”** Kjo, për faktin që nefs i kur bie prehë e një mëkati fillon të përshkallëzohet nga një e keqe, drejt një tjetre akoma më të madhe se e para. Është thënë: “Këtë shenjë Allahu na i ka treguar duke na thënë: **“Kjo ishte për shkak se mohuan shpalljet e Tij dhe pa kurrfarë të drejte i vrisnin profetët. Kjo ishte për shkak se ata nuk u bindën dhe i kaluan kufijtë (në të këqija).”** (Suretu Ali Imran, 112)

Në këtë ajet Allahu tregon se mëkatet i shpien njerëzit në vrasjen e profetëve, ndërsa në një hadith tjetër Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) thotë: **“Allahu e mallkoftë atë vjedhës që vjedh një vezë dhe i pritët dora, gjithashtu vjedh një litar dhe i pritët dora.”** (Qëllimi i hadithit është se i bëhet vjedhja ves dhe zakon, duke e nisur me gjëra të vogla, për të cilat nuk ka masë ndëshkimore, por që më pas ky ves nuk ndalon derisa e çon atë të vjedhë diçka për të cilën ndëshkohet me masën e parashikuar në sheriat për hajdutin) Ku tregon se veprimi i tij përshkallëzohej nga veza dhe litari, drejt vjedhjeve më të mëdha.

5 - Numan bin Beshiri (radijAllahu ‘anhu) ishte sahab në moshë të vogël, madje kur i Dërguari i Allahut ndërroi jetë, ai ishte vetëm tetë vjeç. Në këtë transmetim ai thotë: **“E kam dëgjuar Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) të thotë....”** që tregon se fjalët e fëmijës që ka arritur të dallojë (Mosha e dallimit të së mirës nga e keqja, të së drejtës nga e gabuara, pra mosha që i përafrohet pubertetit), apo që i ka memorizuar (fjalët e Profetit) në kohën e fëmijërisë dhe i transmeton në moshë madhore, janë të pranuar dhe merren në konsideratë-. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për jobesimtarin, i cili ka mësuar diçka në kohën e kufrit dhe e tregon atë në kohën kur ka pranuar Islamin.

6 - Përfitimet që nxjerrim nga ky hadith janë:

- 1 - Sqarimi i ndarjeve të gjërave në legjislacionin Islam në të lejuara, të ndaluara, dhe të dyshimta të cilat varrojnë mes dy të parave.
- 2 - Të dyshimtat nuk i dinë shumë njerëz, edhe pse disa të tjerë i dinë ato bashkangjitur me argumentet përkatëse.
- 3 - Nuk duhet t'i afrohem të dyshimtës derisa të na bëhet e qartë se është e lejuar.
- 4 - Dhënia e shembujve për të pohuar kuptimet figurative duke i krahasuar me gjëra reale.
- 5 - Kur njeriu bie në gjëra të dyshimta i bëhet mjaft e lehtë që të praktikojë edhe të ndaluarat që janë të qarta.
- 6 - Në hadith shihet vendi i rëndësishëm që zë zemra dhe se gjymtyrët e ndjekin atë. Ato përmirësohen me përmirësimin e saj dhe prishen me prishjen e saj.
- 7 - Shthurja e pamjes së jashtme është argument për shthurjen e gjendjes së brendshme.
- 8 - Distancimi nga të dyshimtat e ruan fenë e njeriut nga mangësitë, si dhe nderin e tij nga turpet dhe sharjet.

07 - Feja është këshillë.

Ebu Rukaje Temim bin Eus ed Dari (radijAllahu ‘anhu) transmeton se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Feja është këshillë.”** E pyetën: **“Për cilin, o i Dërguari i Allahut?”** Ai u përgjigj: **“Për Allahun, Librin e Tij, të Dërguarin e Tij, për imamët (prijësat, sunduesit) e muslimanëve, dhe për të gjithë njerëzit e thjeshtë.”** Transmeton Muslimi.

1 - Fjala e Profetit: **“Feja është këshillë”** janë fjale gjithpërfshirëse që pohojnë rëndësinë që ka këshilla në fe se ajo është baza dhe shtylla që e mban atë. Në këtë kuadër ka zbritur edhe hadithi i Xhibrilit ku i Dërguari i Allahut e komenton Islamin, imanin dhe ihsanin me të gjithë fenë duke thënë: **“Ai ishte Xhibrili, erdhi t’ju mësojë fenë tuaj.”** I ngjashëm me të është edhe kjo fjali ku Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) thotë: **“Haxhi është qëndrimi në Arafat”**, duke qenëse Arafati është shtylla më e madhe e Haxhit, pa të cilën Haxhi nuk ka vlerë.

2 - Në librin Mustehrexh të Ebu Auanes transmetohet se Profeti këtë fjali; **“Feja është këshillë”** e ka përsëritur tri herë, ndërsa në Sahihun e Muslimit, ajo transmetohet pa u përsëritur. Shokët e Profetit kur vunë re këtë kujdes dhe rëndësi që i kushtojë këshillës dhe kuptuan gradën e saj të lartë pyetën: “Për këtë, o i Dërguari i Allahut?” Ndërsa ai u përgjigj duke renditur pesë të referuarve në hadith. Një grup i madh dijetarësh e kanë komentuar hadithin, por prej atyre që e ka komentuar më mirë është Ebu Amr bin Salahu në librin e tij Sijanetu sahihi Muslim minel Ihlali uel Galati ue himajetuhu minel iskatu ue sakat. Në fq. 223 - 224 ai shprehet kështu: “Këshilla është një fjalë gjithpërfshirëse, e cila kërkon prej këshilluesit që të këshillojë në format më të mira, si për nga dëshira, ashtu edhe në praktikë. Këshilla që bëhet për Allahun e Madhëruar do të thotë; ta njësoh Atë, ta cilësosh me cilësitë e plota dhe të bukura dhe ta pastrosh nga punët që bien ndesh me to. T’u largohet punëve të ndaluara nga Ai, të praktikojë me sinqeritetin më të madh bindjen ndaj Tij dhe adhurimin që Ai do. Të dojë dhe të urrejë për hir të Tij, t’i luftojë ata që e mohojnë Atë, etj. T’i ftojë dhe t’i nxisë të tjerët për të kryer këto vepra.

Ndërsa këshilla për librin e Tij do të thotë: të besojë, ta madhërojë dhe ta nderojë atë, ta lexojë ashtu siç duhet, të qëndrojë aty ku urdhërohet dhe jo aty ku ndalohet, të kuptojë dituritë dhe shembujt e tij, duke i ftuar edhe të tjerët. T’i dalë në mbrojtje këtij libri, kundrejt shtrembërimeve të ekstremistëve dhe sharjeve të mohuesve. Këshilla për Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) është e përafërt me atë që thamë më sipër: të besosh te Profeti dhe te ajo që i zbriti atij, ta nderosh, ta respektosh, t’i bindesh atij, të ringjallësh Sunetin (traditën) e tij, si dhe të mësosh njohuritë që ai la pas duke i përhapur tek të tjerët. Të urresh cilindo që e urren atë dhe Sunetin e tij dhe të duash cilindo që e do atë dhe Sunetin e tij. Të pajisesh me moralin e tij dhe të ndjekësh sjelljet e tij, të duash shokët dhe familjen e tij, etj. Këshilla për prijësit e muslimanëve, do të thotë: t’i ndihmosh në rrugën e drejtë dhe t’u bindesh, t’i këshillosh me butësi dhe mëshirë, të distancohesh nga kryengritjet që u bëhen atyre, të lutesh që Allahu t’u japë sukses dhe t’i nxisësh njerëzit fisnikë për këtë gjë. Te këshilla për njerëzit në përgjithësi bëjnë pjesë ata që nuk përfshihen tek udhëheqësit, e kjo do të thotë t’i udhëzojmë drejt të mirave, t’u mësojmë gjërat e fesë dhe të dunjasë. T’u mbulojmë të metat, t’i ndihmojmë kundër armiqve dhe t’u dalim krah, të distancohemi nga dredhitë dhe zilia për ta, të duam për ta atë që duam për vetet tona dhe të urrejmë për ta atë që urrejmë për vetet tona etj.”

3 - Përfitimet që nxjerrim nga ky hadith janë:

1 - Rëndësia e madhe që ka këshilla në fe.

- 2 - Në hadith sqarohet se për kë duhet të bëhet këshilla.
- 3 - Nxitja që këshilla të fokusohet në këto pesë gjëra që u përmendën në hadith.
- 4 - Vërehet kujdesi i sahabëve për të mësuar çështjet e fesë.
- 5 - Fe i thuhet edhe punës sepse në hadith Profeti e quajti këshillën fe.

08 - Jam urdhëruar që t'i luftoj njerëzit derisa.

Ibn Umeri (radijAllahu ‘anhu) transmeton se i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Jam urdhëruar t'i luftoj njerëzit, derisa të dëshmojnë se nuk ka të adhuruar të vërtetë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Tij, të falin namazin dhe të japin zekatin. Nëse e bëjnë këtë, ata do të fitojnë nga unë sigurinë për jetën dhe pasurinë e tyre, nëse janë në pajtim me Islamin. Ndërsa llogarinë e tyre (të brendshme për sinjeritetin) do ta japin përpara Allahut të Madhëruar.”** Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

1 - Në fjalën e Profetit: **“Jam urdhëruar”** Ai që e urdhëron është Allahu, sepse atë nuk mund ta urdhërojë askush përveç Tij. Nëse një sahab thotë se jemi urdhëruar për këtë send, apo jemi ndaluar nga ky send, në këtë rast ai që I urdhëron dhe i ndalon është i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

2 - Në kohën kur i Dërguari i Allahut ndërroi jetë dhe pas tij erdhi Ebu Bekri, atë kohë dezertuan (u larguan nga feja) shumë prej arabëve dhe filluan të mos e japin zekatin. Ebu Bekri vendosi që t'i luftonte, duke u nisur nga fakti që të drejtës që i takon dy dëshmime është edhe dhënia e zekatit. Ai nuk e dinte hadithin ku namazi bashkë me zekatin u bashkangjiten dy dëshmime, siç u tha në këtë hadith. Me Ebu Bekrin debatoi Umeri, dhe ky debat është transmetuar në Sahihun e Muslimit me nr. 20 nga Ebu Hurejra, i cili thotë: **“Kur i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ndërroi jetë dhe pas tij erdhi Ebu Bekri, atë kohë mohoi ai që mohoi prej arabëve prandaj Umer bin Hatabi i tha Ebu Bekrit: “Cila është arsyeja që dëshiron t'i vrasësh njerëzit në një kohë që Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Jam urdhëruar t'i luftoj njerëzit derisa të dëshmojnë se nuk ka të adhuruar të vërtetë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Tij, të falin namazin dhe të japin zekatin. Nëse e bëjnë këtë, ata do të fitojnë nga unë sigurinë**

për jetën dhe pasurinë e tyre, nëse janë në pajtim me Islamin. Ndërsa llogarinë e tyre (të brendshme për singeritetin) do ta japin përpara Allahut të Madhëruar.” Ebu Bekri tha: **“Pasha Allahun, do t’i luftoj ata që bëjnë dallim mes namazit dhe Zekatit sepse Zekati është e drejta që i takon pasurisë. Betohem në Allahun se sikur ata të mos japin qoftë edhe një kapistër (litari që u shkohet kafshëve në qafë për t’i mbajtur ose për t’i tërhequr, fre), duke qenë se e kanë dhënë në kohën e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), unë do t’i luftoj për këtë gjë.”** Kur i dëgjoi Umeri këto fjalë, tha: **“Pas këtyre fjalëve vura re se Allahu ia kishte zgjeruar gjoksin Ebu Bekrit që ta vazhdonte këtë mision, dhe kuptova se kjo ishte e vërteta.”**

Hafidh Ibn Haxheri në librin e tij El Fet’h (1/76) thotë: **“Disa njerëz e quajtën të papranueshme saktësinë e këtij hadithi sepse nëse këtë hadith do ta kishte ditur Ibn Umeri, atëherë nuk do ta lejonte babanë e tij që të polemizonte me Ebu Bekrin rreth njerëzve që nuk po e jepnin zekatin. Po edhe nëse do e kishin ditur, atëherë Ebu Bekri nuk do t’ia pohonte Umerit argumentimin e tij me fjalën e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Jam urdhëruar t’i luftoj njerëzit, derisa të dëshmojnë se nuk ka të adhuruar të vërtetë përveç Allahut”, e të kalonte nga ky argumentim e të merrte shembuj. Sepse ai tha; “do t’i luftoj ata që bëjnë dallim mes namazit dhe Zekatit, sepse Zekati gjithmonë vjen bashkë me namazin në librin e Allahut.”** Kësaj i përgjigjemi duke thënë: **“Nuk është e thënë që hadithi i përmendur të mos ketë qenë në dijen e Ibn Umerit dhe mundet që ai ta ketë kujtuar në ato momente, por edhe nëse ai do e kishte ditur më parë, nuk është e largët mundësia që ai të ketë munguar në debatin që u zhvillua, gjithashtu nuk përjashtohet mundësia që ai t’i ketë vënë në dijeni pas një farë kohe.”** Nga ana tjetër Ebu Bekri për vrasjen e atyre që nuk japin zekatin, nuk u argumentua vetëm me kijas, përkundrazi atë që e tha ai e kishte marrë nga fjala e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) në hadithin që e transmetoi vetë, ku thotë: **“...nëse janë në pajtim me Islamin.”** Pra, Ebu Bekri tha se zekati është e drejtë që i takon Islamit. Gjithashtu, nuk ishte vetëm Ibn Umeri që e transmetoi këtë hadith, përkundrazi atë e ka transmetuar edhe Ebu Hurejra me shtojcat e namazit dhe zekatit, siç do ta sqarojmë më pas në dashtë Allahu në kapitullin e zekatit.

Në këtë ndodhi ka argument se ndodh që një sunet të mos e dinë disa nga sahabët e mëdhenj dhe ta dinë njerëz nga mesi i tyre. Për këtë arsye nuk ia vlen të merremi me ato mendime sado të forta qofshin ato, nëse ekzistojnë sunete që i kundërshtojnë. Nga ana tjetër nuk është e pëlqyeshme të pyetet si

është e mundur që këtë nuk e dinte filani? Vetëm Allahu është ai që jep sukses.”

3 - Nga përgjithësimi i përmendur në hadith- pra që të luftohen derisa të praktikojnë ato që u përmendën në hadith- përjashtohen ithtarët e librave të mëparshëm, të cilët japin taksën (xhizjen). Këtë e themi duke u mbështetur në ajetet kuranore, gjithashtu kjo përfshin edhe të tjerët kur e japin atë (taksën-xhizjen) dhe kjo duke u bazuar në sunetin e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), siç thuhet në hadithin e gjatë të Burejde bin Husajbit që transmetohet në Sahihun e Muslimit me nr. 1 731. Në fillim të tij thuhet: **“Kur i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) caktonte një emir në krye të ushtrisë apo ekspedite, e porosiste veçmas me devotshmëri dhe të sillej mirë me muslimanët që kishte me vete.”**

4 - Dëshmitë i mjaftojnë njeriut për të hyrë në Islam, duke qenë se ato janë detyra e parë që i kërkohet një njeriu. Për këtë arsye, nuk duhet t’ua vëmë veshin fjalëve të skolastikëve, të cilët bazohen në disa gjëra të tjera që kanë lidhje me meditimin, apo vullnetin për të medituar. Ibn Dekik el Ijdi në komentin e këtij hadithi thotë: **“Hadithi pohon qartë medh’hebin e dijetarëve hulumtues dhe shumicës së të parëve dhe të mëvonshmëve, se kur njeriu të besojë bindshëm dhe pa luhatje fenë Islame kjo i mjafton atij dhe nuk është i obliguar që t’i mësojë argumentet e skolastikëve apo ta njohë Allahun përmes tyre.”**

5 - Luftimi i atyre që nuk e japin zekatin kryhet atëherë kur ata nuk e japin dhe luftojnë për këtë gjë, por nëse ai nuk lufton atëherë zekati i merret me forcë.

6 - Fjala e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“Ndërsa llogarinë e tyre (të brendshme për singëritetin) do ta japin përpara Allahut të Madhëruar”,** do të thotë se ai që shfaq Islamin dhe shpreh dy dëshmitë, me këtë gjë ai ka siguruar pasurinë dhe jetën e tij. Nëse ka qenë i singërtë në pamjen e jashtme dhe atë të brendshme kjo do t’i vlejë atij përpara Allahut, por nëse gjendja e brendshme e tij është në kundërshtim me atë që shfaq me hipokrizi, atëherë ai do të jetë në gradën më të ulët në zjarrin e Xhehenemit.

7- Përfitimet që nxjerrim nga hadithi janë:

1 - Urdhërimi për t’i luftuar, derisa të realizohen dy dëshmitë, namazi dhe zekati.

2 - Në termi punë përfshihet edhe i shprehuri, sepse Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) në hadith thotë: **“Nëse ata e veprojnë atë...”**, pra, e tha këtë pasi përmendi dy dëshmitë, të cilat janë shprehje.

3 - Pohimi i llogarisë së veprave Ditën e Gjykimit.

4 - Ai që nuk e jep zekatin luftohet për këtë gjest, derisa ta japë atë.

5 - Ndër ata që e praktikojnë Islamin u pranohet, ndërsa sigëriteti i tij i brendshëm i lihet Allahut.

6 - Lidhja e ngushtë mes dy dëshmitëve dhe se ato duhet të vijnë së bashku.

7 - Vërehet rëndësia e madhe e namazit dhe zekatit. Në këtë rast namazi është e drejta që i përket trupit, ndërsa zekati është e drejta që i takon pasurisë.

09 - Çfarë ua kam ndaluar largohuni prej saj.

Ebu Hurejra AbduRrahman bin Sahri (radijAllahu ‘anhu) transmeton se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) të ketë thënë: **“Ato gjëra që ua kam ndaluar mundohuni të largoheni prej tyre, ndërsa për ato që ua kam urdhëruar mundohuni t’i praktikoni sa të mundeni. Arsyeja që i shkatërroi popujt që jetuan para jush ishin pyetjet e shumta dhe kundërvëniet ndaj peygamberëve.”** Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

1 - Këtë hadith e transmetuan dy dijetarët Buhariu dhe Muslimi, por me këto fraza ai gjendet në Sahihun e Muslimit në kapitullin e vlerave me nr. 1 737. Arsyeja e transmetimit të këtij hadithi është trajtuar në kapitullin e Haxhit, në hadithin e transmetuar nga Ebu Hurejra, i cili thotë: **“Një ditë, i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) na mbajti një fjalim dhe me atë rast tha: “O njerëz! Vërtet Allahu ua ka bërë obligim Haxhin, prandaj kryejeni atë.”** Një i pranishëm pyeti: **“për çdo vit o i Dërguari i Allahut?”** I Dërguari i Allahut heshti, ndërsa pyetësi e përsëriti pyetjen e tij tri herë. Atëherë i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) tha: **“Sikur të thoja “Po”, atëherë sigurisht që do të mbetej obligim i domosdoshëm për çdo vit dhe ju nuk do të kishit mundësi. Pastaj tha: “Më lini për aq sa u lë, sepse arsyeja që i shkatërroi popujt që jetuan para jush ishin pyetjet e shumta dhe kundërvëniet që u bënë profetëve të tyre. Kur t’ju urdhëroj për diçka bëjeni sa të keni mundësi, por kur t’ju ndaloj nga diçka atëherë lëreni.”**

2 - Në fjalët e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“Largohuni prej punëve që ju kam ndaluar, ndërsa për punët që ju kam urdhëruar mundohuni t’i praktikoni sa të mundeni.”** vërejmë kufizimin e praktikimit të urdhrave, atëherë kur ekziston mundësia, ndërsa tek e ndaluara nuk e vërejmë diçka të tillë. Kjo ndodh sepse ndalimi përfshihet në veprat që duhen braktisur e që janë të mundshme. Njeriu i ka mundësitë që të mos e bëjë diçka, ndërsa urdhëri në hadith u kufizua me mundësinë sepse ai angazhohet me veprim, të cilin mund, por edhe nuk mund ta praktikojë. Prandaj urdhrat vijnë sipas mundësisë së njeriut si p.sh. kur alkooli u bë i ndaluar, në këtë rast ai e ka të mundur që të mos e pijë atë. Ndërsa namazi është diçka e urdhëruar dhe njeriu e fal atë sipas mundësive që ka; duke qëndruar në këmbë ose ulur, nëse nuk ka mundësi edhe shtrirë. Këtë që thamë e shpjegon shumë lehtë një shembull konkret: **“Nëse një njeriu i thuhet: “Mos u hyr nga kjo derë!”**, në këtë rast, ai mund të mos hyjë sepse është diçka që duhet të mos e bëjë. Por nëse i thuhet: **“Ngije këtë gur!”**, në këtë rast ai mundet ta ngrejë, por edhe mund të mos e ngrejë.

3 - Braktisja e veprave të ndaluara mbetet diçka e përgjithësuar dhe nuk veçohet asgjë prej tyre, duke përjashtuar rastet kur e kërkon nevoja, siç është ngrënia e mishit të ngordhur për të mbijetuar, apo rasti kur dikush mbytet me ushqim dhe nuk gjen aty afër diçka tjetër veç alkoolit.

4 – Veprat e ndaluara, prej të cilave duhet të distancohemi kanë të bëjnë me haramin, ndërsa veprat e urryera janë të lejuara që të praktikohen, edhe pse më e mirë është braktisja sesa praktikimi i tyre.

5 – Veprat me të cilat urdhërohet njeriu duhet t’i praktikojë sipas mundësisë së tij sepse Allahu nuk e ngarkon askënd përtej mundësive të tij. Prandaj nëse ai nuk ka mundësi që një vepër ta kryejë në mënyrën më të plotë, atëherë praktikon atë që është e mundur për të. Kështu që, nëse nuk mundet të falet në këmbë, mund të falet i ulur, e nëse nuk mundet ta praktikojë një detyrim në formën e plotë atëherë bën atë që mundet. Nëse nuk ka ujë të mjaftueshëm për të marrë abdes, në këtë rast ai mer abdes me aq ujë sa ka dhe merr tejemum për ato pjesë që i mbeten. E nëse nuk mundet të nxjerrë një okë **(Oka’ është njësi e vjetër mase që vlerësohet sa 40 derhem argjendi. (Sh.p.))** për zekatin e fitrit, atëherë mund të nxjerrë aq sa ka mundësi.

6 - Fjalët e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“Ajo që i shkatërroi popujt që jetuan para jush ishin pyetjet e shumta dhe kundërvëniet që u bënë pejgamberëve.”** Ajo që ndalohet në hadith ka të bëjë me çështjet që ekzistojnë në kohën e tij, mbi të cilat ndodhte ndalimi i një sendi për shkak të pyetjes së

tij. Apo kur u obligohej diçka që kishte vështirësi të madhe, e cila nuk mund të përballohet, siç është Haxhi për çdo vit. Ndërsa punët që ndalohen pas kohës së tij janë të dhënit pas atyre veprave që përmbajnë teprime dhe ekstremizëm, kundrejt punëve që kanë më shumë rëndësi se ato.

7 - Ibn Rexhebi në librin e tij Xhamiul Ulumi uel Hikem (1/248-249) thotë: “Njerëzit në këtë temë janë ndarë në disa grupe: Ndër ata që pasuan ehli hadithin kishte njerëz që e mbyllën derën e pyetjeve, deri në atë masë sa fikhu dhe dija e tyre u kufizua vetëm në çështjet që Allahu i ka zbritur Profetit të Tij, duke u bërë në këtë mënyrë bartës të fikhut, por jo dijetarë të mirëfilltë të fikhut. Ndërsa prej juristëve të ehli ra'jit **(Ato janë ithtarët e mendimeve individuale, skolastikët. (Sh. p.))** kishte që u zgjeruan shumë në gamën e pyetjeve para se të ndodhnin ato, çfarë mund të ndodhë realish dhe çfarë nuk mund të ndodhë. Ata u angazhuan në dhënien e përgjigjeve të këtyre pyetjeve, i shtuan debatet dhe kundërshtimet rreth tyre, ku si rrjedhojë lindi përçarja e zemrave dhe për shkak të kësaj përçarjeje mbetën epshet, zilitë dhe armiqësitë, të cilat shpesh përzihen me ndjenjën e triumfimit dhe mendjemadhësisë, në mënyrë që fytyrat e njerëzve të shkojnë drejt tyre. Këtë gjë e kanë qortuar dijetarët lektorë dhe Suneti ka urdhëruar për ndalimin e të keqes.

Ndryshe janë dijetarët e hadithit që punojnë me të **(hadithin)**, brenga më e madhe e tyre është kërkimi në kuptimet e librit të Allahut të Madhëruar dhe gjetjen haditheve të sakta që e qartësojnë atë, si dhe fjalë komentuese të transmetuara nga sahabët dhe tabiinëve. Gjithashtu hulumtojnë rreth Sunetit të të Dërguarit të Allahut, duke dalluar të saktin nga i pasakti, më pas duke i kuptuar ato dhe duke i mësuar kuptimet e tyre. Pas kësaj, ata kërkojnë në fjalët e sahabëve dhe tabiinëve, mes llojeve të ndryshme të njohurive që kanë të bëjnë me tefsirin, hadithin dhe çështjet e hallallit dhe haramit, bazat e Sunetit, zuhdin **(Asketizmi)**, rakaik **(Këshilla zbutëse për zemrën)** etj. Kjo ishte rruga që ndoqi imam Ahmedi dhe dijetarët e tjerë të hadithit. Angazhimi me këto që përmendëm **(Kuran dhe Hadith)** është i mjaftueshëm dhe jo të merresh me çfarë u shpik nga ehlu ra'ji, gjëra që nuk kanë dobi dhe që nuk ndodhin në të vërtetë.

Fjalët e tepërta janë ato që nxisin polemikat dhe armiqësitë. Imam Ahmedi, shpesh kur pyetej për gjëra të reja që akoma nuk ishin vërtetuar, shprehej: **“Mos na ngatërmoni me këto gjëra të shpikura!”** Më pas vijonte: “Ai që ndjek rrugën e kërkimit të diturisë sipas asaj që përmendëm, e ka të mundur të kuptojë përgjigjet e duhura që kanë të bëjnë me rastet që ndodhin në realitet shpesh - herë, sepse bazat e tyre burojnë nga ato që përmendëm **(Kurani dhe Hadithi)**. Gjithashtu, këtë rrugë ndoqën imamët: Shafiu, Ahmedi, Is'haku, Ebu

Ubejdi, e të tjerët që ndoqën rrugën e tyre, për të cilët është rënë dakord për udhëzimin dhe dijen e tyre. Cilido që pretendon se ndjek këtë rrugë, duke mos ecur në gjurmët e tyre, ai do të bjerë në humnerë dhe shkatërrim, do të marrë fjalë **(mendime)** që nuk i lejohen t'i marrë dhe do të lërë fjalë **(mendime)** që i ka të detyrueshme t'i praktikojë. Ajo që e përmbledh të gjithë këtë është: që ai të ketë si synim arritjen e kënaqësisë së Allahut dhe afrimin tek Ai, të njohë atë që i zbriti Profetit të Tij (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), të ndjekë rrugën e tij, ta praktikojë atë dhe t'i thërrasë njerëzit në këtë gjë. Kush është i tillë, Allahu do t'i japë sukses dhe do ta udhëzojë, do t'i tregojë rrugën e drejtë dhe do t'i mësojë gjëra që nuk i ka ditur. Si rrjedhojë ai do të jetë ndër dijetarët e lavdëruar, të cilët Allahu i përmend në librin e Tij duke thënë: **“Në të vërtetë, nga robërit e Tij Allahut i frikësohen vetëm dijetarët.”** (Suretu Fatir, 28) Ata që ishin të palëkundshëm në dijen e tyre.”

Imam Ahmedi ka thënë: **“Në përgjithësi, ai që praktikon urdhëresat e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) në këtë hadith dhe largohet ndalesat, shqetësohet për këtë gjë dhe jo për gjëra të tjera, ai fiton shpëtimin në këtë botë dhe në botën tjetër. Ndërsa ai që kundërshton dhe jepet pas logjikës së vet dhe veprave që ai i quan të mira, bie pre e asaj që i Dërguari i Allahut ka kritikuar kur tregon për gjendjen e ithtarëve të librit, të cilët u shkatërruan si pasojë e pyetjeve të shumta dhe kundërvënieve që u bënë profetëve me mosbindje.”**

8 - Përfitime të nxjerra nga ky hadith janë:

- 1 - Domosdoshmëria e braktisjes së çdo gjëje që ka ndaluar Allahu dhe i Dërguari i Tij (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem).
- 2 - Domosdoshmëria e praktikimit të çdo gjëje që ka obliguar Allahu dhe i Dërguari i Tij (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem).
- 3 - Qortimi për të mos rënë në atë humnerë që ranë ithtarët e librit, gjë që shkaktoi shkatërrimin e tyre.
- 4 - Njeriu nuk obligohet me më shumë se mundësitë që ka.
- 5 - Dikush që e ka të pamundur të praktikojë plotësisht një obligim, mund të praktikojë aq sa ka mundësi.
- 6 - Mësojmë se njeriu duhet të pyesë për gjërat që i nevojiten, të shmanget nga interesimi për gjëra të tepërta dhe stërhollimet e panevojshme në pyetje.

10 - Allahu është i mirë dhe nuk pranon diçka tjetër veç të mirës.

Ebu Hurejra (radijAllahu ‘anhu) transmeton se i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Vërtet Allahu është i Mirë dhe nuk pranon vetëm se vepra të mira. Ai i ka urdhëruar besimtarët, ashtu sikurse i pati urdhëruar të Dërguarit. Allahu i Madhëruar thotë: **“O ju të dërguar! Hani gjërat e mira (hallall) dhe punoni mirë.”** Gjithashtu ka thënë: **“O ju që besoni, hani gjërat e mira (hallall) të cilat ua kemi dhënë.”** Më pas, Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) përmendi një njeri, i cili udhëtoi shumë, me flokë të shprishura (i pakrehur) e të pluhurosura e që drejtonte duart nga qielli duke thënë: **“O Zot, o Zot! Në një kohë kur është ushqyer me haram, ka pirë haram, është veshur me haram dhe ka punuar me haram. (Një njeriu të tillë) Si mund t’i pranohet lutja?!”** Transmeton Muslimi.

1 - Fjalët e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“Vërtet Allahu është i Mirë dhe nuk pranon vetëm se vepra të mira”**, pohojnë se prej emrave të Allahut është dhe emri Et Tajib (**i Mirë**) dhe se Allahu i pranon ato punë që janë të cilësuar si të mira. Kjo përfshin të gjitha llojet e punëve ku prej tyre është dhe fitimi. Prandaj njeriu duhet të kryejë vetëm vepra të mira, të fitojë vetëm të mira (hallall) dhe të shpenzojë vetëm prej fitimeve të mira.

2 - Fjalët e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Ai i ka urdhëruar besimtarët, ashtu sikurse i pati urdhëruar të Dërguarit. Allahu i Madhëruar thotë: **“O ju të dërguar! Hani gjërat e mira (hallall) dhe punoni mirë.”** Gjithashtu ka thënë: **“O ju që besoni, hani gjërat e mira (hallall) të cilat ua kemi dhënë.”** Në këto dy ajete Allahu i urdhëron të Dërguarit dhe ata, tek të cilët u dërguan profetët që të ushqehen me të mirat (**hallall**). Ashtu sikurse profetët që ushqehen vetëm me të mirën (**hallallin**), të njëjtën gjë duhet të bëjnë edhe ndjekësit e tyre, pra duhet të ushqehen vetëm me të mirën (**hallallin**).

3 - Fjalët e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Më pas Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) përmendi një njeri, i cili udhëtoi shumë, me flokë të shprishura (i pakrehur) e të pluhurosura, që drejtonte duart nga qielli duke thënë: **“O Zot, o Zot! Në një kohë kur është ushqyer me haram, ka pirë**

haram, është veshur me haram dhe ka punuar me haram. (Një njeriu të tillë) Si mund t'i pranohet lutja?!" Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) shpjegon se Allahu nuk pranon vetëm se të mirën dhe se të Dërguarit dhe besimtarët u urdhëruan që të ushqehen nga të mirat (hallalli), pas kësaj shpjegoi gjendjen e disa njerëzve që e kundërshtojnë këtë rrugë, ndërkohë që ushqimin nuk e kanë të mirë (hallall). Përkundrazi, ata kthehen dhe mundohen ta fitojnë haramin, duke e përdorur në të gjitha aspektet e jetës, në ushqim dhe në veshje. Kjo (të ushqyerit me haram) shkaktonte mospranimin e lutjes së tij, megjithëse në pamje të parë shkaqet për të cilat të pranohet lutja ishin të pranishme, si psh: udhëtimi i gjatësinë, gjendja e tij me flokë të pakrehur dhe i pluhurosur, zgjatja e duarve të tij gjatë lutjes, si dhe lutja që ai i bën Allahut në madhështinë e Tij, shtoi kësaj dhe angazhimin e tij të plotë duke i përsëritur fjalët. E megjithatë fjala e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): **"Si mund t'i pranohet lutja?!"** nënkupton pamundësinë e pranimit të lutjes përderisa ekzistojnë arsyet (ushqyerja me haram) që e ndalojnë pranimin e saj.

4 - Përfitimet që mund të përmendim:

- 1 - Et Tajib (**i Mirë**) është një ndër emrat e Allahut dhe do të thotë **"i Pastër"** nga të metat. Gjithashtu, prej cilësive të Tij është dhe e mira sepse prej të gjithë emrave të Allahut nxirren dhe pohohen attribute të Tij.
- 2 - Muslimani duhet të veprojë mirë dhe të fitojë në mënyrë të ndershme.
- 3 - Sadakaja pranohet vetëm kur është nga pasuria hallall. I Dërguari i Allahut (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: **"Allahu nuk e pranon namazin pa abdes, gjithashtu nuk e pranon sadakanë e atij që e jep nga malli i zaptuar."** (E transmeton Muslimi me nr. 224)
- 4 - Allahu i Madhëruar u ka dhënë njerëzve shumë të mira dhe i ka urdhëruar që të ushqehen me ushqime të mira (**hallall**).
- 5 - Të ushqyerit me haram çon në mospranimin e lutjes.
- 6 - Një prej arsyeve që çojnë në pranimin e duasë është udhëtimi dhe gjendja e njeriut kur lutet, duke qenë i pakrehur dhe i pluhurosur.
- 7 - Gjithashtu ndër arsyet është edhe ngritja e duarve gjatë duasë.
- 8 - Drejtimi nëpërmjet emrave të Allahut.

Prej këtyre arsyeve është dhe këmbëngulja deri në plotësimin e duasë (**me qëllim që Allahu t'i përgjigjet asaj**).

11 - Largoju të dyshimtës dhe përmbaju asaj që nuk është e dyshimtë.

Ebu Muhamed Hasen bin Ali bin Ebi Talibi (radijAllahu ‘anhu), nipi dhe trëndafili i të Dërguarit të Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), transmeton duke thënë: “Kam mbajtur mend nga i Dërguari i Allahut se ai ka thënë: **“Lëre atë që të duket e dyshimtë (qoftë hallall, apo haram; e dobishme, apo e dëmshme), dhe pranoje atë që nuk të duket e dyshimtë!”** Transmeton Tirmidhiu dhe Nesaiu. Tirmidhiu tha se ky hadith është hasen (i mirë) sahih (i saktë).

1 - Ky hadith na urdhëron që njeriu të largohet nga veprat që i sheh të dyshimta, tek të cilat nuk gjen qetësi në shpirtin e tij, e si rrjedhojë ngushtohet dhe tundohet në shpirt, për të shkuar drejt atyre veprave, tek të cilat zemra i qetësohet dhe shpirti i rehatohet. Ky hadith ngjason me hadithin e mëparshëm të Numan bin Beshirit ku thuhet: **“Ai që ruhet nga gjërat e dyshimta, me këtë veprim ka ruajtur fenë dhe nderin e tij. Ndërsa ai që bie në veprimin e të dyshimtave, si rrjedhojë bie në vepra të ndaluara (harame).”** Të dyja këto hadithe tregojnë se një njeri që do të ruhet duhet të largohet nga konsumimi i ushqimeve që janë të dyshimta, ashtu sikurse e ka të ndaluar të ushqehet me ushqime haram.

2 - Ibn Rexhebi në librin e tij Xhamiul Ulumi uel Hikem (1/280) thotë: **“Kuptimi i këtij hadithi konsiston në largimin nga të dyshimtat dhe ruajtjen e vetes prej tyre. Duke qenë se për haramin e mirfilltë besimtari nuk ka dyshime në zemrën e tij (dyshimi është në kuptimin e ngushtimit dhe tundimit), përkundrazi, zemra dhe shpirti i tij mbeten të qetë. Ndërsa me dyshimet, zemrat ngushtohen dhe tundohen, si pasojë e dyshimit që ndodhet në to.”** Në një pjesë tjetër (1/283) ai shprehet: **“Këtu mbetet diçka që duhet kuptuar mirë: investigimi i imtësishëm në ndalimin nga të dyshimtat vlen për atë nivel besimtari që i ka të përmirësuarat të gjitha aspektet e tjera, e që i janë përzier punët me devotshmërinë dhe frikë - respektin që posedon. Ndërsa për atë besimtar që bie në kryerjen e harame të qarta, e më pas kërkon të ruhet nga imtësitë e të dyshimtave, kjo nuk është e pranueshme.”** Për këtë gjë ai duhet të kritikohet, siç u ka thënë Ibn Umeri banorëve të Irakut, të cilët e pyetën për gjakun e mushkonjës,

duke u thënë: **“Më pyesin për gjakun e mushkonjës ndërkohë që kanë vrarë Husejnin!”** Unë e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) duke thënë: **“Ata të dy (Hasani dhe Husejni) janë dy të ëmbëlit e mi në këtë botë.”**

3 - Përfitimet që nxjerrim nga ky hadith janë:

1 - Braktisja e veprave të dyshimta dhe kryerja e veprave që nuk mbartin dyshime.

2 - Braktisja e veprave të dyshimta e qetëson shpirtin dhe e ruan atë nga çdo preokupim.

12 - Nga Islami i mirë i njeriut.

Ebu Hurejra (radijAllahu ‘anhu) transmeton se i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Një prej cilësive të mira të një besimtari musliman është kur nuk ndërhyt në atë që nuk i intereson.”** Hadithi është saktë, atë e transmeton Tirmidhiu dhe të tjerë, po në këtë mënyrë.

1 - Ky hadith konsiston në atë që muslimani duhet t’u largohet veprave që nuk i interesojnë, qoftë në çështjet e fesë, qoftë në ato të dynjasë, apo qoftë në fjalë, qoftë në vepra. Nga ana tjetër, kuptojmë se ai duhet të përpiqet të angazhohet në vepra që i interesojnë.

2 - Ibn Rexhebi në librin e tij Xhamiul Ulumi uel Hikem (1/288-289) thotë: “Kuptimi i këtij hadithi është se një besimtar i mirë, nuk duhet të ndërhyjë në gjërat që nuk i përkasin, qofshin ato fjalë, apo vepra. Në këtë mënyrë ai tregon interes vetëm për ato fjalë, apo vepra që i interesojnë. Fjala intereson i referohet kujdesit të madh për diçka, duke e kthyer në qëllimin dhe kërkimin e tij kryesor, në kuadër të gjykimit legjislativ të Islamit. Për këtë arsye ai e konsideroi besimtar të mirë, sepse kur përmirësohet Islami i një njeriu atëherë ai e lë atë që nuk i intereson në Islam prej fjalëve dhe veprave. Duhet ditur se Islami kërkon zbatimin e urdhrave, siç e kemi përmendur në shpjegimin e hadithit të Xhibrilit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe se Islami i plotë e i lavdëruar përmban braktisjen e veprave të ndaluara, ashtu sikurse thotë i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“Musliman është ai, dora dhe gjuha e të cilit nuk lëndon muslimanët e tjerë.”** Pra, kur Islami i tij përmirësohet, atëherë kjo kërkon prej tij që të braktisë gjithçka që nuk i intereson prej veprave të ndaluara, të dyshimta dhe veprave të urryera, po ashtu edhe teprimi në veprat e lejuara, të cilat nuk janë të nevojshme. Të gjitha

këto nuk duhet t'i interesojnë muslimanit, nëse Islami i tij përmirësohet dhe arrin gradën e ihsanit, që do të thotë ta adhurojë Allahun sikur e sheh Atë, edhe pse nuk e sheh, Allahu e shikon atë. Ndaj, kush e adhuron Allahun, duke ndier afërsinë e Tij e duke e parë me zemrën e tij, apo duke ndier afërsinë dhe mbikëqyrjen e Allahut, me këtë Islami i tij është përmirësuar. Si rrjedhim, besimtarit i kërkohet të braktisë çdo veprër që nuk i intereson në Islam dhe të merret me veprat që i interesojnë. Nga këto dy shkallë lind ajo ndjenjë që quhet turpërimi nga Allahu dhe braktisja e çdo vepre, prej së cilës njeriu turpërohet.”

3 - Përfitimet e nxjerra nga hadithi janë:

- 1 - Njeriu duhet të largohet nga veprat që nuk i interesojnë, si në fe, ashtu edhe në çështjet e kësaj bote.
- 2 - Njeriu duhet të angazhohet me veprat që i interesojnë në fenë dhe jetën e tij.
- 3 - Braktisja e punëve që nuk të interesojnë janë rehati për shpirtin, ruajtje e kohës dhe e nderit tënd.
- 4 - Njerëzit janë në grada të ndryshme në Islam.

13 - Nuk beson ndonjëri prej jush derisa të dojë për vëllain e tij atë që do për vete.

Ebu Hamza Enes bin Malik (radijAllahu ‘anhu), shërbëtori i të Dërguarit të Allahut, transmeton se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Askush nga ju nuk beson, derisa të dëshirojë për vëllanë e tij atë që dëshiron për vete.”** Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

- 1 - Në këtë hadith Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ia mohon besimin e plotë të detyrueshëm një muslimani, derisa ai të dojë për vëllanë e tij atë që do për vete. Ky kusht ka të bëjë me çështjet e dynjasë dhe të ahiretit. Këtu përfshihet edhe sjellja e tij me njerëzit, ashtu siç dëshiron që njerëzit të sillen me të. Abdullah bin Amr bin Asi transmeton një hadith të gjatë në Sahihun e Muslimit me nr. 1 844: **“Kush dëshiron t'i largohet zjarrit le ta gjejë vdekja duke besuar te Allahu dhe bota tjetër dhe le t'iu japë njerëzve atë që dëshiron t'i japin atij.”** Allahu i Madhëruar në librin e Tij thotë: **“Mjerë për ata që hanë në peshë (dhe matje), të cilët kur matin për vete e marrin**

masën të plotë, ndërsa kur u matin të tjerëve me litër ose me kandar ua pakësojnë.” (Suretu Mutaфин, 1,3)

2 - Hafidh Ibn Rexhebi në librin e tij Xhamiul Ulumi uel Hikem (1/306) thotë: **“Hadithi i Enesit pohon se besimtarin duhet ta gëzojë ajo që e gëzon vëllanë e tij besimtar dhe të dojë për të, atë të mirë që dëshiron për veten e tij. E gjithë kjo arrihet kur zemrat janë të ruajtura nga mllefi, dredhia dhe zilia. E themi këtë sepse zilia e shtyn njeriun të urrejë faktin që dikush të jetë më sipër se ai për ndonjë vepër të mirë, apo që të jetë në një gradë me të. Ai kërkon të dallohet nga të tjerët me vlerat e tij dhe të veçohet nga të gjithë me këto vlera, ndërsa imani kërkon të kundërtën; kërkon që të gjithë besimtarët ta shoqërojnë atë në mirësitë që i ka dhuruar Allahu pa i lënë mangët asgjë.”** Në një vend tjetër (1/308) ai shprehet kështu: **“Në përgjithësi besimtarit i kërkohet që të dojë për besimtarët, atë që do për veten e tij dhe të urrejë për ta, atë që urren për veten e tij. Për këtë arsye, nëse vëren tek vëllai i tij ndonjë të metë duhet të angazhohet në përmirësimin e saj.”**

3 - Përfitimet e nxjerra nga hadithi janë:

1 - Besimtari duhet të dojë për vëllanë e tij atë që do për vete dhe të urrejë atë që urren për veten e tij.

2 - Kusht për të arritur këtë gradë është se atij i mohohet besimi i plotë i domosdoshëm, derisa të jetë i tillë.

3 - Besimtarët janë në shkallë të ndryshme në besimin e tyre.

4 - Përdorimi i fjalës **“vëllanë e tij”** është formë zbutëse për muslimanin, në mënyrë që të bëjë për vëllanë e tij atë që i kërkohet.

14 - Nuk lejohet gjaku i muslimanit përveç në tre raste.

Abdullah bin Mesudi (radijAllahu ‘anhu) transmeton se i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Nuk lejohet të derdhet gjaku i muslimanit, veçse në tri raste: Kur i martuari bën imoralitet, vrasësi dhe ai që lë fenë e tij, duke u ndarë nga bashkësia e muslimanëve.”**

Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

1 - Me fjalët e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) **“Kur i martuari bën imoralitet”**, kemi parasysh dënimin që merret me gurëzim. Kjo është saktësuar në Sunetin e të Dërguarit të Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe po këtë gjë pohon ajeti ku përmendet gurëzimi, ajet i cili është anuluar (në leximin e tij) por që ka mbetur e vlefshme dispozita e tij.

2 - Fjala e Profetit; vrasësi, nënkupton kur ekzekutohet vrasësi nëpërmjet hakmarrjes, siç thotë Allahu i Madhëruar në librin e Tij: **“O besimtarë! Është caktuar për ju kisasi për vrasje.”** (Suretu Bekare, 178) Gjithasthu, ka thënë: **“Në ligjin e barazisë në ndëshkim ka siguri për jetën tuaj.”** (Suretu Bekare, 179)

3 - Në fjalët e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem); **“Ai që lë fenë e tij, duke u ndarë nga bashkësia e myslimanëve”** kemi parasysh dezertorin, duke u bazuar edhe në hadithin tjetër ku i Dërguari i Allahut thotë: **“Ai që ndërron fenë, vriteni!”** (E transmeton Buhariu me nr. 3 017)

4 - Hafidh Ibn Rexhebi përmendi ekzekutimin e një grupi tjetër njerëzish që nuk janë përmendur në këtë hadith. Ai përmendi ekzekutimin për homoseksualët, atyre që kryejnë marrëdhënie intime me të afërmit (**inçest**) që e kanë të ndaluar të martohen me ta, për magjistarin, për atë që kryen marrëdhënie me kafshën, për atë që lë namazin, për atë që pi alkoolin për herë të katërt, për vjedhësin për herë të pestë, për vrasjen e njërit nga dy prijësit që ndodhen në besë, apo për ata që zhveshin armët, për spiunin, për muslimanin që spiunon te mohuesit, kundër muslimanëve, etj.

5- Përfitimet e nxjerra nga hadithi janë:

1 - Nderi i gjakut të muslimanit, duke përjashtuar njërin nga tri rastet që u përmenden në hadith.

2 – Bashkëshorti që bën imoralitet, vritet duke u gurëzuar.

3 - Ai që vret me vetëdije, vritet nëse plotësohen kushtet e hakmarrjes.

4 - Dezertori që largohet nga Islami vritet, qoftë burrë, qoftë grua.

15 - Kush i ka besuar Allahut dhe Ditës së Fundit le të flasë mirë.

Ebu Hurejra (radijAllahu ‘anhu) transmeton se I Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Kush beson Allahun dhe Ditën e Fundit, nëse do të flasë le te flasë mirë ose në të kundërt le të heshtë!. Kush beson Allahun dhe Ditën e Fundit duhet të respektojë fqinjin e tij. Kush beson Allahun dhe Ditën e Fundit duhet të respektojë musafirin e tij.”**

Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

1 - Në këtë hadith i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) vuri kusht besimin te Allahu dhe besimin në botën tjetër për kryerjen e këtyre tri urdhëresave, duke qenë se besimi te Allahu është bazë për çdo send. Çdo gjë për të cilën urdhërohem i t’i besojmë, i kthehet dhe ndjek besimin në Allahun. Ndërsa besimi në Ditën e Fundit na përkujton kthimin dhe shpërblimin e punëve: nëse janë të mira me të mira, e nëse janë të këqija me të këqija.

2 - Fjalët e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“Kush beson Allahun dhe Ditën e Fundit, nëse do të flasë le te flasë mirë ose në të kundërt le të heshtë!”** janë gjithëpërfshirëse. Ndër kuptimet që marrin këto fjalë esenciale të Profetit kërkohet ruajtja e gjuhës nga fjalët, përveç fjalëve të mira. Neveviu në komentin e këtij hadithi thotë: **“Shafiu (RahimehUllah) ka thënë: “Kuptimi i hadithit është se; kur një njeri kërkon të flasë le të ndalet e të mendojë. Nëse vëren se kjo nuk i sjell dëm, atëherë le të flasë, por nëse vëren se kjo i sjell dëm, apo kur dyshon, në këtë rast ai duhet të heshtë. Imami i shquar Ebu Muhamed bin Ebi Zejd, imami i Malikive në kohën e tij në Marok, ka thënë: “Të gjitha virtytet e mira degëzohen nga katër hadithe: Në fjalën e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) që thotë: “Kush beson Allahun dhe Ditën e Fundit, të flasë mirë ose le të heshtë” dhe në fjalën e tij ku thotë: “Një nga cilësitë e mira të një besimtari musliman është kur nuk ndërhyr në atë që nuk i intereson.” Gjithashtu, fjala e tij kur e këshillon njërin nga sahabët me një këshillë të shkurtër, duke i thënë: “Mos u zemëro”, si dhe fjala e tij kur thotë: “Askush nga ju nuk beson, derisa të dëshirojë për vëllanë e tij atë që dëshiron për vete.”** Pas kësaj, Neveviu

transmeton një thënie që përdorej shpesh nga disa: **“Sikur t’u blinit nxënësve fletore, atëherë do heshtnit nga shumë fjalë.”**

3 - E mira është emër, të cilit i kundërvihet e keqja. E mira vjen edhe në trajtën e pashquar Hajër (**mirësi**) dhe mes tyre Allahu i Madhëruar ka bashkuar në një ajet Kuranor duke thënë: **“O Profet! Thuaju robërve që gjenden në duart tuaja: Nëse Allahu gjen mirësi në zemrat tuaja, do t’ju japë diçka edhe më të mirë nga ajo që u është marrë.”** (Suretu Enfal, 70)

4 - Në fjalët e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“Kush beson Allahun dhe Ditën e Fundit të respektojë fqinjin e tij”**, tregohet se sjellja me fqinjin është nga detyrimet më të kategorike. Për këtë fakt kanë ardhur shumë hadithe që këshillojnë për respektimin e fqinjit, si dhe kërcënojnë nga lëndimi dhe dëmtimi i tij. Një prej këtyre haditheve është edhe hadithi i Aishes (radijAllahu ‘anha), e cila transmeton se i Dërguari i Allahut ka thënë: **“Xhibrili (‘alejhis-selam) më porositi aq shumë për fqinjin sa kujtova se do ta bënte pjesëtar në trashëgimi.”** (E transmeton Buhariu me nr. 6 014 dhe Muslimi me nr. 2 624) Gjithashtu është hadithi ku i Dërguari i Allahut thotë: **“Pasha Allahun! Nuk beson ai...! Pasha Allahun nuk beson ai ...! Pasha Allahun nuk beson ai ...!”** Shokët e tij e pyetën - **“Kush është ky o i Dërguari i Allahut?”** Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) tha: **“Ai, fqinji i të cilit i trembet së keqes që vjen prej tij.”** (E transmeton Buhariu me nr. 6 016 dhe Muslimi me nr. 73) Nderimi i fqinjit bëhet duke i ofruar çdo mirësi dhe duke e ruajtur nga çdo e keqe. Fqinjët ndahen në tri grupe:

01 - Fqinji musliman, me të cilin ke afërsi gjaku dhe me të ke tri detyrime: fqinjësinë, afërsinë dhe Islamin.

02 - Fqinji musliman, me të cilin nuk ke afërsi gjaku, por tek ai ke detyrimet e Islamit dhe të fqinjësisë.

03 - Fqinji jomusliman, me të cilin nuk ke afërsi gjaku, por me të ke vetëm detyrimin e fqinjësisë.

Fqinji që meriton nga ti më shumë nderim dhe respektim është më i afërti nga shtëpia jote, duke qenë se vetëm ai vëren të mirat që hyjnë në shtëpinë e fqinjit të tij dhe pret që ajo mirësi t’i vijë edhe atij.

5 - Fjalët e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“Kush beson Allahun dhe Ditën e Fundit të respektojë mysafirin e tij”**, tregojnë se respekti ndaj mysafirit është detyrim i ndërsjelltë mes muslimanëve dhe hyn në virtytet e larta. Në Sahihun e Buhariut me nr. 6 019, Ebu Shurejhi transmeton: “E kanë

dëgjuar veshët e mi dhe e kanë parë sytë e mi Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) kur thoshte: **“Kush beson Allahun dhe Ditën e Fundit duhet të respektojë fqinjin e tij! Kush beson Allahun dhe Ditën e Fundit të respektojë mysafirin e tij duke i dhënë shpërblimin e tij!”** Të pranishmit i thanë: **“Cili është shpërblimi i tij o i Dërguari i Allahut?”** Ai iu përgjigj: **“Ta mbajë një ditë dhe një natë, sepse miqësia është tri ditë, ndërsa ditët e tjera quhen sadaka për të.”**

6 - Përfitimet e nxjerra nga hadithi janë:

- 1 - Nxitja që i duhet dhënë besimtarëve që kur flasin të flasin për vepra të mira.
- 2 - Nxitja që duhet bërë për të heshtur, nëse e folura nuk ka dobi.
- 3 - Gjatë nxitjes dhe kërcënimit të besimtarit nga një vepër, është mirë që të përmendet Dita e Gjykimit, sepse atë ditë do të bëhet llogaria e veprave.
- 4 - Inkurajimi për respektimin e fqinjit dhe qortimi për cenimin e tij.
- 5 - Nxitja për të respektuar mysafirin dhe për ta nderuar atë.

16 - Mos u zemëro.

Ebu Hurejra (radijAllahu ‘anhu) transmeton se një burrë erdhi te Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe i tha: **“Më këshillo!”** I Dërguari i Allahut i tha: **“Mos u zemëro!”** Ai e përsëriti disa herë kërkesën e tij, ndërsa i Dërguari i Allahut i përgjigjej: **“Mos u zemëro!”** Transmeton Buhariu.

1 - Hafidh Ibn Haxheri në librin e tij **“Fet’hul Bari”** (10/520) thotë se Hatabi ka thënë: **“Fjala mos u zemëro do të thotë të largohesh nga shkaqet që sjellin zemërimin dhe mos i kërko gjërat që e nxisin atë. Ndërsa zemërimi në vetvete nuk është diçka e ndaluar, por është diçka e natyrshme që nuk mund t’i largohet njeriut.”**

Në një pjesë tjetër ai shprehet: **“Ibn Tini ka thënë: “I Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) në fjalën e tij mos u zemëro përzgjedhi mes të mirës së dynjasë dhe ahiretit, duke qene se zemërimi shpie në shkëputjen e lidhjeve mes njerëzve dhe largon çdo lloj butësie, e nganjëherë, shkon deri aty, sa i zemëruari të lëndojë njerëzit, gjë e cila cenon fenë.”**

2 - Allahu i Lartësuar i ka lavdëruar njerëzit që e përmbajnë veten nga zemërimin, si dhe ata që i falin njerëzit. Ndërsa i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) na ka lajmëruar duke thënë: **“Nuk është i fortë ai që mund**

të tjerët, por i fortë është ai që përmban veten kur zemërohet.”

(Transmeton Buhariu me nr. 6 114) Prandaj, kur njeriu zemërohet duhet që ta përmbajë veten dhe të kërkojë mbrojtje tek Allahu nga shejtani i mallkuar, siç transmetohet në Sahihun e Buhariut me nr. 6 115. Gjithashtu, duhet të ulet, apo edhe të shtrihet, siç transmetohet në Sunen e Ebu Daudit me nr. 4 782, në hadithin e transmetuar nga Ebu Dherri se i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Kur zemërohet ndonjëri nga ju e ndodhet në këmbë, atëherë le të ulet; e nëse nuk i largohet zemërimi, le të shtrihet.”** Ky hadith është i saktë sepse transmetuesit e tij janë transmetues në Sahihun e Muslimit.

3 - Përfitimet e nxjerra nga hadithi janë:

- 1 - Kujdesi që tregonin sahabët për të arritur veprat e mira, sepse ky sahabi kërkoji këshillë nga Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).
- 2 - Këshilla për largimin nga shkaqet që shpien drejt zemërimit dhe nga pasojat që vijnë pas tij.
- 3 - Përsëritja e këshillës për ndalimin e zemërimit tregon për rëndësinë e kësaj këshille.

17 - Allahu e ka obliguar mirësinë në çdo gjë.

Ebu Jeala Shedad bin Eusi (radijAllahu ‘anhu) transmeton se i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Allahu i Madhëruar e ka bërë detyrë mirësinë për çdo gjë. Prandaj, edhe kur të vrisni dikë (ndonjë armik në luftë), vriteni me sa më pak vuajtje. Po ashtu, kur të therni ndonjë kafshë, mundohuni ta therni në mënyrën më të mirë, duke mprehur thikën që kafsha të mos mundohet.”** Transmeton Muslimi.

1 - Në fjalët e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“Allahu i Madhëruar e ka bërë detyrë mirësinë për çdo gjë”**, mirësia është e kundërta e keqbërjes. Ndërsa fjala **“e ka bërë detyrë”** do të thotë e ka ligjëruar dhe e ka obliguar. Pra, mirësia është e përgjithshme sepse duhet të përfshijë njeriun dhe kafshën është detyrim fetar dhe legjislativ.

2 - Pas kësaj, i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) urdhëron që të tregohet mirësi gjatë therjes së kafshës, duke e mprehur thikën, me qëllim që

ajo të ndiejë sa më pak dhimbje. Ky ishte një shembull që pasqyron mirësinë edhe gjatë vrasjes së një njeriu që meriton të ekzekutohet, apo për therjen e një kafshe, duke përzgjedhur rrugët më të lehta, nëpërmjet të cilave t'u dalë shpirti pa mundim të madh.

3 - Ibn Rexhebi në librin e tij Xhamiul Ulumi uel Hikem (1/381-382) thotë: **“Ky hadith pohon domosdoshmërinë e pasqyrit të mirësisë në të gjitha veprat. Duhet të dimë se mirësia duhet treguar sipas rastit, p.sh: mirësia në kryerjen e detyrimeve të dukshme apo të padukshme, si dhe ushtrimi i tyre në formën më të plotë, bashkë me këto detyra. Në këtë rast, kjo pjesë e mirësisë është e domosdoshme. Ndërsa mirësia e përdorur për të plotësuar gjërat e pëlqyeshme nuk është e domosdoshme. Mirësia në braktisjen e të ndaluarave dhe largimin prej tyre, qofshin të dukshme, apo të fshehta, siç thotë Allahu i Madhëruar: **“E largohuni nga mëkatet e hapëta dhe ato të fshehta.”****

Mirësia në këtë rast është e domosdoshme. Për sa i përket mirësisë së durimit ndaj kaderit, ajo është e pëlqyeshme të kryhet duke duruar në formën e kërkuar, pa u acaruar dhe pa u shqetësuar. Mirësia e domosdoshme në marrëdhëniet me njerëzit dhe bashkëjetesën me ta arrihet duke praktikuar të gjitha detyrimet, me të cilat të ka urdhëruar Allahu. Ndërsa mirësia e domosdoshme në udhëheqjen e krijesave dhe mirëvajtjen e punëve të tyre, arrihet duke i praktikuar të gjitha detyrimet që kërkon udhëheqja, Çdo gjë shtesë mbi obligimin nuk është mirësi e detyrueshme. Gjithashtu, mirësia në vrasjen e atyre që lejohet të vriten, qoftë njerëz, apo kafshë, qëndron në mundësinë krijohet për ta, në mënyrë që të japin shpirt në formën më të lehtë dhe me të shpejtë, pa ua shtuar vuajtjet, sepse konsiderohet vuajtje e panevojshme. Këtë lloj mirësie e përmendi i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) në këtë hadith, e ndoshta e ka përmendur si shembull ose për shkak të nevojës për qartësim që kishte kjo çështje në atë kohë, duke thënë: **“Ndaj dhe kur të vrisni dikë (ndonjë armik në luftë), vriteni me sa më pak dhimbje. Po ashtu, kur të therni ndonjë kafshë, mundohuni ta therni në mënyrën më të mirë.”** Kjo do të thotë që të përmirësojmë mënyrën e therjes dhe vrasjes. Gjithashtu, kjo pohon domosdoshmërinë e përsheptimit të nxjerrjes së shpirtit ndaj atyre që lejohen, në formën më të lehtë.”

4 - Vetëpërmbajtja gjatë vrasjes është e kërkuar, për të qenë larg gjymtimit apo përçudnimit **(të kufomës)**, sido që të jetë; vrasje e mohuesve, hakmarrjeje, apo edhe në rastin e ekzekutimit të vendimeve penale. Këtu përjashtohet rasti kur ndodh një hakmarrje ku me vrasësin veprohet në të njëjtën mënyrë siç ka vepruar ai me të vrarin, siç është transmetuar nga Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue

sel-lem), i cili vrau jehudiun që kishte shtypur kokën e një robëreshe mes dy gurëve, ndodhi të cilën e transmeton Buhariu me nr. 2 413 dhe Muslimi me nr. 1 672. Apo ashtu siç është saktësuar në ndodhinë e uranijinëve, të cilën e ka transmetuar Buhariu me nr. 6 802, si dhe Muslimi me nr. 1 671. Ndërsa rasti i gurëzimit të imoralit kur është i martuar mundet që të jetë përjashtuar nga përgjithësimi i këtij hadithi ose kuptohet në atë që mirësia kryhet kur është në përputhje me legjislacionin, kështu që gurëzimi i përket këtij legjislacioni.

5 - Përfitimet e nxjerra nga hadithi janë:

1 - Domosdoshmëria e mirësisë në çdo gjë.

2 - Domosdoshmëria e shfaqjes së mirësisë gjatë ekzekutimit, duke ndjekur rrugët me më pak vuajtje.

3 - Kujdesi për mjetin që pret kafshën para se ta fillojë therjen, e kjo duke u bazuar në fjalën e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“...duke mprehur thikën që kafsha të mos vuajë.”**

18 - Ki frikë Allahun kudo që të jësh.

Ebu Dherr Xhundub bin Xhunadeh dhe Ebu AbduRrahman Muadh bin Xhebeli (radij-Allahu ‘anhum) transmetojnë se i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Frikësoju Allahut kudo që të jesh. Të keqen pasoje me një të mirë me qëllim që ta fshijë atë (të keqen) dhe me njerëzit sillu me moral të mirë.”** Transmeton Tirmidhiu, i cili thotë se ky hadith është i mirë, ndërsa në disa dorëshkrime të tjera, ai e konsideron hadith të saktë.

1 - Ky hadith, bashkë me tri fjalitë e tij ka përmbledhur çdo gjë që i kërkohet një muslimani, kundrejt Zotit të tij, vetes dhe të tjerëve.

2 - Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) thotë: **“Frikësoju Allahut kudo që të jesh.”** Në gjuhën arabe origjina e Takvasë (**frikë - respektit**) është kur vendos mes teje dhe atij që i frikësohesh një pengesë, e cila të ruan prej tij, siç është përdorimi i këpucëve dhe nallaneve për t’u ruajtur nga dëmtimet që janë mbi sipërfaqe të tokës, apo siç është ndërtimi i shtëpive dhe tendave për t’u ruajtur nga i nxehti i diellit etj. Ndërsa në terminologjinë fetare takvaja ka kuptimin kur njeriu vendos një pengesë mes tij dhe hidhërimit të Allahut në mënyrë që të ruhet, e kjo arrihet duke zbatuar urdhrat dhe duke braktisur veprat e

ndaluar, i mbushur me bindje dhe vërtetësi të plotë në atë që i përcillet prej fesë dhe duke e adhuruar Allahun në përputhje të plotë me legjislacionin, pra jo me bidate apo risi. Frikë - respekti ndaj Allahut është i kërkuar në të gjitha rastet, në të gjitha vendet dhe në të gjitha kohërat. Në këtë mënyrë, njeriu duhet t'i frikësohet Allahut të Lartësuar kur është në mesin e njerëzve dhe kur është vetëm, siç thuhet dhe në këtë hadith: **“Frikësoju Allahut kudo që të jesh!”**

3 - Fjala e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“Të keqen pasoje me një të mirë me qëllim që ta fshijë atë (të keqen)”**, ka kuptimin për rastet kur njeriu bën një mëkat dhe pendohet prej tij. Ky pendim është vepër e mirë sepse i fshin të gjitha mëkatet e vogla apo të mëdha që njeriu mund të ketë bërë më parë. Gjithashtu, fshirja e mëkateve arrihet edhe me punë të mira, të cilat i fshijnë mëkatet e vogla, ndërsa mëkatet e mëdha i fshin vetëm pendimi.

4 - Në fjalët e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) **“...dhe me njerëzit sillu me moral të lartë”**, besimtarit i kërkohet që të sillet me të gjithë njerëzit, në mënyrën më të mirë. Në këtë mënyrë, ai duhet të sillet me ta, ashtu sikurse dëshiron që njerëzit të sillen me të, kjo duke u bazuar në fjalën e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) që thotë: **“Askush nga ju nuk beson, derisa të dëshirojë për vëllanë e tij atë që dëshiron për vete.”** Si dhe në fjalën e Profetit që thotë: **“Kush dëshiron t'i largohet zjarrit le ta gjejë vdekja duke besuar te Allahu dhe bota tjetër dhe le t'u japë njerëzve atë që dëshiron të marrë prej tyre.”** Allahu i Madhëruar e ka cilësuar të Dërguarin e Tij me moral të lartë. Gjithashtu, Aishja (radijAllahu ‘anha) transmeton: **“Moral i tij ishte Kurani”** (E transmeton Muslimi me nr. 746), që do të thotë se ai praktikonte çdo gjë që diktohej në Kuran. Në Sunet janë transmetuar shumë hadithe, të cilat pohojnë vlerën e moralit dhe e nxisin njeriun të pajiset me moral të lartë, e nga ana tjetër, e këshillojnë prej moralit të keq.

5 - Përfitimet e nxjerra nga hadithi janë:

1- Këshilla e plotë që i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i jep umetit të tij, duke përfshirë edhe çështjet që u përmendën në këtë hadith, pra tri këshillat e mëdha dhe gjithëpërfshirëse.

2 - Frika që duhet të ketë besimtari ndaj Allahut në të gjitha rastet, vendet dhe kohët.

3 - Inkurajimi i besimtarit që veprat e këqija t'i pasojë me vepra të mira.

4 - Veprat e mira i fshijnë veprat e këqija.

5 - Nxitja e besimtarit që të sillet me njerëzit me moral të lartë.

19 - Ruaje Allahun që të të ruajë ty.

Ebu Abas Abdullah bin Abasi (radijAllahu ‘anhu) transmeton duke thënë: “Një ditë po qëndroja pas Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe ai më tha: **“O vogëlush, do të të mësoj disa fjalë: “Sille ndërmend Allahun sepse Ai do të të ruajë ty, kije ndërmend Allahun dhe Atë do ta gjesht para teje (do të mbrojtë dhe do të ndihmojë). Kur të kërkosh diçka kërkoje nga Zoti, e nëse kërkon ndihmë atëherë kërko nga Zoti. Dije se sikur i tërë populli të mblidhet për të të ndihmuar në diçka, nuk do mund të të ndihmonin dot përveç asaj që të ka përcaktuar Allahu. Por edhe sikur të mblidheshin për të të dëmtuar, ata nuk do të dëmtonin aq sa Allahu e ka përcaktuar. Lapsat (për shënimin e përcaktimeve) janë ngritur, dhe faqet e shkrimit janë tharë.”** Transmeton Tirmidhiu dhe thotë se është hadith hasen sahih.

Ndërsa në një transmetim tjetër të këtij hadithi shënohen edhe këto fjalë:

“Sille ndërmend Allahun, do ta gjesht përpara teje. Njihe Allahun (duke e respektuar) kur je në bollëk, në mënyrë që Ai të të njohë (me ndihmën e Tij) kur je në vështirësi. Dije se ajo prej të cilës ke shpëtuar, nuk do të mund të të godiste dhe prej asaj që je goditur nuk do të kishe mundësi të shpëtoje. Dije se fitorja arrihet me durim, ndërsa suksesi me mundim dhe pas vështirësive vjen lehtësimi.”

1 - Fjala e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“Sille ndërmend Allahun, në mënyrë që Ai do të të ruajë ty”**, kuptohet kështu: **“Ruaji kufijtë e vëna nga Allahu, duke i praktikuar urdhrat e Tij, duke u distancuar nga punët e ndaluara, duke iu besuar fjalëve të Tij, duke e adhuruar në përputhje me legjislacionin e vendosur prej Tij dhe jo me bidate dhe pasione. Të gjitha këto, me qëllimin që Allahu të të ruajë ty në çështjet e fesë dhe të dynjasë, si shpërblim i merituar, pra shpërblim në varësi të punës.”**

2 - Fjala e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“Sille ndërmend Allahun, në mënyrë që Atë do ta gjesht para teje”**, do të thotë që Allahu do të të ruajë në çështjet e tua të fesë dhe të dynjasë.

3 - Fjalët e Profetit: **“Kur të kërkosh diçka, kërkoje nga Zoti yt, e nëse kërkon ndihmë, atëherë kërkoje nga Zoti yt”**, janë në përputhje të plotë me

ajetin Kuranor ku Allahu i Madhëruar thotë: **“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.”** (Suretu Fatiha, 5) T’i kërkoshte Allahut është lutje, e ndërsa lutja është adhurim. Kjo do të thotë që muslimani adhuron vetëm Allahun dhe vetëm Atij i kërkon zgjidhjen e problemeve të tij, vetëm Atij i kërkon ndihmë në të gjitha çështjet e kësaj bote dhe botës tjetër, pa harruar përdorimin e shkaqeve të lejuara dhe i lutet Allahut që të bëjë dobi me këto shkaqe, siç thotë Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“Kujdesu për gjithçka që të bën dobi! Kërkoji ndihmë Allahut dhe mos u trego i dobët.”** (E transmeton Muslimi me nr. 2 664)

4 - Fjalët e Profetit: **“Dije se sikur i tërë populli të mbledhej për të të ndihmuar në diçka, nuk do mund të të ndihmonte”**, e deri tek fjalët: **“Lapsat (për shënimin e përcaktimeve) janë ngritur dhe faqet e shkrimit janë tharë.”** Pra, pasi tregoi se lutja dhe kërkitimi i ndihmës duhet t’i kërkohej vetëm Allahut, se çdo send është në dorën e Tij. Askush nuk mund ta ndalojë atë që Ai jep dhe askush nuk mund të japë atë që Ai e ndalon, pra, çdo gjë nuk mund të dalë jashtë dëshirës dhe vullnetit të Tij. Gjithashtu, njerëzit nuk mund t’i bëjnë mirë dikujt, përderisa atë nuk e ka paracaktuar Allahu, nga ana tjetër, nuk mund ta dëmtojnë me asgjë, nëse këtë nuk e ka paracaktuar Allahu. Çdo gjë që ndodh, apo nuk ndodh është paracaktuar më parë, për këtë arsye në hadith thuhet: **“Lapsat (për shënimin e përcaktimeve) janë ngritur dhe faqet e shkrimit janë tharë.”** Kjo do të thotë se çdo gjë që do të ndodhë është shkruar dhe ka mbaruar, e patjetër që do të realizohet. Me ngritjen e lapsave dhe tharjen e faqeve të shkrimit kuptohet mbarimi i çdo gjëje që është paracaktuar në librin Leuhi Mahfudh dhe që patjetër do të ndodhë në përputhje me atë që është paracaktuar. Të gjitha këto arsyetime pohojnë atë që quhet besimi në kaderin e Allahut, i cili është një nga gjashtë bazat e besimit dhe që e kemi sqaruar në hadithin e njohur të Xhibrilit.

5 - Fjala e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“Njihe Allahun (duke e respektuar) kur je në bollëk, në mënyrë që Ai të të njohë (me ndihmën e Tij) kur je në vështirësi”** tregon se nëse dikush që punën e tij e bën të sigurtë për hir të Allahut gjatë kohës së rehatisë dhe bollëkut, do të gjejë nga Allahu vetëm të mira dhe Ai do i largojë çdo të keqe në kohën e vështirësive dhe mundimeve, siç thotë Allahu i Madhëruar: **“Atij që i frikësohet Allahut, Ai do t’i gjejë rrugëdalje (nga çdo vështirësi) dhe do t’i japë risk prej nga nuk e pret.”** (Suretu Talak, 2-3)

Në një ajet tjetër Ai thotë: **“Dhe po të mos ishte nga ata që i luten Allahut, me siguri do të mbetej në barkun e saj deri në Ditën e Ringjalljes.”** (Suretu Safat, 143-144)

Në këtë kuadër, mund të marrim shembull edhe rastin e tri udhëtarëve që i zuri rruga në një shpellë, derën e së cilës e mbylli një gur i madh. Ata ndërmjetësuan tek Allahu me anë të veprave të tyre të mira, të cilat i kishin kryer në kohën e rehatisë dhe bollëkut. Kështu, njëri prej tyre përmendi respektin e tij ndaj prindërve, i dyti përmendi ruajtjen e amanetit dhe shtimin e tij, duke ia kthyer edhe një herë të zotit të saj dhe i treti përmendi braktisjen që i kishte bërë imoralitetit për hir të Allahut, pasi i kishte të gjitha mundësitë për ta bërë.

Si rrjedhojë, Allahu ua largoi vështirësinë dhe i çliroi nga dëmtimi që u ishte kanosur, kështu që guri u rrokullis, derisa ata mundën të dilnin nga ajo shpellë. Këtë hadith e transmeton Buhariu me nr. 5 974 dhe Muslimi me nr. 2 743.

6 - Fjala e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“Dije se ajo prej të cilës ke shpëtuar nuk do të mund të të godiste dhe prej asaj që të ka goditur, nuk mund të shpëtoje”**, sqaron se ajo që ka paracaktuar Allahu për ty do të të ndodhë patjetër, por ajo që nuk ka paracaktuar të ndodhë, nuk ka për të ndodhur sepse ajo që do Allahu bëhet e çfarë nuk do Ai, nuk mund të bëhet. Gjithçka për të cilën Allahu ka paracaktuar që të ndodhë patjetër, do të ndodhë dhe kurrsesi nuk mund të ndryshojë, ndërsa atë që Allahu nuk e ka përcaktuar për ty, ti nuk mund të gjesh rrugë për ta marrë, apo për të arritur tek ajo.

7 - Dhe në fund janë fjalët e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“Dije se fitorja arrihet me durim, ndërsa suksesi me mundim dhe pas vështirësive vjen lehtësimi.”**

Në këto tri fjali pohohet arritja e fitores me anë të durimit dhe suksesit, me anë të mundimit dhe lehtësimit pas vështirësisë. Gjithashtu prej durimit vjen fitorja me lejen e Allahut ndërsa vështirësinë Allahu e largon me anë të fitores që vjen menjëherë pas saj, dhe vështirësia pasohet me lehtësim nga ana e Allahut të Madhëruar.

8 - Përfitimet e nxjerra nga hadithi janë:

1 - Dikush që iu kushton rëndësi kufijve që ka vënë

Allahu, Allahu e ruan në fenë dhe jetën e tij.

2 - Dikush që sillet shkujdesur ndaj kufijve që ka vënë Allahu nuk do e arrijë këtë përkujdesje nga Ai, sikurse thuhet në një prej ajeteve kuranore: **“Ata e harruan Allahun e Ai i harroi ata.”**

3 - Shpërblimi jepet në varësi të punës. Vepra e mirë në këtë rast shërben si ruajtje, prandaj shpërblimi ishte I njëjtë **(pra edhe Allahu të ruan)**.

4 - Robi duhet tia kushtojë adhurimin e tij vetëm Allahut, madje edhe atëherë kur kërkon ndihmë.

5 - Besimi te kaderi i Allahut.

6 - Njerëzit nuk mund të të sjellin dobi, apo dëm në një çështje, vetën nëse dobia, apo dëmi është paracaktuar nga Allahu.

7 - Askujt nuk i ndodh një e mirë, nëse ajo nuk ka qenë e paracaktuar, e po ashtu, nuk mund t'i largohet një e keqe nëse nuk ka qenë e paracaktuar. Ajo që dëshiron Allahu bëhet, ndërsa diçka që nuk e do Allahu nuk mund të bëhet.

8 - Durimi pasohet me fitore.

9 - Mundimi pasohet me sukses.

10 - Pas vështirësisë vjen lehtësimi.

11 - Thjeshtësia e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) dhe mëshira e tij për të vegjlit.

12 - Përparësia që u jepet punëve të rëndësishme për t'i nxitur shpirtrat drejt tyre, kjo duke u bazuar në fjalën e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): **"...do të të mësoj disa fjalë."**

20 - Nëse nuk ke turp, bëj ç'të duash.

Ebu Mesud Ukbe bin Amr el Ensari el Bedri (radijAllahu 'anhu) transmeton se i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: **"Prej fjalëve (të urta) që bota ka mbajtur mend nga predikimet e profetëve të mëparshëm është: Kur nuk ke turp, bëj ç'të duash."** Transmeton Buhariu.

1 - Hadithi pohon se turpi është një virtyt i lavdëruar, i cili është gjendur jo vetëm në këtë legjislacion, por edhe në legjislacionet e mëparshme. Turpi është një virtyt, të cilin e kanë trashëguar profecitë njëra pas tjetrës, deri në kohën e këtij umeti. Urdhri i përmendur; **"bëj ç'të duash"**, ka për qëllim lejueshmërinë, përderisa ajo prej së cilës ke turp nuk është e ndaluar ligjërisht. Nëse bëhet fjalë për një vepër të ndaluar, atëherë ajo nënkupton kërcënim ose një gjë e tillë

nuk mund t'i ndodhë vetëm se një njeriu që i ka ikur, apo i është pakësuar ndjenja e turpit. Ibn Rexhebi në librin e tij Xhamiul Ulumi uel Hikem (1/497) thotë: **“Fjalët e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Prej fjalëve (e urta) që bota ka mbajtur mend nga predikimet e profetëve të mëparshëm”, tregojnë se ky virtyt është i trashëguar nga profetët e mëparshëm dhe se njerëzit e kanë përdorur dhe e kanë trashëguar atë brez pas brezi. E gjithë kjo, pohon se profecia e mëparshme ishte ajo që e solli këtë fjalë dhe ajo u përhap shumë mes njerëzve, derisa arriti tek njerëzit e parë të këtij umeti.”** Më pas, ai vijon: **“Ndërsa fjalët e tij: “Kur nuk ke turp bëj ç’të duash”,** rreth kuptimit të tyre ekzistojnë dy mendime:

Mendimi i parë: Nuk nënkuptohet urdhri që ai të bëjë ç’të dojë, përkundrazi, fjalët kanë kuptimin e nënçmimit dhe ndalimit të asaj veprë. Përkrahësit e kësaj thënieje kanë dy rrugë:

E para: ata pohojnë se ai është urdhër që nënkupton kërcënimin dhe dënimin dhe që do të thotë se nëse nuk ke turp, atëherë bëj ç’të duash sepse Allahu do të të shpërblejë për këtë që bën, siç thotë Allahu: **“Bëni ç’të doni, vërtet Ai e sheh atë që veproni!”** (Teubeh 105) apo siç është fjala tjetër e Allahut: **“Adhuroni çfarë të doni në vend të Tij.”** (Zumer 15) Ky mendim ishte zgjedhja e një grupi dijetarësh, ku në mes tyre bën pjesë edhe Ebu Abas Thealebi.

E dyta: ata pohojnë se është urdhër dhe bie kallëzuesi, që do të thotë se vetëm ai që nuk e ka ndjenjën e turpit bën ç’të dojë sepse ajo që e pengon njeriun nga sjelljet e këqija është turpi, prandaj, ai që nuk ka turp zhytet në çdo vepër të keqe dhe të ndaluar. Nga ana tjetër, nga vepra të tilla stepet çdokush që gëzon virtytin e turpit, siç thotë i Dërguari i Allahut: **“Kush gënjen ndaj meje qëllimisht, le të përgatisë vendin e tij për në zjarr.”** Në këtë rast, shprehja e tij është në formën urdhërore, por që nënkupton kallëzuesin. Këtë mendim e zgjodhi Ebu Ubejd Kasim bin Salami (RahimehUllah), Ibn Kutejbe, Muhamed bin Nasr el Mervezi etj. Ndërsa Ebu Daudi transmetoi nga imam Ahmedi fjalë që përputhen me këtë mendim.

Mendimi i dytë: Duke iu referuar shprehjes në parim merr kuptimin që ai të veprojë ç’të dojë, nëse vepra që kërkon të bësh nuk është diçka e turpshme sepse mund të jetë veprim adhurimi ose virtyt, moral dhe sjellje e mirë. Ky është njëri nga mendimet e imamëve si p.sh.; Ebu Is’hak el Meruezi Eshafi dhe po ashtu, një fjalë e tillë është transmetuar edhe nga imam Ahmedi.

Ndërsa në një pjesë tjetër (1/501-502) ai shprehet: **“Dije se turpi ndahet në dy lloje: i pari është turpi i natyrshëm, jo i fituar. Ky lloj turpi**

konsiderohet si virtyti më i mirë që Allahu ia dhuron një rob, duke ia caktuar karakterit të tij. Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) thotë: “Turpi sjell vetëm të mira”, sepse të ndalon nga veprime të këqija dhe të pamoralshme, gjithashtu të nxit në sjelle me moral të lartë. Prandaj, duke u nisur nga ky koncept, ai bën pjesë në besim. Lloji i dytë i turpit është i fituar prej njohjes së Allahut, njohja e madhësisë së Tij dhe afërsisë që Ai ka me krijesat e Tij, mbikëqyrjen dhe diturinë që ka për të fshehtat e tyre, duke qenë se Ai i di çfarë fshehin cepat e syve dhe kraharorët. Ky lloj turpi konsiderohet është prej shkallëve më të larta të imanit, madje mund të them se është prej gradave më të larta të ihsanit! Ndodh që turpërimi nga Allahu të lindë edhe kur njeriu vëren mirësitë prej Tij, krahasuar me shkujdesjen në falënderimin ndaj Tij. Nëse njeriu privohet nga turpi i fituar, apo i lindur, asgjë më nuk mund ta ndalojë atë për t’u zhytur në të këqija dhe në moral të ulët, e në këtë mënyrë kthehet në një njeri që nuk ka iman.”

2 - Përfitimet e nxjerra nga hadithi janë:

- 1 - Morali i turpit është prej moraleve të virtytshme që është trashëguar nga profecitë e mëparshme.
- 2 - Ky hadith nxit për ruajtjen e ndjenjës së turpin dhe tregon disa vlera të tij.
- 3 - Ai që humb ndjenjën e turpin është i ekspozuar ndaj çdo veprë të keqe.

21 - Thauj: I kam besuar Allahut, dhe përmbaju kësaj.

Sipas Ebu Amrit, e po ashtu edhe sipas disa të tjerëve si Ebu Amrete Sufjan bin Abdilah (radijAllahu ‘anhu) transmetohet: “Një herë i thashë Profetit: **“O i Dërguari i Allahut! Më thuaj diçka për Islamin që të mos kem nevojë të pyes ndonjë tjetër pas teje.”** Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) u përgjigj: **“Thuaj: “I besova Allahut,” - e më pas vijo (qëndro) në këtë rrugë.”**

Transmeton Muslimi.

- 1 - Shokët e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) janë njerëzit më të kujdesshëm në njohjen e fesë, gjithashtu janë më të përparuarit në çdo të mirë. Kjo pyetje e bërë nga Sufjan bin Abdullahu e përforcon edhe më shumë këtë që pohim, sepse ai i drejtoi të Dërguarit të Allahut këtë pyetje esenciale, e cila kërkon një përgjigje të përmbledhur e të qartë, në mënyrë që pyetësi të mos

ketë nevojë të pyesë dikë tjetër pas të Dërguarit të Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

2 - I Dërguari i Allahut iu përgjigj këtij sahabi me fjalë të pakta, por që kanë një kuptim shumë të gjerë dhe llogariten si fjalët më përmbledhëse të Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“Thuaj: “I besova Allahut,” - e më pas qëndro në këtë rrugë.”** Ai e urdhëroi të shprehte me gjuhë besimin e tij te Allahu dhe çdo gjë që ai përfshin, pa harruar ato që përmend Allahu në librin e Tij dhe në Sunetin e Profetit të Tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Në këtë kontekst përfshihen edhe çështjet e fshehta dhe të dukshme sepse imani dhe Islami janë dy fjalë që kur përmenden së bashku, secila prej tyre merr kuptimin përkatës. Nga ana tjetër, nëse Islami dhe imani vijnë të ndarë, ashtu siç përmendet këtu, kjo gjë bën që kuptimet të ndërthuren me njëra-tjetrën **(d.m.th. punët e dukshme dhe ato të padukshme)**. Pas gjithë besimit, bindjes dhe qëndrueshmërisë së tij, ai e urdhëroi për qëndrueshmëri në këtë të vërtetë dhe në këtë udhëzim, pra ta vazhdojë këtë rrugë, ashtu siç thotë Allahu i Madhëruar: **“O besimtarë! Kijeni frikë Allahun ashtu si i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë!”** (Suretu Ali Imran, 102)

Kjo ka të bëjë me qëndrueshmërinë në bindje ndaj Allahut dhe në bindje ndaj të Dërguarit të Tij, derisa t’ju vijë vdekja në këtë gjendje të mirë. Allahu i Madhëruar e ka sqaruar shpërblimin e atyre që besojnë dhe janë të qëndrueshëm në këtë besim, duke thënë: **“Me të vërtetë, atyre që thonë: “Zoti ynë është Allahu”, e pastaj vazhdojnë të vendosur në rrugën e drejtë, do t’u zbresin engjëjt (para vdekjes) e do t’u thonë: “Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni! Dhe gëzojuni Xhenetit që ju është premtuar.”** (Suretu Fusilet, 30)

Gjithashtu thotë: **“Padyshim, ata që thonë: “Zoti ynë është Allahu!” dhe pastaj qëndrojnë në rrugën e drejtë, nuk do të kenë arsye për t’u frikësuar e as për t’u dëshpëruar (kur t’u vijë vdekja). Ata do të jenë banorë të Xhenetit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë si shpërblim për atë që kanë punuar.”** (Suretu Ahkaf, 13-14)

3 - Përfitimet e nxjerra nga hadithi janë:

1 - Kujdesi i sahabëve mbi të pyeturit rreth çështjeve që kanë të bëjnë me fenë e tyre.

2 - Pyetja esenciale që drejtoi Sufjan bin Abdullahu pasqyron logjikën e tij të shëndoshë dhe dëshirën për të marrë një këshillë gjithëpërfshirëse.

3 - Besimi tek Allahu, në Librin e Allahut dhe Sunetin e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem).

4 - Qëndrueshmëria në drejtësi dhe në udhëzim, derisa të na vijë vdekja.

22 - Si mendon nëse i fal pesë namazet dhe e agjëron Ramazanin.

Ebu Abdullah Xhabir bin Abdilah el Ensari (radijAllahu 'anhu) transmeton: “Dikush e pyeti të Dërguarin e Allahut (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): **“Si mendon, nëse unë e fal namazin e detyruar, agjëroj Ramazanin, u përmbahem të lejuarave dhe braktis të ndaluarat dhe nuk shtoj gjë tjetër veç këtyre, a mund të hyj në Xhenet?”** I Dërguari i Allahut iu përgjigj: **“Po!”** Transmeton Muslimi.

1 - Në disa rrugë të tjera të transmetimit të këtij hadithi në Sahihun e Muslimit me nr. 15, tregohet emri i njeriut që pyeti e ai ishte Numan bin Kaukal.

2 - Fjala e pyetësit: **“Si mendon...”**, kuptohet me fjalë të tjera: më trego nëse unë i veproj këto punë, a mund të hyj në Xhenet?

3 - Në çështjet për të cilat pyeti se a e fusin në Xhenet nëse i praktikon, si; namazi, agjërimi, veprimi i të lejuarave dhe braktisja e të ndaluarave, aty nuk përmenden zekati dhe Haxhi. Komenti se Haxhi nuk është përmendur, vazhdon me arsyetimin se në atë kohë, akoma nuk ishte bërë obligim. Gjithashtu, edhe zekati nuk u përmend sepse merret parasysh fakti që mund të ishte njeri i varfër që nuk kishte pasuri për ta dhënë zekat, por mundet të jetë edhe fakti se Haxhi bashkë me zekatin përfshihen në përmbajtjen ndaj të lejuarave dhe braktisjen e të ndaluarave.

4 - Në hadith tregohet zbatimi i detyrimeve dhe aty nuk përmenden veprat e pëlqyeshme. Ai që i praktikon ato është mesatari, për të cilin Allahu i Madhëruar thotë: **“Pastaj, Ne ua dhamë Librin robërve Tanë të zgjedhur (nga ndjekësit e Muhamedit). Disa prej tyre i bëjnë dëm vetes (duke bërë vepra të ndaluara), disa janë në rrugë të mesme (duke kryer detyrimet dhe duke shmangur të ndaluarat), ndërsa disa, me lejen e Allahut, shkojnë**

përpara me të mira (përtej detyrimeve); kjo është dhuntia e madhe.”

(Suretu Fatir, 32)

Në këtë kuptim, kryerja e detyrimeve dhe braktisja e të ndaluarave janë shkaqe që njeriu të hyjë në Xhenet. Ndërsa kryerja e adhurimit vullnetar, bashkë me obligimet i plotësojnë ato nëse nuk i ka pasur të plota dhe këtë fakt e vërteton një hadith i saktë nga i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) të cilin e transmeton Ebu Daudi me nr. 864, Tirmidhiu me nr. 413 dhe Ibn Maxheh me nr. 1 425. Gjithashtu, adhurimet vullnetare janë si mburojë për obligimet sepse dikush që kujdeset për nafilet, natyrisht që kujdesi i tij ndaj farzit është edhe më i madh. Ndërsa dikush që është i shkujdesur ndaj nafileve, kjo gjë ka shumë mundësi ta shpjerë drejt mangësive në farze.

5 - Përfitimet e nxjerra nga hadithi janë:

1 - Kujdesi që tregonin sahabët për t’i mësuar ato punë që e fusin njeriun në Xhenet.

2 - Punët janë shkak për hyrjen në Xhenet.

3 - Rëndësia e pesë namazeve, madje në hadith tjetër thuhet se namazi është shtylla e Islamit.

4 - Në hadith theksohet rëndësia e agjërimit të muajit të Ramazanit.

5 - Muslimani i përmbahet hallallit me besimin se është i lejuar dhe distancohet nga harami me besimin se është i ndaluar.

6 - Në hadith pohohet kotësia e disa pretendimeve të sufijve, të cilët mendojnë se njeriu nuk e adhuron Allahun me dëshirën për të hyrë në Xhenet, apo nga frika që ai ka prej zjarrit, ndërkohë që Allahu për të dashurin e Tij, Ibrahimin, thotë: **“Dhe më bëj mua prej atyre që trashëgojnë xhenetin e kënaqësive!”**

23 - Pastërtia është gjysma e besimit.

Ebu Malik el Harith bin Asim el Eshari (radijAllahu ‘anhu) transmeton se i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Pastërtia (abdesi) është gjysma e besimit. Falënderimi i Allahut (Elhamdulilahi) i mbush peshoret (e punëve të tij të mira), lavdërimi bashkë me falënderimin (SubhanAllahi uel Hamdulilahi) e përmbushin (ose e përmbush me sevap**

hapësirën ndërmjet qiellit dhe tokës). Namazi është dritë, sadakaja është provë (besimi). Durimi është shkëlqim, ndërsa Kurani është dëshmi e qartë pro ose kundër teje. Çdo njeri ecën e mundohet, ku prej tyre ka që e shesin shpirtin e tyre, duke e çliruar ose duke e shkatërruar atë.”

Transmeton Muslimi.

1 - Pastërtia e përmendur në hadith merr kuptimin edhe me braktisjen e shirkut, mëkateve dhe largimi prej tyre. Gjithashtu, koment është bërë edhe mbi abdesin që përdoret në namaz. Ndërsa imani **(besimi)** i përmendur është komentuar me namazin, siç thotë Allahu i Madhëruar: **“Dijeni se Allahu nuk ua humb besimin tuaj”** (Suretu Bekare, 143), d.m.th. namazin që keni falur të drejtuar nga Kudsi. Ajo që pohon se me pastërtinë nënkuptojmë abdesin është versioni i përmendur te Tirmidhiu me nr. 3 517, ku në vend të fjalës **“pastërti”** është përmendur fjala **“abdes.”** Po ashtu, është versioni i Ibn Maxhes me nr. 280 ku thuhet: **“Përsosmëria e abdesit.”** Kushti i namazit është abdesi, ashtu sikurse është transmetuar në hadith: **“Namazi nuk pranohet pa abdes, e as sadakaja e atij që e ka përvetësuar pasurinë nga preja e luftës.”** (E transmeton Muslimi me nr. 224)

2 - **“Falënderimi i Allahut (Elhamdulilahi) i mbush peshoret (e punëve të tij të mira), lavdërimi bashkë me falënderimin (SubhanAllahi uel Hamdulilahi) e përmbushin (ose e përmbush me sevap) hapësirën ndërmjet qiellit dhe tokës.”** Peshoret, këtu ka kuptimin e peshores së punëve. Në hadith del në pah vlera e tahmidit **(fjalës Elhamdulilah)** dhe tesbihut **(fjalës subhanAllah)**. Tesbih do të thotë ta pastrosh Allahun nga çdo e metë, ndërsa tahmidi është që ta cilësosh Atë me përsosmëri.

Në fjalët e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“...e përmbushin (ose e përmbush)”**, mundet që përmbushja ndërmjet qiellit dhe tokës të jetë me të dyja veprat së bashku ose me njërën prej tyre, duke qenë se transmetimi është bërë me dyshim.

3 - Fjalët e Profetit: **“Namazi është dritë”**, nënkuptojnë dritën në zemër, në fytyrë, në udhëzim dhe në Ditën e Kiametit.

4 - Fjala e Profetit: **“Sadakaja është provë (besimi)”**, do të thotë se është shenjë për besimin dhe sinjeritetin e një njeriu, për arsye se shpirtat bëhen koprracë ndaj pasurisë, ndaj ai që i ruhet koprracisë së shpirtit duke dhënë sadaka, e kalon sprovën për besimin e tij. E themi këtë sepse hipokriti mund shtirur duke u falur, por kurrë nuk ia bën zemra që të japë sadaka, për shkak të fanatizmin që ai ka në ruajtjen e pasurisë së tij.

5 - Fjalët e Profetit: **“Durimi është shkëlqim”**, nënkuptojnë durimin në bindjen ndaj Allahut, edhe pse për disa shpirtra është e shumë e vështirë. Gjithashtu, durimi nga mëkatet, edhe pse disa shpirtra anojnë drejt tyre, si dhe ndaj kadereve të Allahut që janë të dhimbshme, duke mos u mërzhitur e as duke u mllefosur, sepse nëse kjo ndodh tek një musliman, provon besimin e fortë dhe arsyetimin e mendjes së tij. Pikërisht, për këtë arsye, durimi u cilësua si shkëlqim.

6 - Fjalët e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“...ndërsa Kurani është dëshmi e qartë pro ose kundër teje”**, ndryshe kuptohen se Kurani ose është argument pro atij njeriu që praktikon ato që kërkon Kurani, siç janë: miratimi i çdo lajmi që ka ardhur në të, zbatimi i urdhrave, largimi prej të ndaluarave dhe leximi i tij ashtu siç duhet. Ose është argument kundër, nëse ia kthen shpinën dhe nuk praktikon ato që ai i kërkon. I ngjashëm me këtë hadith është edhe fjala e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) në Sahihun e Muslimit me nr. 817 ku thotë: **“Vërtet, Allahu me këtë libër ngre disa njerëz dhe i poshtëron disa të tjerë.”**

7 - Fjalët e Profetit: **“Çdo njeri punon e mundohet, ku prej tyre ka që e shesin shpirtin e tyre duke e çliruar ose duke e shkatërruar atë”** do të thotë që njerëzit veprojnë dhe mundohen por janë të ndarë në dy grupe: njëri grup e shet shpirtin e tij për hir të Allahut, duke iu bindur urdhrave të Tij e duke u larguar nga ato që ka ndaluar Ai. Me këtë vepër Ai e shpëton atë rob nga zjarri i Xhehenemit dhe e largon nga humbjet e shejtanit e mashtrimet e tij. Grupi tjetër e shkatërron shpirtin duke zhytur në mëkate, pra, duke rënë pre e epsheve të ndaluara, të cilat e shpien atë drejt zjarrit të Xhehenemit.

8 - Përfitimet e nxjerra nga hadithi janë:

1 - Në hadith trajtohet vlera e pastërtisë.

2 - Në hadith trajtohet vlera e tahmidit dhe tesbihut.

3 - Pohohet mizani **(peshorja e punëve)**.

4 – Nxirret në pah vlera e namazit dhe fakti që ai është dritë në këtë botë dhe në botën tjetër.

5 – Nxirret në pah vlera e sadakasë, e cila është shenjë që tregon për besimin e një njeriu.

6 - Nxirret në pah vlera e durimit dhe se durimi është shkëlqim për ata që durojnë.

7 - Nxitja në përkushtimin për mësimin e Kuranit, meditimin e punën me të, me qëllim që të jetë argument pro për besimtarin.

8 - Këshillimi lidhur me mangësitë që referohen zbatimit të Kuranit, me qëllim që të mos bëhen argument kundër besimtarit.

9 - Nxitja për çdo punë të mirë që e çliron njeriun nga e keqja e kësaj bote dhe dënimi në botën tjetër.

10 – Këshillimi lidhur me çdo punë të keqe që e shpie njeriun në kategorinë e të dashurve të shejtanit, e si rrjedhojë e shpien atë drejt zjarrit të Xhehenemit.

24 - O Robërit e Mi! Unë ia kam ndaluar vetes padrejtësinë.

Ebu Dherr el Gifari (radijAllahu ‘anhu) transmeton se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) transmeton nga Zoti i tij: **“O robërit e Mi! Unë ia kam ndaluar padrejtësinë Vetes dhe juve, ndaj mos i bëni padrejtësi njëri - tjetrit. O robërit e Mi! Të gjithë ju jeni të humbur, përveç atij që Unë e kam udhëzuar, prandaj kërkojeni udhëzimin nga Unë, që t'ju udhëzoj. O robërit e Mi! Të gjithë ju jeni të uritur, përveç atij që e ushqej Unë, prandaj kërkon nga Unë që t'ju ushqej e Unë do t'ju ushqej. O robërit e Mi! Të gjithë ju jeni të zhveshur, përveç atij që e vesh Unë, prandaj kërkon veshje nga Unë që t'ju vesh. O robërit e Mi! Vërtet ju gaboni natën dhe ditën, ndërsa Unë i fal të gjitha mëkatet, prandaj kërkon nga Unë falje që t'ju fal. O robërit e Mi! Ju nuk mund të arrini kurrë tek ajo që të më shkaktojë dëm Mua dhe as që do të arrini ndonjëherë tek ajo që do të më sillte dobi. O robërit e Mi! Sikur i pari dhe i fundit nga ju, duke përfshirë njerëzit dhe xhinët, të ishit të devotshëm si zemra më e devotshme e njërit prej jush, kjo nuk do t'i shtonte sundimit Tim asgjë. O robërit e Mi! Sikur i pari dhe i fundit nga ju, duke përfshirë njerëzit dhe xhinët, të ishit të prishur si zemra më e prishur e njërit prej jush, kjo nuk do t'i pakësonte sundimit Tim asgjë. O robërit e Mi! Sikur i pari dhe i fundit nga ju; duke përfshirë njerëzit dhe xhinët, të ngriheshit (qëndronit) në një vend dhe dëshirat e lutjet të m'i drejtonit Mua, dhe Unë t'i përgjigjesha lutjes së çdonjërit, kjo nuk do të zvogëlonte asgjë nga ajo që kam Unë, përpos si gjilpëra që nuk sjell asgjë kur ngulet në det. O robërit e Mi! Çdo gjë varet nga veprat tuaja që tek Unë janë të ruajtura dhe të llogaritura, e për të cilat Unë do t'ju shpërblej. Prandaj, kush gjen mirë le ta falënderojë**

Allahun, ndërsa kush gjen të kundërtën, mos të fajësojë asnjëri, përveç vetes.” Transmeton Muslimi.

1 - Nga fjala e Ebu Dherrit: **“përcjell nga Zoti i Tij ”**, kuptojmë se ky hadith është prej haditheve të shenjta hyjnore, pra kjo frazë dëshmon se hadithi është i shenjtë. E njëjtë me këtë është dhe fraza: **“Allahu i Madhëruar ka thënë...”**, ashtu siç e përcjell i Dërguari i Tij. Hadithi kudsij (i shenjtë) është hadithi kur Profeti **“...i referohet Allahut të Madhëruar.”**

2 - Në fjalën e Tij: **“O robërit e Mi! Unë ia kam ndaluar padrejtësinë Vetes dhe juve, ndaj mos i bëni padrejtësi njëri-tjetrit.”** Padrejtësia është të vendosësh diçka jo në vendin e duhur. Allahu ia ka ndaluar Vetes, edhe pse ka fuqi ta bëjë atë madje dhe çdo send tjetër, ndaj Allahu kurrë nuk bën padrejtësi për shkak të drejtësisë absolute që posedon. Allahu i Madhëruar thotë: **“Allahu nuk synon padrejtësi për robërit e Vet.”** (Suretu Gafir, 31) **“Vërtet, Zoti yt nuk është i padrejtë me robërit e Tij.” “Vërtet, Allahu nuk u bën asnjë padrejtësi njerëzve.” “Allahu nuk bën padrejtësi, qoftë dhe sa grimca më e vogël.” “Ndërsa ai që bën vepra të mira dhe është besimtar, nuk do të ketë frikë nga padrejtësia e as nga pakësimi i asaj që i përket.”** (Suretu Taha, 112) Me kuptimin që nuk duhet të frikësohet se mos i pakësohen punët e mira, t’i shtohen veprat e këqija apo të mbartë gabimet e të tjerëve. Mohimi i padrejtësisë nga Allahu i Madhëruar në këto ajete përmban pohimin e drejtësisë së Tij absolute. Ibn Rexhebi në librin e tij Xhamiul Ulumi uel Hikem (2/36) thotë: **“Përderisa Allahu i krijoi veprat e njerëzve dhe ato mbartin padrejtësi, kjo nuk nënkupton cilësimin e Tij si të padrejtë; i Lartë dhe i Pastër është Allahu, ashtu sikurse nuk mund të cilësohet me të këqija të tjera, të cilat i veprojnë njerëzit. Ato janë vetëm krijimi dhe paracaktimi i Tij, prandaj Allahu cilësohet vetëm me anë të veprimeve të Tij dhe jo me veprimet e krijesave të Tij. Veprimet e krijesave janë krijim i Tij dhe Ai nuk mund të cilësohet me asnjërin prej tyre, përkundrazi, Ai duhet të cilësohet me ato cilësi dhe veprime që bën, e për këtë Allahu e di më mirë!”** Allahu i Madhëruar ua ka ndaluar edhe njerëzve padrejtësinë, prandaj njeriu nuk duhet t’i bëjë padrejtësi vetes, apo të tjerëve.

3 - **“O robërit e Mi! Të gjithë ju jeni të humbur, përveç atij që Unë e kam udhëzuar, prandaj kërkojeni udhëzimin nga Unë që t’ju udhëzoj.”** Ibn Rexhebi në Xhamiul Ulumi uel Hikem (2/39-40) thotë: “Disa menduan se këto fjalë bien ndesh me hadithin e Ijad bin Himarit, i cili transmeton nga Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) se Allahu i Madhëruar ka thënë: **“Unë i krijova robërit e Mi të pastër, – në një version tjetër transmetohet - muslimanë, por atyre u erdhën shejtanët...”** Megjithatë, ky pretendim nuk është i saktë

sepse Allahu i krijoi bijtë e Ademit dhe në natyrshmërinë e tyre bëri që të kenë në shpirt Islamin dhe të anojnë tek ai, e tek asnjë fe tjetër veç fesë së Tij, duke i pajisur me këtë gjë në mënyrën më efikase. E megjithatë njeriut i kërkohet ta mësojë Islamin me vepra, sepse para se të fillojë mësimin ai konsiderohet i paditur, siç thotë Allahu i Madhëruar: **“Allahu u nxori nga barqet e nënave tua në një kohë kur nuk dinit asgjë.”** Ndërsa të Dërguarit të Tij Allahu i Madhëruar i thotë: **“A nuk të gjeti të paditur (për Islamin), e Ai të udhëzoi?”** (Suretu Duha, 7) Që do të thotë gjeti të paditur para se të mësonte librin dhe urtësinë, siç thotë Allahu i Lartësuar në një ajet tjetër: **“Dhe kështu, Ne të kemi dërguar ty shpallje me urdhrin dhe vullnetin Tonë. Ti më parë nuk e ke ditur se çfarë është Libri e as çfarë është besimi.”** (Suretu Shura, 52) Pra, njeriu lind në natyrshmërinë e pranimit të së vërtetës. Nëse Allahu e udhëzon, i mundëson atij një shkak që t’ia mësojë fenë, kështu që bëhet i udhëzuar në realitet pasi që ishte i udhëzuar me forcën e natyrshmërisë. Nga ana tjetër, nëse Allahu do ta poshtërojë i mundëson atij dikë që e mëson jashtë natyrshmërisë së tij, siç thotë i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“Çdo foshnje lind në natyrshmërinë e vet, ndërsa prindërit e bëjnë atë çifut, të krishterë ose zjarrputist.”**

Në këtë hadith njeriu urdhërohet që të kërkojë nga Allahu ta udhëzojë dhe këtu përfshihet udhëzimi i argumentimit dhe udhëzimi i suksesit. Nevoja e njeriut për t’u udhëzuar në fe është më e madhe se nevoja e tij për të ngrënë, apo për të pirë, përderisa në suren El Fatiha thuhet: **“Na udhëzo në rrugën e drejtë!”** Në këtë mënyrë njerëzit i luten Allahut që t’i forcojë në udhëzim dhe t’u shtojë udhëzim mbi udhëzimin që kanë.

4 - **“O robërit e Mi! Të gjithë ju jeni të zhveshur përveç atij që e vesh Unë, prandaj kërkonte veshje nga Unë që t’ju vesh.”** Në këto dy fjali tregohet nevoja e madhe që kanë krijesat për Zotin e tyre, pra nevoja që kanë për të arritur furnizimin e tyre në nivelin më të domosdoshëm. Për këtë arsye, u kërkohet që t’i kërkojnë Allahut të Madhëruar ushqimin dhe veshmbathjet e tyre.

5 - **“O robërit e Mi! Vërtet ju gaboni natën dhe ditën, ndërsa Unë i fal të gjitha mëkatet, prandaj kërkonte nga Unë falje që t’ju fal.”** Allahu i Madhëruar u kërkon robërve të Tij që t’u përmbahen urdhërave dhe të largohen nga të ndaluarat. Natyrisht, robërit kanë mangësi, kundrejt detyrimeve që u ka caktuar Allahu, apo në kryerjen e disa prej veprimeve të ndaluara. Rruga e drejtë është që ata t’i kthehen Allahut, duke u penduar tek Ai nga mëkatet që bëjnë sepse; **“Mëkatarrët më të mirë janë ata që pendohen.”** (Hadithi është saktë dhe e transmeton Ibn Maxheh me nr. 4 251 etj)

6 - **“O robërit e Mi! Ju nuk mund të arrini kurrë tek ajo që mund të më shkaktojë Mua dëm, e as tek ajo që do të më sillte dobi.”** Rreth këtyre fjalëve Ibn Rexhebi (2/43) thotë: **“Kjo do të thotë se njerëzit nuk i kanë mundësitë që t’i bëjnë dobi apo dëm Allahu sepse Allahu në Qënien e Tij është i Panevojshëm dhe i Falënderuar, nuk ka nevojë për adhurimet e robërve dhe e mira e tyre nuk i kthehet Atij, përkundrazi, janë ata që kanë dobi dhe dihet se Ai nuk mund të dëmtohet me mëkatet e tyre, por ata janë që dëmtohen.”** Allahu i Madhëruar thotë: **“Mos të të pikëllojnë ata që nxitojnë për në mosbesim, sepse Allahun nuk e dëmtojnë aspak.”** Dhe: **“Kushdo që kthehet prapa, nuk i bën kurrfarë dëmi Allahut.”** (Suretu Ali Imran, 144)

7 - **“O robërit e Mi! Sikur i pari dhe i fundit nga ju, njerëzit dhe xhinët, të ishit të devotshëm si zemra më e devotshme e njërit prej jush, kjo nuk do t’i shtonte sundimit Tim asgjë. O robërit e Mi! Sikur i pari dhe i fundit nga ju, njerëzit dhe xhinët, të ishit të prishur si zemra më e prishur e njërit prej jush, kjo nuk do t’i pakësonte sundimit Tim asgjë.”** Në këto dy fjali sqarohet sundimi absolut i Allahut të Madhëruar, si dhe pavarësia e Tij absolute nga krijesat. Gjithashtu, sikur robërit të përfaqësonin gjithë devotshmërinë apo të keqen më të madhe që mund të ekzistojë, kjo nuk do t’i shtonte e as nuk do t’i pakësonte sundimit të Tij asgjë. Devotshmëria është në dobi të njeriut që e tregon atë, ndërsa e keqja është në dëm të atyre që e tregojnë atë.

8 - **“O robërit e Mi! Sikur i pari dhe i fundit nga ju, njerëzit dhe xhinët, të ngriheshit (qëndronit) në një vend dhe dëshirat dhe lutjet të m’i drejtonit Mua, dhe Unë t’i përgjigjesha lutjes së çdonjërit, kjo nuk do të zvogëlonte asgjë nga ajo që kam Unë, njësoj si gjilpëra që nuk sjell asgjë kur ngulet në det.”** Këto fjalë pasqyrojnë pasurinë absolute të Allahut të Madhëruar dhe nevojën që njerëzit kanë për të. Gjithashtu, nëse xhinët dhe njerëzit do mbledheshin dhe do t’u plotësoheshin dëshirat nga Allahu, duke filluar nga i pari, e deri tek i fundit, Atij do t’iu ndikonte aq sa mund marrë ujë gjilpëra kur zhytet në det. Kuptimi i këtij krahasimi është se në pasurinë e Tij nuk ndodh asnjë pakësim sepse ajo që merr gjilpëra nga uji nuk merret në kosideratë, si në peshore, ashtu edhe kur shihet me sy të lirë.

9 - **“O robërit e Mi! Çdo gjë varet nga veprat tuaja, të cilat tek Unë janë të ruajtura dhe të llogaritura, e për të cilat Unë do t’ju shpërblej. Prandaj, kush gjen mirë le të falënderojë Allahun, ndërsa kush gjen të kundërtën të mos fajësojë asnjë përveç vetes.”** Kjo tregon se njerëzit në këtë botë janë të urdhëruar për të praktikuar disa urdhëra dhe për t’u distancuar nga disa të

ndaluar. Ndaj, çdo gjë që ndodh prej tyre, qoftë e mirë ose e keqe, do t'u llogaritet dhe gjithsecili do e ketë para vetes atë që ka punuar. Nëse ka punuar mirë do gjejë të mira, e nëse ka punuar keq do gjejë të këqija. Allahu i Madhëruar thotë: **“Kush ka bërë ndonjë të mirë qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë.”** (Suretu Zelzele, 7-8) Ai që bën një të mirë do ta ketë shpërblimin e saj përpara vetes, ndërsa shpërblimi është mirësi e Allahut për robin e Tij. Veprimi i veprave të mira në këtë botë është sukses nga ana e Allahut të Madhëruar që ia jep një rob, ndaj Atij i takon falënderimi, si në fillim, ashtu edhe në fund. Nga ana tjetër, ai që do të ketë të këqija para vetes, do t'i ketë si pasojë e duarve të tij, e kështu nuk duhet të fajësojë Allahun për mëkatet kryera sepse ato i kthehen vetëm atij. Kështu, nëse gjen dënimin para vetes të mos fajësojë askënd përveç vetes së tij.

10 - Përfitimet e nxjerra nga hadithi janë:

1 – Kemi hadithe që transmetohen nga Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), të cilat ai i përcjell nga Zoti i tij. Ato përmbajnë përemra, të cilët i drejtohen Allahut, ndryshe ato quhen hadithe të shenjta.

2 - Allahu i Madhëruar ia ka ndaluar padrejtësinë Vetes, është pastruar prej saj dhe i ka pohuar Vetes të kundërtën e saj që është drejtësia absolute.

3 - Allahu i Madhëruar e ka ndaluar padrejtësinë për robërit e tij, qoftë ndaj vetes, qoftë ndaj të tjerëve.

4 - Njerëzit kanë shumë nevojë që t'i luten Zotit të tyre për t'i udhëzuar e për t'i furnizuar me ushqime dhe veshmbathje, e shumë nevoja të tjera që kanë të bëjnë me çështjet e kësaj bote.

5 - Allahu pëlqen që robërit e tij t'i luten për çdo gjë që kanë nevojë prej çështjeve të dunjasë dhe të fesë.

6 - Allahu është Sunduesi absolut dhe robërit nuk mund të arrijnë deri aty sa t'i bëjnë dobi apo dëm, përkundrazi, dëmi dhe dobia janë vetëm për ta.

7 - Njerëzit nuk shpëtojnë nga gabimet, prandaj duhet që të pendohen dhe të kërkojnë falje nga ato gabime.

8 - Devotshmëria dhe e keqja ekzistojnë në zemra, kjo duke u bazuar në fjalën e Tij që thotë; **“...si zemra më e devotshme e njerit prej jush”** dhe; **“...si zemra më e keqe e njerit prej jush.”**

9 - Sundimin e Allahut nuk mund ta shtojë bindja e të mirëve e as ta pakësojë mëkati i gjynahqarëve.

10 - Pasuria dhe sundimi absolut i Allahut. Nëse Ai do u jepte krijesave duke filluar nga i pari e deri tek i fundit i tyre, çdo gjë që mund t'i kërkonin nuk do i pakësonte sundimit të Tij asgjë, po ashtu edhe depozitave të Tij.

11 - Allahu i nxit robërit të binden dhe i qorton nga mëkatet, sepse të gjitha do u merren në llogari.

12 - Atij që Allahu i jep sukses në rrugën e mirë ai ka për të fituar lumturinë e kësaj bote dhe botës tjetër, ndërsa mirësia kthehet tek Allahu për suksesin që i dha njeriut në ndjekjen e rrugës së drejtë, gjithashtu edhe për shpërblimet që merr për to.

13 - Ai që është i shkujdesur dhe bën vepra të këqija do fitojë humbjen dhe do të pendohet, në një kohë kur nuk do bëjë më dobi pendimi.

25 - Na i morën të pasurit të gjitha shpërblimet.

Ebu Dherri (radijAllahu ‘anhu) transmeton se disa nga shokët e të Dërguarit të Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i thanë atij: “O i Dërguari i Allahut! Pasanikët na e kaluan në shpërblime, falen dhe agjërojnë si ne dhe japin sadaka me tepricën e pasurisë së tyre. I Dërguari i Allahut u tha: **“A nuk u ka mundësuar Allahu që dhe ju të keni me çfarë të bëni sadaka? Vërtet, çdo tesbih (lavdërim Allahut) është sadaka, çdo tekbir (madhërim Allahut) është sadaka, çdo tahmid (falënderim Allahut) është sadaka, çdo tehlil (dëshmia: La ilahe ila Allah) është sadaka. Urdhërimi për të mirë është sadaka, ndalimi nga të këqijat është sadaka, edhe marrëdhëniet seksuale (bashkëshortore) janë sadaka”**. Njerëzit i thanë: **“O i Dërguari i Allahut, edhe kur ndonjëri prej nesh kryen marrëdhënie epshore ka shpërblim?”** Ai u tha: **“Më thoni nëse dikush epshin e tij e përdor në haram, a nuk ka mëkat për të? Po ashtu, nëse e përdor në hallall do të ketë shpërblim.”** Transmeton Muslimi.

1 - Shokët e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) janë njerëzit që tregojnë kujdesin më të madh për punët e hajrit, duke i paraprirë të gjithë njerëzit në të mira. Ata garonin me punët e mira dhe gjithsecili dëshironte t'i bashkangjitej atij që e ka paraprirë me ndonjë shpërblim. Për këtë arsye, një grup nga të

varfërit e shokëve të Profetit i treguan të Dërguarit të Allahut namazin dhe agjërimin që bënë të pasurit bashkë me ta, si dhe diferencën që i dallonte ata, për shkak të sadakasë që jepnin nga pasuria që u tepronte. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i udhëzoi duke iu treguar ekzistencën e shumë lloje sadakash, të cilat mund t’i venë në zbatim edhe të varfërit, si dhikret, urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja, etj.

2 - Sadakatë, për të cilat Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i udhëzoi të varfërit që t’i praktikojnë, ndahen në dy kategori: në kategorinë e parë bëjnë pjesë ato sadaka dobia e së cilave u kthehet vetë atyre **(personave që e praktikojnë)**, siç është; tesbihi, tahmidi dhe tehlili. Nga ana tjetër, ekziston një kategori tjetër sadakaje, dobia e e së cilës jep efekte edhe tek të tjerët, pra dobia në këtë rast është e dyfishtë si për ata që e japin, ashtu edhe për ata që e marrin. Këtu bën pjesë urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja, si dhe raportet intime mes bashkëshortëve.

3 - Ndër veprat e lejuara që njeriu kryen, me anë të të cilave ruan veten, mund të konsiderohen adhurime nëse nijeti është i mirë, ashtu siç është rasti kur njeriu kryen marrëdhënie intime me bashkëshorten, nëse me këtë vepër ai ka për qëllim ruajtjen e vetes dhe të familjes nga imoraliteti, si dhe lindjen e fëmijëve.

4 - Përfitimet e nxjerra nga hadithi janë:

1 - Kujdesi që tregonin sahabët në kryerjen e veprave të mira, si dhe garimin që bënë njëri - tjetrin me të mira.

2 - Sadakaja nuk është e kufizuar vetëm në dhënien e e pasurisë, edhe pse kjo është origjina e saj.

3 - Inkurajimi për të bërë tesbih, tekbir, tahmid dhe tehlil, si sadakaja që muslimani bën për veten e tij.

4 - Ai që nuk mund të kryejë ndonjë adhurim për shkak të pamundësisë, duhet t’i shpreshtojë ato adhurime që ka mundësi të kryejë.

5 - Inkurajimi i myslimanit që të urdhërojë në të mirë dhe të ndalojë nga e keqja, duke qenë se kjo vepër konsiderohet sadaka, jo vetëm për të tjerët, por edhe për të.

6 - Raporti intim me një të mirë konsiderohet sadaka për atë dhe të tjerët.

7 - Dijetari mundet t'u kthehet edhe njëherë fjalëve që ka thënë, me qëllim që të sigurohet.

8 - Pohimi i kijasit (**analogjisë**) si bazë e saktë argumentimi, sepse Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) shëmbëlleu miratimin e shpërblimit të atij që kryen marrëdhënie të lejuara intime, me marrjen e mëkateve nëse njeriu kryen marrëdhënie të ndaluara. Kijasi (**analogjia**) që përdoret në këtë hadith është ai që quhet; analogji me të anasjelltën.

26 - Për çdo nyje të trupit duhet dhënë sadaka.

Ebu Hurejra (radijAllahu 'anhu) transmeton se i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Për çdo nyje të njeriut, çdo ditë kur lind dielli duhet dhënë sadaka. Nëse pajton dy vetë edhe kjo punë është sadaka, nëse e ndihmon dikë që të hipë në kafshën e tij ose e ndihmon të ngarkojë barrën në kafshën e tij (kalë ose deve), edhe kjo punë është sadaka. Fjala e mirë është sadaka, çdo hap, të cilin e hedh për të shkuar në namaz është sadaka, edhe largimi nga rruga e asaj gjëje që pengon kalimtarët është sadaka.”** Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

1 - Në fjalët e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): **“Për çdo nyje të njeriut, çdo ditë kur lind dielli duhet dhënë sadaka”**, me nyjet nënkuptojmë nyjet e gjymtyrëve, të cilat numërohen rreth treqind e gjashtëdhjetë nyje, komenti për të cilat vjen në Sahihun e Muslimit në hadithin që transmeton Aisha me nr. 1 007. Kjo do të thotë se në çdo ditë që lind dielli, për të gjitha këto nyje duhet dhënë sadaka brenda asaj dite. Pas kësaj, ai përmendi disa shembuj, me të cilat arrihet dhënia e sadakasë, e që ndahen në veprime dhe fjalë të kufizuara (**për atë që i kryen**) dhe vepra që dobia u kalon edhe të tjerëve. Në Sahihun e Muslimit, në hadithin që transmeton Ebu Dherri me nr. 720 thuhet: **“Të gjithë këtë e zëvendësojnë dy rekate namaz nafile të paradites (duha)”**, duke qenë se me faljen e këtyre dy rekateve vihen në lëvizje të gjitha këto gjymtyrë në adhurimin, i cili është namazi. Për këtë arsye është i mjaftueshëm, kundrejt të gjitha sadakave që duhet të jepen atë ditë.

2 - Çdo vepër e mirë, sido që të jetë, me fjalë apo veprime vepra, konsiderohet sadaka. Ajo që përmendi i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) në hadith është thjesht një përngjasim dhe nuk është diçka e kufizuar. Kështu, pajtimi mes dy njerëzve arrihet nëpërmjet gjykimit apo pajtimit me drejtësi, e

në këtë rast është sadaka dhe ka të bëjë me të shprehurin dhe se mirësia e saj shkon edhe tek të tjerët. Duke qenë se sadaka konsiderohet edhe një fjalë e mirë, qoftë dhikër, dua, lexim, mësim, urdhërim për të mirë dhe ndalim nga e keqja etj. Në këtë rast është sadaka që shprehet me gjuhë dhe dobia e saj është si për njeriun që e kryen ashtu edhe për të tjerët. Gjithashtu, çdo hap që bën njeriu për në namaz konsiderohet sadaka që muslimani i jep vetes, vepër e cila konsiderohet në dobi të tij. Edhe largimi i pengesave nga rruga si p.sh.; ferrat, gurët, xhamat, etj., janë sadaka, dobia e së cilave shkon edhe për të tjerët.

3 - Përfitimet e nxjerra prej këtij hadithi janë:

1 - Çdo nyje e trupit të njeriut, për çdo ditë duhet të japë sadaka sido qoftë ajo në dobi të tij, apo edhe në dobi të të tjerëve.

2 - Hadithi nxit për pajtimin mes njerëzve me drejtësi të plotë.

3 - Hadithi e nxit muslimanin që të ndihmojë të tjerët në gjërat që ata kanë nevojë, të tilla si ndihma për të hipur në kafshë, apo për t'i mbartur gjëra mbi të.

4 - Inkurajimi për të shprehur çdo fjalë të mirë, çfarëdo që të jetë: dhikër, lexim, mësim, thirrje, etj.

5 - Vlera e çdo hapi të hedhur për në xhami. Madje, në një hadith tjetër është përmendur se njeriut i shkruhen hapat që ka bërë për të shkuar dhe për t'u kthyer nga xhamia, hadith të cilin e transmeton Muslimi me nr. 663.

6 - Vlera e largimit të pengesave nga rruga. Në një hadith tjetër citohet se kjo vepër konsiderohet prej degëve të besimit, hadith, të cilin e transmeton përsëri Muslimi me nr. 58.

27 - Devotshmëria është morali i mirë.

Neuas bin Semani (radijAllahu ‘anhu) transmeton se I Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Mirësia është morali i mirë, ndërsa mëkati është ajo diçka që të bren në shpirtin tënd dhe nuk ke dëshirë që njerëzit ta dinë.”** Transmeton Muslimi.

Nga ana tjetër, Uabisa bin Meabed transmeton duke thënë: “Një herë shkova tek i Dërguari i Allahut e ai më tha: **“A erdhe të pyesësh për mirësinë dhe**

mëkatin?” Unë i thashë: **“Po!”** Ai më tha: **“Kërkoi përgjigje zemrës, sepse mirësia është ajo tek e cila shpirti dhe zemra qetësohen, ndërsa mëkati është ajo që të bren në shpirt dhe nuk të qetësohet zemra në të, pavarësisht nëse njerëzit të japin opinione miratuese.”** Ky hadith është i saktë dhe e kemi transmetuar nga Musnedet e dy imamëve, Ahmed bin Hanbelit dhe Darimiut me zinxhirë të mirë transmetimi.

1 - Hadithin e Neuasit e transmetoi Muslimi, ndërsa hadithin e Uabisas e transmetoi Ahmedi dhe Darimiu me një zinxhir transmetimi, saktësia e të cilit është i përfolur, e megjithatë ai ka hadithe të tjera që dëshmojnë për të, e që janë me zinxhir të mirë transmetimi. Ato i përmendi hafidh Ibn Rexhebi në librin e tij Xhamiul Ulumi uel Hikem. Në të vërtetë, hadithi ngjason shumë me hadithin e Neuas bin Semanit.

2 - Mirësia është fjalë gjithpërfshirëse që përmbledh fshehtësitë në zemër dhe cilësitë që pasqyrohen në gjuhë dhe gjymtyrë. Ajeti: **“Nuk është mirësi kthimi i fytyrës suaj nga lindja apo perëndimi...”** (Suretu Bekare, 177) është mjaft i qartë në këtë drejtim, sepse pjesa e parë e tij përmbledh gjërat e fshehta **(ndjenjat e brendshme)**, ndërsa fundi i tij flet për veprat e dukshme. Kur përmendet Mirësia, në shumicën e rasteve kihet për qëllim respekti ndaj prindërve, e atëherë kur kjo bashkohet me ruajtjen e lidhjeve farefisnore. Në këtë rast, me të nënkuptohet respekti ndaj prindërve dhe ruajtja e lidhjeve farefisnore. Mirësia, gjithashtu, vjen e lidhur me devotshmërinë, siç thuhet në fjalën e Allahut: **“Ndhimoheni njëri - tjetrin në mirësi e devotshmëri.”** (Suretu Maide, 2) ndaj, kur radhiten si në këtë ajet, atëherë mirësia komentohet me adhurimin ndërsa devotshmëria komentohet me braktisjen e të ndaluarave. Nëse ato vijnë të ndara nga njëra – tjetra, atëherë njëra merr kuptimin e tjetrës, gjë e cila ngjan me shembullin e Islamit dhe imanit, fakirit dhe nevojtarit.

3 - Në hadithin e Neuasit thuhet: **“Mirësia është morali i mirë.”** Me moralin e mirë mund të nënkuptohet ai moral i veçantë që njihet me këtë emër, ndërsa nënkuptimi i mirësisë me të bëhet për të treguar rëndësinë dhe vlerën e tij të madhe. Arsyetimi i mësipërm ngjason me kuptimin fjalëve të Profetit (sal-Allahu ‘alejhi ue sel-lem) kur thotë: **“Feja është këshillë”,** apo **“Haxhi është Arafati.”** Nga ana tjetër, mund të konsistojë edhe në përgjithësimin e çdo vepre që është e mirë dhe për këtë dëshmon hadithi i Aishes, kur tregon se morali i Profetit ishte si Kurani, e që do të thotë se ai zbatonte normat e tij, u bindej urdhërave dhe largohej nga veprat e ndaluara.

4 - **“...ndërsa mëkati është ajo që kurdis në shpirtin tënd dhe nuk ke dëshirë ta dinë njerëzit.”** Ka mëkate që janë mjaft të qarta, por ka edhe të tjera që kurdisen në krahare dhe shpirti nuk qetësohet nga to, madje nuk pëlqen që njerëzit t'i dijnë sepse është diçka e turpshme nëse veprohen, ndaj ky njeri druhet nga gjuhët e njerëzve në lidhje me të. Kjo pjesë e hadithit është e ngjashme me tri hadithet që kemi përmendur më sipër: **“Ai që ruhet nga gjërat e dyshimta, ka ruajtur fenë dhe nderin e tij”** dhe hadithin: **“Mos e bëj atë punë që e sheh të dyshimtë”**, si dhe hadithin: **“Prej fjalëve (të urta) që bota i ka mbajtur mend nga predikimet e profetëve të mëparshëm është: “Kur nuk ke turp, bëj ç'të duash.”**

Me mëkat nënkuptohen mëkatet e qarta dhe të dyshimta. Mëkati përmendet gjithashtu, edhe me armiqësi, ashtu siç thotë Allahu i Madhëruar: **“E mos e ndihmoni njëri - tjetrin në gjynahe dhe armiqësi.”** (Suretu Maide, 2) Këtu, armiqësia i referohet agresionit dhe padrejtësisë, ku bën pjesë armiqësia ndaj njerëzve në gjakrat, pasuritë dhe nderet e tyre.

5 - Në hadithin e Uabisas mirësia iu referua veprës që qetëson zemrën dhe shpirtin, unë nuk vërej ndonjë dallim mes këtyre të dyjave. Fjalja e dytë mund të pohojë të parën, duke qenë se vijnë me të njëjtin kuptim, ku mëkati i referohet fjalisë së parë, gjithashtu është me kuptim të njëjtë komentin e mëkatit në hadithin e Neuasit.

6 - Fjalët e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) në fillim të hadithit të Uabisas: **“Kërkoji përgjigje zemrës”** dhe në fund të tij: **“...edhe nëse njerëzit të japin përgjigje e përgjigje”**, pohojnë se veprat e dyshimta, tek të cilat nuk gjen qetësi zemra, më e mira është që të lihen, edhe nëse njerëzit e lejojnë atë duke dhënë fetva. Kuptimi është se njeriu që posedon besim, që i frikësohet Allahut dhe druhet prej Tij, nuk duhet t'i japë përparësi një diçkaje, për shkat të së cilës nuk gjen rehati. Ndodh që njeriu të kërkojë përgjigje nga një njeri që nuk ka dije, ose mund të kërkojë nga një tjetër që posedon dije, por që në atë çështje mund të mos ketë argument tek i cili mbështetet opinioni. Nëse në një çështje ka argument nga Kurani dhe Suneti, atëherë obligohemi që të shkojmë tek argumenti. Kërkimi i përgjigjes nga zemra nuk ka vlerë për mëkatarët, sepse ka prej tyre që i shfaqin mëkatet dhe nuk turpërohen para Allahut e as para njerëzve. Njerëz të tillë bien në haramet të hapura, ndërsa në dyshime bien edhe më shumë.

7 - Ajo që u tregua në hadithin e Uabisas kur Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e lajmëron atë që erdhi për të pyetur para se të pyeste, komentohet e për këtë Allahu e di më mirë, se ai e dinte më parë interesin që tregonte ky sahab

në njohjen e mirësisë dhe gjynahut. Pra, mund të ketë ndodhur që ai ta ketë pyetur edhe më parë për këtë gjë.

8 - Përfitimet e nxjerra prej këtij hadithi janë:

1 - Hadithi tregon rëndësinë e madhe që morali i mirë.

2 - Mirësia dhe mëkati janë fjalë esenciale.

3 - Në çështjet e fesë, muslimani duhet të kryejë ato vepra që kosiderohen hallalle të qarta dhe jo të dyshimta.

4 - Besimtari që i frikësohet Allahut nuk kryen vepra për të cilat nuk do të jetë i qetë, edhe nëse i japin fetva të ndryshme, përderisa nuk është çështje e qartë në legjislacion si shembulli i ruhsave. **(Ajo që ndryshon nga gjendja fillestare në gjendje lehtësimi dhe zbutje, siç është rasti i namazit të udhëtarit. (Sh p.))**

5 - Në hadith vërehet kujdesi që tregonin sahabët mbi njohjen e hallallit dhe haramit, mirësisë dhe mëkatit.

28 - U porosis me devotshmëri dhe moral të mirë.

Ebu Nexhih Irbad bin Sarijeh (radijAllahu ‘anhu) transmeton: “I Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) na dha një këshillë të prekëse, prej së cilës zemrat u tronditën dhe sytë u përlotën. Atëherë, ne i thamë: **“O i Dërguar i Allahut! Fjalët e tua duket sikur janë këshillë lamtumire, kështu që na lër ndonjë porosi.”** Ai u përgjigj: **“Ju porosis t'i frikësoheni Allahut, ta dëgjoni dhe t'i bindeni, edhe nëse ju udhëheq një skllav. Ai që do të jetojë (më gjatë) ka për të parë kundërshti të shumta, ndaj përmbajuni Sunetit tim dhe sunetit të prijësave të drejtë, të cilët ju udhëzojnë. Kapuni fort pas tij (Sunetit) me dhëmbë e dhëmballë. Kini kujdes nga shtesat (në fe) sepse çdo shtesë shpie drejt humbjes.”** Transmeton Ebu Davudi dhe Tirmidhiu, ky i fundit thotë se hadithi është hasen sahih.

1 - Në fjalët e Irbadit: **“I Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) na dha një këshillë të prekshme, prej së cilës zemrat u tronditën dhe sytë u përlotën”**, kuptojmë se këshilla kur përcillet me fjalë inkurajuese **(për mëshirën e Allahut)** dhe kërcënuese **(nga dënimi i Tij)** ndikon në shpirt dhe

arrin të prekë zemrat, e si rrjedhojë ato tronditen nga frika ndaj Allahut. Irbadi e cilësoi këtë këshillë se ishte e përbërë nga tri emocione: retorika, tronditja e zemrës dhe përlotja e syve. Ibn Rexhebi në librin e tij Xhamiul Ulumi uel Hikem (2/111) thotë: **“Përdorimi i retorikës gjatë këshillimit është i dobishëm sepse prek zemrën dhe pranohet nga ajo. Retorika, në të vërtetë është arritja e të kuptuarit të mendimeve dhe të drejtuarit e tyre drejt zemrave të dëgjuesve, në formën më të mirë dhe me shprehjet më të përshtatshme, më letrare, më të ëmbla për dëgjuesit dhe ato që prekin më shumë zemrat.”** Allahu i Madhëruar i ka cilësuar besimitarët si njerëz që iu tronditen zemrat dhe iu lotojnë sytë gjatë përmendjes së Allahut. Për këtë, Allahu i Madhëruar thotë: **“Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, zemrat e të cilëve dridhen kur përmendet Allahu dhe u forcohet besimi kur u lexohen shpalljet e Tij, dhe vetëm te Zoti i tyre mbështeten.”** (Suretu Enfal, 2) **“Kur dëgjojnë për atë (Kuranin) që i është zbritur të Dërguarit, i sheh se si u rrjedhin lotët nga sytë.”** (Suretu Maide, 83)

2 - Në fjalët e tij: **“O i Dërguar i Allahut, fjalët e tua duken si të ishin këshillë lamtumire, ndaj na lër ndonjë porosi”**, kjo këshillë ngjasonte me porositë që lë dikush në fundin e jetës. Për këtë arsye, sahabët e ndershëm që ishin shumë të kujdesshëm në çdo të mirë, kërkuan nga i Dërguari i Allahut që t’u linte ndonjë porosi të përmbledhur, me qëllim që të kapeshin pas saj dhe ta kishin si shembull. Duke qenë se porosia në çastet e ndarjes ka ndikim të madh në shpirtra, ata e morën si këshillë lamtumire, ndaj edhe e kërkuan.

3 - Në fjalët e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“Ju porosis t’i frikësoheni Allahut”, takvaja (devotshmëria) ndaj Allahut të Madhëruar arrihet atëherë kur njeriu vendos një mburojë mes tij dhe zemërimit të Allahut dhe kjo vjen me kryerjen e adhurimeve, duke u distancuar nga të ndaluarat dhe duke u besuar fjalëve të tij. Kjo është porosia që Allahu u ka lënë të parëve dhe atyre që do vijnë pas tyre, duke thënë: “Ne i patëm porositur edhe më parë ithtarët e librit, gjithashtu edhe juve që t’i frikësoheni Allahut.”**

Takvaja bëhet shkaktar i çdo të mire, shpëtim në këtë botë dhe në botën tjetër. Urdhëri për takva vjen në shumë ajete kuranore, e veçanërisht në ajetet që fillojnë me fjalët: **“O ju që besuat!”** Një urdhër i tillë vjen edhe nga porositë profetike që i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) u drejtonte shokëve të tij.

4 - **“Të dëgjoni dhe t’i bindeni edhe nëse ju udhëheq një skllav.”** Me këto fjalë, Profeti porosit për dëgjueshmëri dhe bindje ndaj udhëheqësve, përderisa

ata nuk urdhërojnë që të kundërshtohet Allahu, edhe nëse ky udhëheqës është skllav. Dijetarët janë të një mendimi se skllavi nuk është i denjë për të qenë prijës, ndërsa ajo që u transmetua në këtë hadith apo në hadithe të tjera interpretohet në disa kuptime: ka mundësi që hadithi të përmbajë hiperbolë lidhur me bindjen dhe dëgjueshmerinë ndaj një skllavi nëse bëhet prijës, edhe pse një gjë e tillë nuk ndodh. Në një kuptim tjetër: kur prijësi lë nënpunës një skllav për të drejtuar punët e një fshati, apo grupi njerëzish. Një kuptim tjetër mund të jetë: kur ai e mori fronin ishte i lirë, por u quajt skllav duke marrë parasysh gjendjen që ishte më parë. Ose ndodh që një skllav me njerëzit e tij (që i janë bërë krah) të ketë triumfuar me forcë ndaj të tjerëve, e në këtë rast gjërat nën pushtetin e tij janë stabilizuar dhe marrja e pushtetit prej tij mund të shkaktojë pasoja më të këqia sesa qëndrimi i tij në atë vend **(post)**.

5 - **“Ai që do të jetojë (më gjatë) do të shohë kundërshtime të shumta.”** Ky është një argument që pohon profecinë e tij sepse ai na lajmëroi për diçka që do të ndodhë në të ardhmen, gjë e cila u realizua ashtu siç na paralajmëroi ai. Dihet se ata sahabë që jetuan më gjatë arritën të shihnin kundërshtime të mëdha që binin ndesh me rrugën e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe shokët e tij. Kjo gjë u pasua me shfaqjen e disa grupeve të devijuara nga rruga e drejtë siç ishin: kaderitë, hauarixhët, etj.

6 - **“Ndaj përmbajuni sunetit tim dhe sunetit të prijësave të drejtë, të cilët ju udhëzojnë. Kapuni fort pas tij (sunetit) me dhëmballët tuaja.”** Në kohën që Profeti na njoftoi për ekzistencën e përçarjeve, ai na tregoi rrugën e sigurt dhe shpëtimin. Kjo gjë arrihet duke u kapur fort pas Sunetit të tij dhe sunetit të prijësave të drejtë, të cilët ishin: Ebu Bekri, Omeri, Othmani dhe Aliu (radijAllahu ‘anhuma). I Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e ka cilësuar udhëheqjen e tyre si udhëheqje në rrugën e Profetit, siç është transmetuar në hadithin e Sefines ku thotë: **“Udhëheqja në udhën profetike do të ekzistojë tridhjetë vjet, e më pas Allahu do t’ia japë sundimin kujt të dojë.”** (E transmeton Ebu Daudi me nr. 4 646, etj. Hadithi është i saktë dhe atë e ka përmendur Albani në librin Vargu i haditheve të sakta me nr. 460. Ai transmetoi edhe nga nëntë dijetarë, të cilët e kanë saktësuar këtë hadith)

Ibn Rexhebi (2/120) thotë: **“Suneti është ajo rrugë që duhet ndjekur, në të cilën ecur udhëheqësit e tij të drejtë, si në besim, ashtu edhe në punë e fjalë. Ky është Suneti i plotë dhe për këtë arsye, të parët tanë të hershëm e përdornin termin e Sunetit vetëm atëherë kur ky term përfshinte të gjitha këto kushte. Një kuptim i i ngjashëm mbi Sunetin është transmetuar nga Haseni, Ezaiu dhe Fudejl bin Ijadi. Shumë dijetarë të mëvonshëm, termin e sunetit e veçojnë vetëm për çështjet që kanë të**

bëjnë me besimin sepse ai është baza e fesë dhe kush e kundërshton atë ndodhet në një rrezik të madh.” I Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka kumbëngulur që të kapemi fort pas Sunetit të tij dhe sunetit të udhëheqësve të drejtë, duke na këshilluar: **“Përmbajuni!”**, e kjo në formën urdhërore. Pas kësaj, na udhëzoi që t’i përmbahemi akoma më shumë Sunetit, duke na këshilluar: **“Kapuni fort pas tij (Sunetit) me dhëmbë e dhëmballë.”** Togfjalëshi **“me dhëmbë e dhëmballë”** i shprehur në hadith është metaforë, e cila pasqyron fuqinë që duhet të përdorim për t’ju përmbajtur Sunetit dhe për ta zbatuar atë. **(Gjithashtu tregon mllëfin e atyre që e kundërshtojnë Sunetin dhe largojnë të tjerët prej tij. (Sh.P.))**

7 - “E kini kujdes nga shtesat (në fe) sepse çdo shtesë shpie drejt humbjes.” Në versionin e Ebu Daudit me nr. 4 607 thuhet: **“Kini kujdes nga shtesat në fe sepse çdo shtesë konsiderohet bidat dhe çdo bidat të shpie në humbje.”** Shtesat në fe janë risi që shpiken në fe, ndërsa nuk kanë kurrfarë baze origjine, e të cilat i kthehen përçarjes dhe kundërshtimeve të nënçmuara që përmendi i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) në fjalën e tij kur tha: **“Ai që do të jetojë (më gjatë) do të shohë kundërshtime të shumta.”** I Dërguari i Allahut ka cilësuar se çdo bidat është humbje, prandaj nuk mund të ketë bidate të mira, duke u bazuar në fjalën e përgjithshme të Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) që thotë: **“sepse çdo bidat është humbje.”** Muhamed bin Nasri në librin e tij Suneti transmeton një hadith me zinxhir të saktë se Ibn Umeri ka thënë: **“Çdo bidat është humbje, edhe nëse njerëzit e shohin si të dobishme.”** Shatibiu, në librin e tij El iatisam transmeton nga Ibn Maxhishuni se ai e ka dëgjuar Malikun të ketë thënë: **“Kush shpik në Islam një bidat dhe e sheh si të dobishëm, ai ka pretenduar se Muhamedi e ka tradhëtuar shpalljen sepse Allahu i Madhëruar thotë: “Sot përsosa për ju fenë tuaj.”** Ndaj ajo që nuk njihej atëherë si fe nuk mund të njihet as sot.” Ndërsa Ebu Uthman Nejsaburi thotë: **“Ai që lë udhëheqës Sunetin për veten e tij në fjalë dhe në vepra, ka për të folur me urtësi, ndërsa ai që lë udhëheqës pasionet në fjalë dhe në vepra ka për të folur me bidate.”** (Shih Hiljetul eulija (10/244))

Përsa i përket hadithit, të cilin e transmeton Muslimi në Sahihun e tij me nr. 1 017 ku thuhet: **“Cilido që ngjall një traditë të mirë në Islam, i takon shpërblimi i saj dhe shpërblimi i atyre që e praktikojnë atë.”** Ky hadith aludon në dhënien e shembullit praktik të kryerjes së veprave të mira, siç është sqaruar në shkakun e transmetimit të këtij hadithi, sepse i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), ishte vetë ai që i nxiti njerëzit që të jepnin sadaka.

Në atë kohë, aty erdhi një prej ensarëve, duke mbartur një çantë të madhe dhe njerëzit kur e panë filluan të sillnin sadaka, atëherë, i Dërguari i Allahut i tha fjalët e mësipërme. Gjithashtu, hadithi komentohet edhe në kuptimin: ai që shfaq një prej suneteve të Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe e risjell atë në praktikë, ka bërë një shfaqje të Sunetit të Profetit, ashtu siç ndodhi me Umerin, i cili i tuboi njerëzit në namazin e teravive në Ramazan, duke qenë se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ishte falur me njerëzit disa netë të muajit të Ramazanit, por që e kishte lënë nga frika se mos bëhej detyrim, sikurse thuhet në Sahihun e Buhariut me nr. 2 012. Në kohën kur i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ndërroi jetë, shkaku prej të cilit ekzistonte frika e obligimit të atij namazi u largua, sepse legjislacioni u ndërpre me vdekjen e tij, mbeti vetëm pëlqyeshmëria e asaj vepre, të cilën e shfaqti Umeri. Gjithashtu, kjo vepër konsiderohet prej udhëzimit të prijësave të drejtë, ndërsa ajo që thuhet se Umeri është shprehur: **“Sa bidat i mirë!”** në transmetimin e Sahihut të Buhariut me nr. 2 010, ai ka pasur për qëllim shfaqjen e namazit të teravive, ndërsa me fjalën bidat ka patur për qëllim kuptimin e tij gjuhësor. E njëjta gjë është edhe ajo që bëri Uthmani, duke shtuar ezanin e dytë ditën e Xhuma, dhe këtë vepër e miratuan të gjithë sahabët, pra është vepër e udhëheqësave **(halifeve)** të drejtë të cilësuar nga i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Pra, ajo që përcillet nga Umeri -nëse është e saktë se ai ka thënë- : **“Sa bidat i mirë!”**, kjo nënkupton bidatin në terminologjinë gjuhësore.

8 - Përfitimet e nxjerra nga ky hadith janë:

- 1 - Pëlqimi i këshillës dhe përkujtimit në disa raste, për shkak të ndikimit që ka ajo në zemra.
- 2 - Në hadith vërehet kujdesi që tregonin sahabët për punët e hajrit, në rastin kur ata kërkuan që Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) t’u linte një porosi.
- 3 - Gjëja më e rëndësishme me të cilën mund të këshillohet njeriu është frika ndaj Allahut të Madhëruar, e cila konsiston në zbatimin e urdhërave dhe largimin nga veprat e ndaluara.
- 4 - Gjithashtu, prej gjërave më të rëndësishme për të cilat duhet të këshillohet njeriu është edhe bindja e respektimi i udhëheqësave, për shkak të dobive madhore që muslimanët përfitojnë **(nga ky veprim)** në jetën e kësaj bote dhe botës tjetër.
- 5 - Hiperbolizmi që përdoret në nxitjen për të dëgjuar dhe për t’iu bindur, edhe në rast se udhëheqësi mund të jetë skllav.

6 - Lajmërimi i Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) mbi ekzistencën e kundërshtive të shumta në popullin e tij dhe realizimi i këtij parashikimi është argument që pohon profecinë e tij.

7 - Rruga e drejtë, pavarësisht kundrështimeve në fe është që të kapemi fort pas zbatimit të Sunetit të Profetit dhe sunetit të udhëheqësve të drejtë.

8 - Në hadith tregohen vlerat e prijësve të drejtë që janë; Ebu Bekri, Umeri, Uthmani dhe Aliu dhe se ata janë të drejtuar dhe të udhëzuar.

9 - Këshillimi nga çdo shtesë në fe e që nuk ka pasur asnjë lloj origjine.

10 - Të gjitha bidatet janë humbje, ndaj nuk ka asnjë bidat të mirë.

11 - Të përbashkëtat e inkurajimit dhe kërcënimit gjatë këshillës, duke u bazuar në atë që ka thënë Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem):

“Përmbajuni!”, ndërsa për kërcënim tha: **“Kini kujdes!”**

12 - Në hadith tregohet rëndësia që ka porosia me frikë ndaj Allahut, dëgjueshmëria dhe bindja ndaj udhëheqësve, ndjekja e Sunetit dhe braktisja e bidateve, sepse Profeti i porositi shokët e tij me këto gjëra pas fjalëve të porosisë që dha: **“si të ishin këshillë lamtumire, ndaj na lër ndonjë porosi.”**

29 - Adhuroje Allahun duke mos i bërë shok asgjë.

Muadh bin Xhebeli (radijAllahu ‘anhu) transmeton duke thënë: “Një ditë e pyeta të Dërguarin e Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“O i Dërguari i Allahut! Më trego për një punë, e cila më shpie në Xhenet dhe më largon nga zjarri.”** I Dërguari i Allahut tha: **“Ke pyetur për diçka shumë të madhe, edhe pse ajo është e lehtë për cilindo që Allahu i Madhëruar ia lehtëson atë. Adhuroje Allahun dhe mos i bëj ortak askënd, fale namazin, jepe Zekatin, agjëroje Ramazanin dhe kryej Haxhin.”** Më pas, më tha: “A do të t’i tregoj të gjitha dyert e hajrit? Agjërimi është mburojë, sadakaja i shuan mëkatet, ashtu sikurse uji e shuan zjarrin, po ashtu edhe namazi i një njeriu në mes të natës; dhe nisi të lexonte ajetin: **“Ata ngrihen nga shtrati”** dhe e përfundoi me ajetin; **“si shpërblim për punët e mira që kanë bërë.”** Më pas më pyeti: **“A dëshiron të të tregoj thelbin e çështjes, shtyllën dhe kulmin e saj?”** Unë iu përgjigja: **“Patjetër o i Dërguari i Allahut.”** Ai vazhdoi: **“Thelbi i çështjes është Islami, shtylla e saj është namazi dhe kulmi i saj është**

Xhihadi.” Më pas shtoi: **“A të të tregoj thelbin e gjithë kësaj?” Unë iu përgjigja: “Patjetër o i Dërguari i Allahut!”** Ai kapi gjuhën e tij me dorë dhe më tha: **“Ndaloje këtë!”** Unë i thashë: **“O profeti i Allahut, vallë edhe për fjalët që flasim do të merremi në përgjegjësi?”** Ai m’u përgjigj: **“Mos të pastë nëna o Muadh, a ka gjë tjetër që i hedh njerëzit më shumë në zjarr se gjuhët e tyre të këqija?!”** Transmeton Tirmidhiu dhe thotë se ky hadith është me zinxhir të mirë transmetimi dhe i saktë.

1 - Fjalët e Muadhit: **“O i Dërguari i Allahut! Më trego për një punë e cila më shpie në Xhenet dhe më largon nga zjarri”**, pohojnë kujdesin që tregonin sahabët në njohjen e punëve, të cilat të shpien në Xhenet dhe të ruajnë nga zjarri. Në hadith pohohet gjithashtu, ekzistenca e Xhenetit dhe zjarrit dhe se të dashurit e Allahut bëjnë vepra të mira për të fituar Xhenetin dhe për t’u ruajtur nga zjarri. Në kundërshtim me fjalët e disa sufijve që shprehen se nuk e adhurojmë Allahun nga dëshira për Xhenetin e as nga frika prej zjarri, fjalë që janë të kota, sahabët tregonin kujdes të madh në njohjen e atyre punëve që të shpien në Xhenet dhe të largojnë nga zjarri. Allahu i Madhëruar kur flet për të dashurin e Tij, Ibrahimin thotë: **“Dhe më bëj një nga trashëgimtarët e Xhenetit të begatë!”** (Suretu Shuara, 85) Ajo që pohon se punët e mira janë shkak për hyrjen në Xhenet janë ajetet e shumta kuranore ku prej tyre është fjala e Allahut që thotë: **“Ja, ky është Xheneti që ju është dhënë trashëgim për atë që keni bërë.”** (Suretu Zuhruf, 72) **“Padyshim, ata që thonë: “Zoti ynë është Allahu!” dhe pastaj qëndrojnë në rrugën e drejtë, nuk do të kenë arsye për t’u frikësuar e as për t’u dëshpëruar (kur t’u vijë vdekja). Ata do të jenë banorë të Xhenetit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë si shpërblim për atë që kanë punuar.”** (Suretu Ahkaf, 13 - 14)

Ky pohim nuk bie ndesh me hadithin: **“Askush nuk do të hyjë në Xhenet me punën e tij.”** E pyetën: **“As ti o i Dërguari i Allahut?”** Ai u përgjigj: **“As unë, vetëm nëse Allahu më përfshin në mëshirën e Tij.”** (Transmeton Buhariu me nr. 6 463 dhe Muslimi me nr. 2 816) Kuptimi i fjalisë në hadith flet për kompensim, ndërsa tek ajetet tregohet se punët janë shkak i këtij kompesimi, ndaj hyrja në Xhenet nuk është kompensim me anë të punëve, përkundrazi, punët janë thjesht shkak për hyrjen në të. Allahu i Madhëruar me mirësinë e Tij i ka dhënë sukses këtij shkak, pra punëve të mira, gjithashtu, ka dhuruar shpërblimin që është hyrja në Xhenet. Kështu që e gjithë merita si për shkakun dhe shkaktarin, i kthehet vetëm tek Allahut të Madhëruar.

2 - Në fjalët e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“Ke pyetur për diçka shumë të madhe, edhe pse ajo është e lehtë për cilindo që Allahu i Madhëruar ia lehtëson atë”, tregohet rëndësia e madhe e kësaj pyetjeje, si**

dhe inkurajimi për të bërë pyetje të tilla, duke marrë parasysh faktin që i Dëguari i Allahut e cilësoi pyetjen të rëndësishme. Me gjithë madhështinë dhe vështirësinë e praktikimit të saj, i Dërguari i Allahut shpjegoi atë që tregonte lehtësinë e atyre veprave, për dikë që Allahu ia lehtëson.

Gjithashtu, kjo tregon se muslimani duhet të durojë në kryerjen e adhurimeve, edhe nëse janë të vështira për shpirtrat, sepse e ardhmja e durimit është e mirë. Allahu i Madhëruar ka thënë: “Atij që i frikësohet Allahut, Ai do t’ia lehtësojë çështjen.” (Suretu Talak, 4) Ndërsa i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Xheneti është rrethuar me vështirësi, ndërsa zjarri është rrethuar me epshe.”** (Transmeton Buhariu me nr. 6 487 dhe Muslimi me nr. 2 822)

3 - “Adhuroje Allahun dhe mos i bëj ortak askënd, fale namazin, jepe zekatin, agjëroje Ramazanin dhe kryeje Haxhin.” Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) shpjegoi se gjëja kryesore, me anë të së cilës njeriu afrohet tek Allahu, arrin të hyjë në Xhenet dhe të shpëtojë nga zjarri është praktikimi i obligimeve, të cilat në këtë hadith janë pesë shtyllat e Islamit që janë përmendur në Hadithin e Xhibrilit dhe në Hadithin e Ibn Umerit: **“Islami është ndërtuar mbi pesë shtylla.”** Nga ana tjetër, në një hadith kudsij Allahu I Lartësuar thotë: **“Nuk ka vepër më të mirë me të cilën të më afrohet robim e që të jetë më e dashur tek Unë se sa ajo vepër që Unë ia kam obliguar atij.”** Fjalët e Tij: **“Adhuroje Allahun dhe mos i bëj ortak askënd!”**

nënkuptojnë detyrimin që kemi ndaj Allahut, i cili është adhurimi i pastër vetëm për Të. Këtu përfshihet edhe dëshmia se Muhamedi është i Dërguari i Allahut, sepse adhurimi mund të njihet vetëm nëpërmjet besueshmërisë së tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe zbatimit të asaj me të cilën është dërguar.

Çdo punë që të afron tek Allahu nuk i bën dobi njeriut, derisa të jetë e sigurtë për Allahun dhe e ndërtuar mbi ndjekjen e Sunetit të të Dërguarit të Allahut, sepse dihet se dy dëshmitë janë të lidhura ngushtë me njëra - tjetrën. Prandaj, dëshmisë se: nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut, duhet t’i bashkangjitet edhe dëshmia se: Muhamedi është i Dërguari i Allahut. Pesë shtyllat e Islamit janë përmendur të radhitura në këtë hadith sipas rëndësisë që ka secila prej tyre. Këtu iu dha përparësi namazit sepse ai konsiderohet një lidhje shumë e fortë mes robit dhe Krijuesit të tij dhe se ai përsëritet pesë herë, gjatë një ditë - nate. Më pas vjen Zekati, i cili obligohet vetëm një herë në vit, dobia e të cilit është si për atë që e jep, ashtu edhe për atë që e merr. Më pas vjen agjërimi, i cili përsëritet çdo vit dhe në fund përmendet Haxhi që është detyrë vetëm një herë në jetë.

4 - **“Më pas më tha: “A do të t’i tregoj të gjitha dyert e hajrit? Agjërimi është mburojë, sadakaja i shuan mëkatet, ashtu sikurse uji e shuan zjarrin, po ashtu edhe namazi i një njeriu në mes të natës, dhe nisi të lexojë ajetin: “Ata ngrihen nga shtrati” dhe e përfundoi me ajetin; “si shpërblim për punët e mira që kanë bërë.”** Pasi Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) sqaroi obligimet, të cilat shkaktojnë hyrjen në Xhenet dhe shpëtimin nga zjarri, ai filloi të sqaronte disa punë vullnetare, të cilat i mundësojnë muslimanit shtimin e besimit dhe shpërblimeve, si dhe shlyerjen e mëkateve dhe gabimeve. Ato janë sadakaja, agjërimi dhe namazi i natës. Rreth agjërimit ai tha: **“Agjërimi është mburojë.”** Agjërimi është mburojë në këtë botë dhe në botën tjetër; në këtë botë të ruan nga rënia në mëkate. Abdullah bin Mesudi transmeton se i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“O ju të rinj, kush ka mundësi materiale le të martohet sepse është më e mirë për sytë dhe mbrojtje nga harami. E ai që nuk mundet le të agjërojë sepse kjo do ta mbrojë.”** (E transmeton Buhariu me nr. 1 905 dhe Muslimi me nr. 1 400) Gjithashtu, agjërimi është mburojë në botën tjetër nga zjarri. Në një hadith, i Dërguari i Allahut thotë: **“Kush agjëron një ditë në rrugë të Allahut, Allahu do t’ia largojë këtij njeriu fytyrën nga zjarri i Xhehenemit shtatëdhjetë vjet.”** (E transmeton Buhariu me nr. 2 840)

Fjalët e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“ndërsa sadakaja i shuan mëkatet, ashtu sikurse uji e shuan zjarrin”** tregojnë rëndësinë e madhe që ka sadakaja vullnetare dhe se Allahu me anë të saj i shlyen dhe i shuan mëkatet, ashtu sikurse uji shuan zjarrin. Në këtë rast bëhet fjalë për gabimet e vogla, por këtu përfshihen edhe gabimet e mëdha nëse njeriu pendohet prej tyre. Fjalët e Profetit ku merr si shembull shuarjen që sadakaja u bën mëkateve, si uji që shuan zjarrin, pohojnë fshirjen e të gjitha mëkateve, sepse uji që bie mbi zjarr e shuan plotësisht atë duke mos i lënë asnjë gjurmë.

Fjalët e tij: **“...po ashtu edhe namazi i një njeriu në mes të natës”**, tregojnë se kjo është vepra e tretë e dyerve të hajrit, me të cilat njeriu afrohet tek Allahu i Madhëruar. Më pas i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) lexoi fjalët e Allahut të Madhëruar që thotë: **“Ata ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre me frikë e shpresë dhe japin nga ajo që Ne iu kemi dhënë. Askush nuk di se çfarë gëzimesh janë fshehur për ata (në jetën tjetër), si shpërblim për punët e mira që kanë bërë.”** (Suretu Sexhde, 16-17)

Gjithashtu, i Dërguari i Allahut ka lajmëruar se; **“Namazi më i mirë, pas farzeve është namazi i natës.”** (E transmeton Muslimi me nr. 1 163) I Dërguari i Allahut përgatiti një tablo të qartë për dyert e hajrit nëpërmjet pyetjes: **“A do të t’i tregoj të gjitha dyert e hajrit?”** Kjo pyetje e tërheq më

shumë vëmendjen e Muadhit, për të parë rëndësinë e asaj që po i thuhej dhe të përgatitet të kuptojë çdo gjë që i thuhet.

5 - **“A dëshiron të të tregoj për thelbin e çështjes, shtyllën dhe kulmin e saj?”** Unë iu përgjigja: **“Patjetër, o i Dërguari i Allahut.”** Ai tha: **“Thelbi i çështjes është Islami, shtylla e saj është namazi dhe kulmi i saj është Xhihadi.”** Me çëshjten nënkuptohet diçka shumë e madhe, e cila është feja me të cilën u dërgua Profeti i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

Thelbi i saj është Islami, i cili përfshin namazin, Xhihadin, etj. Ai përmendi namazin, duke e cilësuar atë si shtyllë të Islamit, dhe duke e simbolizuar me ndërtesën e cila ngrihet mbi shtyllat e saj. Namazi është adhurimi më i rëndësishëm që përfshin trupin, dobia e të cilit i përfitohet vetëm prej atij që e kryen. Më pas, ai përmendi Xhihadin, i cili përfshin Xhihadin me shpirtin dhe Xhihadin kundër armiqve, qofshin ata jobesimtarë, apo edhe hipokritë. Ai e cilësoi si kulm të Islamit sepse me anë të Xhihadit tregohet forca e muslimanëve, triumfi i fesë së tyre dhe epërsia e saj, kundrejt feve të tjera.

6 - **“Më pas, më tha: “A të të tregoj thelbin e gjithë kësaj?”** Unë iu përgjigja: **“Patjetër, o i Dërguari i Allahut!”** Ai kapi gjuhën me dorën e tij dhe më tha: **“Ndaloje këtë!”** Unë i thashë: **“O profeti i Allahut, vallë edhe për ato që flasim do të merremi në përgjegjësi?”** Ai më tha: **“Mos të pastë nëna o Muadh! A ka gjë tjetër që i hedh njerëzit më shumë në zjarr përveç gjuhës së keqe?”** Këtu na del në pah rrezikshmëria e gjuhës dhe se ajo e shpie njeriun drejt shkatërrimit. E mira më e madhe është ruajtja e saj, me qëllim që prej saj të dalë vetëm mirësi, ashtu siç thotë i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“Kush siguron atë që ka mes dy buzëve dhe atë që ka mes dy këmbëve, unë atij do t’i siguroj Xhenetin.”** (Transmeton Buhariu me nr. 6 474) Në një hadith tjetër, i Dërguari i Allahut thotë: **“Kush i beson Allahut dhe botës tjetër, të flasë mirë ose le të heshtë.”** Ibn Rexhebi, gjatë komentimit të këtij hadithi në librin e tij Xhamiul Ulumi uel Hikem (2/146-147) thotë: **“Kjo tregon se mbajtja dhe frenimi i gjuhës është origjina e çdo të mire dhe se ai që e zotëron gjuhën i ka zotëruar të gjitha çështjet e tij dhe i ka vënë në rrugën e duhur.”** Gjithashtu ka thënë: **“Me gjuhët e këqija kemi parasysh ndëshkimi nga fjalët e ndaluara, duke qenë se njeriu me fjalët dhe veprat e tij i mbjell të mirat dhe të këqijat e më pas i vjel ato Ditën e Gjykimit. Për këtë arsye, ai që ka mbjellë të mira do të korrrë sukses, e ai që ka mbjellë të këqija me fjalë dhe me vepra, nesër do të ketë. Ajo që kuptohet nga hadithi i Muadhit është se shkakun që i fut njerëzit më së shumti në zjarr është përdorimi i gjuhës së tyre. Te mëkati nga të folurit përfshihet shirku, i cili është mëkati më i madh tek Allahu i**

Lartësuar, gjithashtu përfshihet i foluri në fenë e Allahut pa dituri, mëkat i cili është i ngjashëm me shirkun. Gjithashtu, përfshihet magjia, akuzat, e shumë mëkate të tjera të mëdha e të vogla, të tilla si: gënjeshtria, përgojimi dhe thashethemet. Ndërsa mëkatet në vepra, në shumicën e rasteve nuk mbeten pa u përzier me fjalë të cilat e ndihmojnë atë.”

“Mos të pastë nëna, o Muadh!” Shejh Ibn Utthejmini në komentin e këtij hadithi e shpjegon kështu: mbettë në zi nëna jote me humbjen tënde. Këto fjalë nuk kanë kuptimi i parë, përkundrazi ato kanë kuptimin për të nxitur atë që të kuptojë fjalët që i thuhet. Madje, mund të themi se fjalët e thëna në këtë hadith apo hadithe të tjera të ngjashme me të, merren si lutje që Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) bën për këta njerëz. Këtë e pohon hadithi në Sahihun e Muslimit me nr. 2 603, të transmetuar nga Enesi, ku i Dërguari i Allahut thotë: **“O Umu Sulejm, a nuk e di kushtin që i kam vënë Zotit tim? Unë i kam vënë kusht Zotit tim dhe i kam thënë: “O Zoti im, unë jam njeri; gëzohem siç gëzohen njerëzit dhe hidhërohem siç hidhërohen njerëzit, prandaj kundër cilitdo që të lutem nga umeti im me ndonjë lutje që ai nuk e meriton, bëje këtë dua pastrim dhe afrim për të, me të cilin ai të më afrohet Ditën e Gjykimit.”**

Mendjemprehtësia e imam Muslimit dhe renditja e mirë e Sahihut të tij, bëri që ai ta transmetonte këtë hadith, menjëherë pas hadithit të Ibn Abasit ku i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i thotë Muauijes: **“Allahu mos e ngophtë barkun e tij!”** - Në këtë formë konsiderohet dua (**lutje**) për të dhe jo mallkim.

7 - Përfitimet që nxirren nga ky hadith janë:

- 1 - Kujdesi që tregonin sahabët për të njohur veprat e mira, veprat që të çojnë drejt Xhenetit dhe të largojnë nga zjarri i Xhehenemit.
- 2 - Xheneti dhe zjarri i Xhehenemit ekzistojnë, ato do të qëndrojnë dhe kurrë nuk do të zhduken.
- 3 - Me adhurimin e Allahut shpresohet hyrja në Xhenet dhe shpëtimi nga zjarri i Xhehenemit dhe jo siç shprehen disa sufij se Allahu nuk adhurohet me shpresë për Xhenetin e Tij apo me frikë prej zjarrit të Tij.
- 4 - Në hadith tregohet rëndësia e pyetjeve që iu drejtuan Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) sepse janë konsideruar pyetje me një vlerë të madhe.
- 5 - Rruga që të shpie drejt shpëtimit është e vështirë dhe ndjekja e kësaj rruge bëhet vetëm me lehtësim nga ana e Allahut.

6 - Gjëja më e rëndësishme, me të cilën u obliguan njerëzit dhe xhinët është adhurimi i Allahut, madje për këtë arsye zbritën librat dhe u dërguan profetët.

7 - Adhurimi ndaj Allahut nuk merret parasysh, derisa të ndërtohet mbi dy dëshmitë, të cilat janë të lidhura ngushtë me njëra - tjetrën. Asnjë punë nuk pranohet, derisa të jetë kryer me sinqeritet për Allahun dhe në përputhje me rrugën e të Dërguarit të Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

8 - Në hadith shfaqet vlera e Islamit sepse Profeti e udhëzoi Muadhin për ndjekjen e asaj rruge, mes shumë obligimeve të tjera.

9 - Këto obligime janë të radhitura sipas rëndësisë që kanë, ashtu sikurse u radhitën në këtë hadith.

10 - Inkurajimi për kryerjen e namazit të nafilëve, pa harruar farzet.

11 - Prej veprave më të rëndësishme, me të cilat robi afrohet tek Allahu, pas praktikimit të farzeve është sadakaja, agjërimi dhe namazi i natës.

12 - Në hadith tregohet rëndësia e madhe që ka namazi si shtylla e Islamit.

13 – Gjithashtu, pohohet vlera e Xhihadit, i cili konsiderohet si kulmi i Islamit.

14 - Në hadith tregohet rreziku që mbart gjuha dhe fakti që ajo e shpie njeriun drejt shkatërrimit dhe si përfundim, e fut në zjarr.

30 - Allahu ka obliguar disa faerze, prandaj mos i lini pas dore.

Ebu Thealebe el Hasheni Xhurthum bin Nashir (radijAllahu ‘anhu) transmeton se i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Padyshim që Allahu i Madhëruar i ka bërë obligim disa farze, prandaj mos i lini pas dore; ka vendosur kufij, në mënyrë që të mos i tejkaloni ato; ka ndaluar disa gjëra prandaj mos i thyeni ato, ka heshtur për disa gjëra nga mëshira ndaj jush e jo nga harresa, ndaj mos hulumtoni rreth tyre!”** Hadithi është me zinxhir të mirë transmetimi. Transmeton Derakutni dhe të tjerë.

1 - Hadithin e vlerësoi si të saktë Neveviu, e para tij Ebu Bekr Semani, siç shprehet edhe Ibn Rexhebi. Në zinxhirin e transmetimit të tij ka ndërprerje, e

megjithatë Ibn Rexhebi ka përmendur disa hadithe që dëshmojnë rreth kuptimit të tij. Në këtë mënyrë ai (2/150-151) shprehet: “Kuptimi i këtij hadithi është transmetuar, duke iu referuar Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) në shumë forma të tjera. Ato i transmetoi Bezari në Musned dhe Hakimi nga Ebu Derda e ky nga Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), i cili tha: “Atë që Allahu e ka lejuar në librin e Tij, mbetet e lejuar, ndërsa atë që Ai e ka ndaluar mbetet e ndaluar. Për gjërat që ka heshtur ato janë mëshirë, ndaj pranojeni nga Allahu mëshirën e Tij sepse Allahu nuk mund të harrojë asgjë, - e më pas lexoi fjalën e Allahut që thotë: **“E Zoti yt nuk është që harron.”** Hakimi për këtë hadith ka thënë se zinxhiri i transmetimit të këtij hadithi është i saktë, ndërsa Bezari ka thënë se zinxhiri i tij i transmetimit është i saktë.

2 - Hafidh Ibn Rexhebi në librin e tij Xhamiul Ulumi uel Hikem (2/152-153) thotë: **“Hadithi i Ebu Thealebes i ndau dispozitat e Allahut në katër grupe: farze, haram, caqe dhe çështje të heshtura. Kjo ndarje i përmbledh të gjitha dispozitat fetare. Ebu Bekr Semani thotë: “Ky hadith është një parim i rëndësishëm prej parimeve të fesë.”** Gjithashtu, ka thënë: **“Është transmetuar nga dikush prej dijetarëve të ketë thënë: Në hadithet profetike nuk ekziston qoftë dhe një hadith i vetëm që të jetë kaq gjithëpërfshirës për bazat e diturisë dhe degëzimet e saj, se hadithi i Ebu Thealebes.”** Nga Uathile el Muzeni transmetohet se ka thënë: **“I Dërguari i Allahut e përmbloodhi të gjithë fenë në katër fjalë...”**, e më pas përmendi hadithin e Ebu Thealebes. Ibn Semani thotë: **“Ai që punon me këtë hadith i ka fituar shpërblimet dhe është ruajtur nga ndëshkimet. Ai që kryen detyrimet dhe u largohet haramëve, u përmbahet caqeve dhe nuk hulumton në çështje që nuk ka njohuri, ka arritur pjesët e mirësisë dhe i ka plotësuar detyrimet e tij ndaj fesë, duke qenë se legjislacioni nuk mund të dalë jashtë këtyre ndarjeve që u përmendën në këtë hadith.”**

3 - Fjalët e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“Padyshim që Allahu i Madhëruar i ka bërë obligim disa farze prandaj mos i lini pas dore”**, do të thotë se ua ka bërë obligim disa gjëra në mënyrë kategorike, të tilla si: namazi, zekati, agjërimi dhe Haxhi. Çdo muslimani i kërkohet që t’i zbatojë ato, ashtu siç e ka urdhëruar Allahu dhe nuk duhet t’i lërë pas dore apo të jetë i shkujdesur, duke lënë boshllëqe në praktikën e tyre.

4 - **“Ka vendosur kufij, kështu që mos i kaloni ato!”**, do të thotë se ka ligjëruar gjëra të detyruara, të pëlqyera dhe të lejuara, ndaj mos i kaloni këto caqe për të shkuar diku tjetër e për të rënë në haram, siç është rasti i trashëgimisë, të cilën Allahu e ka sqaruar në librin e Tij. Askujt nuk i lejohet të kalojë caqet dhe të sjellë një pjesë trashëgimie që bie ndesh me atë që na ka

treguar Allahu. Fjala kufi, zakonisht përdoret për veprat që ka ndaluar Allahu, kështu që çdo muslimani i del për detyrë që të mos u afrohet atyre, sikurse thotë Allahu i Lartësuar në librin e Tij: **“Këta janë kufjtë e Allahut prandaj mos iu afroni atyre!”**

5 - **“Ka ndaluar disa gjëra, ndaj mos i thyeni ato!”**, që do të thotë se muslimanëve nuk ju lejohet që të bien prehë e asaj që ka ndaluar Allahu, por atyre u del si detyrë që t’i braktisin, siç thotë Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“Largohuni prej asaj që ju kam ndaluar.”**

6 - **“Ka heshtur për disa çështje nga mëshira ndaj jush e jo nga harresa, ndaj mos hulumtoni rreth tyre”**, që do të thotë se ka çështje, për të cilat nuk ka ardhur ndonjë tekst në librin e Allahut, apo në Sunetin e të Dërguarit të Tij, kështu që nuk duhet të angazhohemi duke hulumtuar, apo duke pyetur rreth tyre. I njëjtë është rasti i të pyeturit rreth Haxhit, nëse është obligim që ta kryejmë çdo vit, pyetje të cilën e kundërshtoi i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), duke i thënë pyetësit: **“Më lini në atë që ju lashë sepse ajo që i shkatërroi popujt e mëparshëm ishin polemikat e shumta dhe kundërshtimet që kishin me pejgamberët e tyre.”** Po ashtu, i njëjtë është edhe rasti kur njeriu pyet për diçka që nuk është e ndaluar, e si rrjedhojë ajo bëhet e ndaluar për shkak të kësaj pyetjeje. Për rrezikshmërinë e kësaj vepre janë saktësuar hadithe nga Profeti. Gjithashtu, duhet ditur se pas vdekjes së Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk duhet të bëhen pyetje, të cilat përmbajnë ekstremitete dhe ekzagjerime (**stërhollime**). Për sa i përket kuptimit të fjalës: **“Ka heshtur për disa gjëra, duke mos ua obliguar e as duke ua ndaluar, ndaj mos pyesni për to!”** Allahu i Madhëruar thotë: **“O besimtarë! Mos pyesni për gjëra që sikur t’ju thuheshin haptazi, nuk do t’ju pëlqenin, e nëse do të pyesnit për to kur ju shpallet Kurani, do t’ju bëheshin të qarta. Allahu j’ua ka falur kërshërinë, se Allahu është Falës dhe i Butë. Disa njerëz kanë bërë pyetje të tilla para jush e pastaj u bënë jobesimtarë.”** (Suretu Maide, 101-102) Ibn Rexhebi (2/163) thotë: **“Përsa u përket çështjeve të lëna në heshtje, fjala është ato çështje që nuk është përmendur lejueshmëria, domosdoshmëria apo ndalimi i tyre, në këtë mënyrë mbetet diçka e falur, për të cilën nuk bën mëkat ai që e kryen. Këtë arsyetim e kanë pohuar hadithet që kemi përmendur këtu, siç është hadithi i Ebu Thealebes, etj.”**

7 - Përfitimet e nxjerra nga ky hadith janë:

1 - Legjislacioni i Allahut përmban atë që quhet farz i kërkuar, e që duhet praktikuar dhe jo të lihet pas dore.

2 - Duhet t'u përmbahemi detyrimeve, veprave të pëlqyera dhe të lejuara, por pa i kaluar caqet drejt veprave të ndaluara.

3 - Muslimani duhet të braktisë çdo gjë që ka ndaluar Allahu dhe të largohet përfundimisht prej saj.

4 - Gjërat për të cilat nuk ka ardhur argument për ndalimin, apo lejimin e tyre, janë të falura dhe nuk duhet të pyesim rreth tyre.

31 - Mos lakmo në këtë dunja që të të dojë Allahu.

Ebul Abas Sehl bin Sead es Saidi (radijAllahu 'anhu) transmeton: “Dikush erdhi tek i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) dhe i tha: **“O i Dërguari i Allahut! Më udhëzo në një punë, me anë të së cilës të më dojë Allahu dhe të më duan njerëzit.”** Ai iu përgjigj: **“Jeto si asket në këtë botë që të të dojë Allahu dhe mos lakmo atë që iu përket të tjerëve, në mënyrë që të të duan njerëzit.”** Hadithi është me zinxhir të mirë transmetimi. E transmetoi Ibn Maxheh e të tjerë me zinxhir të mirë transmetimi.

1 - Shokët e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ishin njerëzit që tregonin kujdesin më të madh për çdo të mirë, madje ishin njerëzit që përparonin më shumë drejt të mirave. Sahabi i përmendur në këtë hadith deshi të dinte se cilat vepra i mundësojnë dashurinë e Allahut dhe dashurinë e njerëzve, prandaj edhe e pyeti të Dërguarin e Allahut.

2 - Fjalët e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): **“Tregohu asket në këtë botë që të të dojë Allahu”** shpjegojnë se dashuria e Allahut të Madhëruar arrihet duke jetuar si asket në këtë botë. Ndër komentet më të mira që janë bërë zuhdit (asketizmit) në këtë botë është edhe ai që njeriu të lërë çdo punë që e pengon për të adhuruar Allahun e Madhëruar, ashtu siç e ka transmetuar edhe Hafidh Ibn Rexhebi në librin e tij Xhamiul Ulumi uel Hikem (2/186) nga Ebu Sulejman ed Darani si vijon: **“Ebu Sulejman Darani ka thënë: “Tek ne në Irak u shtuan debatet rreth të kuptuarit të zuhdit, ku kishte prej atyre që thonin se zuhdi nënkupton braktisjen e takimeve me njerëzit; ndër ta kishte edhe të tjerë që thonin se zuhdi nënkupton braktisjen e epsheve. Kishte të tjerë që pretendonin se zuhdi nënkupton të hash dhe të mos ngopesh. Kuptimet që ata i jepnin këtij termi ishin shumë të përafërta me njëra- tjetrën, ndërsa unë jam i mendimit se zuhdi është të braktisësh çdo**

gjë që të pengon nga adhurimi i Allahut të Madhëruar. Ky koment që dha Ebu Sulejmani është i pranueshëm, duke qenë se qëndron në mes të të gjitha komenteve të mësipërme që u thanë rreth zuhdit.”

3 - Fjalët e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“...mos lakmo atë që është e të tjerëve në mënyrë që të të duan njerëzit”** tregojnë se njerëzit në natyrën e tyre janë të dhënë pas pasurisë dhe mallit në jetën e kësaj bote, e në shumicën e rasteve i ndrydhnin duart dhe nuk u japin të tjerëve nga pasuria që kanë. Allahu i Madhëruar thotë: **“Prandaj frikësojuni Allahut sa të mundeni, dëgjoni e binduni dhe shpenzoni për bamirësi në të mirën tuaj. Ata që e ruajnë veten nga lakmia e saj, pikërisht ata janë të fituarit.”** (Suretu Tegabun, 16) Njerëzit nuk pëlqejnë që dikush ta lakmojë atë që ata kanë, prandaj kur njeriu mjaftohet me aq sa ka, me këtë gjest ai fiton respektin dhe dashurinë e tyre. E nëse fiton dashurinë e tyre, me këtë rast ruhet edhe nga mllefi i tyre.

4 - Përfitimet e nxjerra nga ky hadith janë:

1 - Kujdesi që tregonin sahabët për punët që u mundësonin dashurinë e Allahut dhe dashurinë e njerëzve.

2 - Në hadith pohohet cilësia e dashurisë për Allahun e Madhëruar.

3 - Mirësia për besimtarin qëndron në dashurinë e Allahut për të.

4 - Prej punëve që sjellin dashurinë e Allahut është asketizmi në këtë botë.

5 - Nëse nuk lakmojmë atë që u përket të tjerëve, fitojmë dashurinë e tyre, e si rrjedhojë përfitojmë nga të mirat e tyre dhe njëkohësisht ruhem nga mllefi i tyre.

32 - Nuk duhet të ketë dëm për asnjërën palë.

Ebu Seid Sead bin Malik bin Sinan el Hudri (radijAllahu ‘anhu) transmeton se i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Nuk duhet të lëndohet vetja e as të tjerët!”** Hadithi është i saktë. Transmetoi Ibn Maxheh, Derakutni, etj., me zinxhirë të rregullt. Si mursel **(fjalë që i referohet Tabi’init)** e transmetoi Maliku në librin El Mueta nga Amr bin Jahja, e ky nga

babai i vet, e ky i fundit nga Profeti, por në zinxhir ai nuk e përmendi Ebu Seidin. Hadithi ka edhe rrugë të tjera transmetimi që forcojnë njëra - tjetrën.

1 - Ky hadith përmban një prej rregullave të legjislacionit Islam që është moslëndimi i vetes dhe të tjerëve. Hadithi ndalon rreptësisë që njeriu të kryejë dëmtimin e vetes, apo të të tjerëve. Dëmtimi që njeriu mund t'i bëjë vetes mund të ndodhë me qëllim ose jo, ndërsa dëmtimi që ai u bën të tjerëve ka gjithmonë qëllim në vetvete. Hafidh Ibn Rexhebi në librin e tij Xhamiul Ulumi uel Hikem (2/212) thotë: “Dijetarët kanë rënë në polemika rreth dy shprehjeve të përdorura në hadith, nëse ka ndryshim mes tyre apo jo? Disa pretenduan se ato kanë të njëjtin kuptim dhe vijnë në formën e miratimit, por më e sakta është se mes tyre ka dallim. Më pas, disa të tjerë thanë se dëmtimi në këtë rast është emri, ndërsa shkaktimi i dëmtimit është veprimi që do të thotë se vetë dëmi nuk duhet të ekzistojë në legjislacion, gjithashtu edhe cënimi i të tjerëve pa të drejtë nuk duhet të ekzistojë.

Disa të tjerë kanë thënë se dëm konsiderohet kur i bën tjetrit një dëm për të përfituar vetë. Ndërsa dëmtimi i të tjerëve do të thotë që t'u bësh dëm atyre në diçka që nuk kanë përfitim, si shembulli i një njeriu që e privon dikë nga diçka që nuk e dëmton, por që realisht e lëndon njeriun e privuar. Këtë mendim e zgjodhën një grup dijetarësh ku prej tyre mund të përmendim: Ibn Abdul Berrin, Ibn Salahun, etj.

Disa të tjerë kanë thënë se dëm përbën lëndimi i dikujt me diçka që vetë nuk të lëndon, ndërsa me fjalën “të tjerët” i drejtohet dikujt që e ke lënduar më herët në mënyrë jo të ligjshme. E megjithatë, i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e ndaloi lëndimin e vetes dhe të tjetrit, nëse bëhet pa të drejtë, sepse të lëndosh dikë me të drejtë me motivin se ai i ka kaluar kufijtë e përcaktuar nga Allahu, në këtë rast ndëshkohet në masë të krimit që ka bërë. Ose në rastin kur ai i ka bërë padrejtësi vetes apo të tjerëve, në këtë rast i dëmtuari kërkon ballafaqimin me të me drejtësi, pra ky rast nuk është për qëllim në hadith. Ajo në të cilën aludon hadithi është kur dikë e lëndon pa të drejtë dhe kjo ndodh në dy forma:

E para: Kur me këtë veprim ka për qëllim lëndimin e të tjerëve dhe mbi këtë pretendim nuk ka dyshim mbi të keqen dhe ndalimin e saj. Në Kuran ndalohet cënimi i dikujt, ku përfshihet edhe cënimi i testamentit. Allahu i Madhëruar thotë: **“Pasi të kryhet testamenti e të lahet borxhi duke mos dëmtuar askënd...”** (Suretu Nisa, 12)

Më pas Ibn Rexhebi (2/217) vijon duke thënë: **“E dyta: Kur bëhet fjalë për ndonjë qëllim të qartë, siç është rasti kur ai shfrytëzon pasurinë e tjetrit**

gjëra që janë në interesin e tij. Rjedhimisht, ai vazhdon t'u bëjë dëm të tjerëve ose i ndalon të tjerët që të përfitojnë nga malli i tyre, duke e ruajtur prej tyre, e në këtë mënyrë i privuari dëmtohet me këtë gjest.”

2 - Përfitimet e nxjerra nga ky hadith janë:

1 - Në hadith tregohet përsosmëria e këtij legjislacioni mb i largimin e dëmit ndaj vetes dhe të tjerëve.

2 - Muslimani nuk duhet t'i dëmtojë të tjerët e as veten.

33 - Pretenduesi duhet të sjellë fakte dhe dëshmi, ndërsa pala mbrojtëse mjaftohet me betim.

Ibn Abasi (radijAllahu ‘anhu) transmeton se i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Po t’ju jepen njerëzve të mira materiale, në bazë të pretendimeve që kanë, atëherë do kishte njerëz që do të pretendonin pasuritë dhe gjakrat e një populli. Kush pretendon diçka duhet të paraqesë prova, ndërsa ai që e mohon pretendimin e tjetrit duhet të betohet.”** Hadithi është i saktë dhe e transmeton Bejhakui, etj. Një pjesë e tij gjendet në dy librat e saktë të hadithit (Buhariut dhe Muslimit).

1 - Hadithin e Ibn Abasit e transmetoi Buhariu me nr. 4 552 dhe Muslimi me nr. 1 711, ndërsa pjesa më e madhe e tij gjendet në dy Sahihet e tyre. Ajo që nuk shënohet në dy Sahihet e Buhariut dhe Muslimit është fjala e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“Kush pretendon diçka duhet të paraqesë prova, ndërsa ai që e mohon pretendimin e tjetrit duhet të betohet”**, e megjithatë, kjo fjali është saktësuar në dy Sahihet në hadithin e transmetuar nga Eshath bin Kajsi tek Buhariu me nr. 4 550 dhe Muslimi me nr. 138 tregimin e ndodhisë së tij me njërin nga djemtë e xhaxhait, ku Profeti i thotë: **“Ose ti paraqit provat, ose ai të betohet!”**

2 - Ibn Dekik el Ijdi në komentimin e librit Dyzet hadithet shprehet: **“Ky hadith është prej bazave të dispozitave dhe referenca më e madhe ku njerëzit iu kthehen gjatë polemikave dhe armiqësive. Ky hadith konsiston në faktin se për askënd nuk duhet gjykuar në bazë të pretendimeve të tij.”** I Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) sqaroi se sikur çdo njeriu t'i

miratohej çdo pretendim ndaj dikujt tjetër, atëherë kjo do t'i bënte njerëzit që të vazhdonin të pretendonin akoma edhe pasuritë, edhe gjakrat e njerëzve pambarimisht, por i Dërguari i Allahut e sqaroi këtë çështje në mënyrën më të mirë, në mënyrë që njerëzit ta gjejnë të qartë këtë dispozitë me kërkimin e provave nga pretenduesi.

Këtu përfshihet çdo provë që qartëson të drejtën dhe e pohon atë, qofshin ata dëshmitarë, apo argumente të tërthorta, etj. Nëse ai sjell një provë, atëherë gjykimi është në favor të tij, por nëse ai nuk gjen dot ndonjë provë, atëherë i kërkohet palës tjetër që të betohet. Nëse pala tjetër betohet, përgjegjësia i largohet, por nëse tërhiqet nga betimi, atëherë gjykimi vazhdon të zhvillohet në bazë të kësaj tërheqjeje dhe i kërkohet pretendimi i paditësi i tij. Neveviu në komentin e librit Dyzet hadithet thotë: **“Pretenduesit i kërkohet dëshmia sepse në të vërtetë ai pretendon diçka që bie ndesh me origjinën, e cila është pafajësia e garantuar.”** Pas kësaj, ai përmendi se në këtë temë veçohen shumë çështje, në të cilat pranohet fjala e pretenduesit, edhe pa prova, siç është rasti i pretendimit të babait për nevojën e tij që të martohet, apo pretendimi i mendjelehtit që do të martohet, pa lënë mënjane argumentet e tërthorta ose rasti kur gruaja pretendon se e ka kaluar afatin e pritjes dhe e ka lindur fëmijën, pretendimi i një fëmije se ka arritur moshën e pjekurisë me anë të nxjerrjes së spermës në gjumë, pretendimi i një dorëzani se i është shkatërruar malli që i është lënë në ruajtje ose që ia kanë vjedhur etj. Në këtë rast, pretenduesi është ai që kërkon të drejtën e tij dhe nëse ndodh që ai të heshtë, e drejta e tij bie poshtë, ndërsa tjetri i cili akuzohet për diçka, nëse hesht, akuza ndaj tij nuk bie poshtë.

Ibn Mundhiri transmeton në Xhamiul Ulumi uel Hikem (2/230): **“Të gjithë dijetarët kanë rënë në mendim unanim se ai që pretendon diçka duhet të sjellë prova, ndërsa betimin duhet ta bëjë ai prej të cilit pretendohet. Ai thotë: “Kuptimi i fjalës pretenduesi duhet të sjellë prova do të thotë se me anë të tyre ai meriton gjërat që pretendon dhe që janë e drejtë e tij (që t'i kthehen) e për to do të merret në llogari (nëse i ka përfituar pa të drejtë). Ndërsa kuptimi i fjalës; betimin e bën ai, prej të cilit pretendohet diçka, do të thotë se me anë të betimit ai konsiderohet i pafajshëm, gjë e cila kërkohet prej tij dhe merret në llogari në çdo kohë.”**

3 - Pretenduesit i kërkohet të sjellë prova për çështjet e kësaj bote, gjithashtu i kërkohet të sjellë dhe prova që kanë të bëjnë me çështjet e botës tjetër. Kush pretendon se e do Allahun dhe të Dërguarin e Tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), pretendimi i tij konsiderohet i sinqertë, vetëm atëherë kur të ndjekë të Dërguarin siç thotë Allahu i Madhëruar në librin e Tij: **“Thuaju (o Muhamed):**

“Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua që Allahu do t’ju dojë dhe t’jua falë gjynahet!” (Suretu Ali Imran, 31) Ibn Kethiri në komentin e këtij ajeti ka thënë: “Ky ajet fisnik është gjykatës për cilindo që pretendon dashurinë ndaj Allahut, në një kohë kur nuk është në rrugën e Muhamedit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Në këtë rast ai konsiderohet gënjeshtar, derisa të ndjekë legjislacionin e Muhamedit dhe fenë e tij në të gjitha mënyrat, me fjalë dhe me vepra, ashtu sikurse është saktësuar në një hadith të saktë, ku i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) thotë: **“Kush bën një punë, e cila nuk përputhet me çështjen tonë, ajo është e refuzuar.”** Kjo ishte dhe arsyeja që Allahu i Madhëruar tha: **“Thuaju (o Muhamed): “Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua që Allahu do t’ju dojë dhe t’jua falë gjynahet!”** Kuptimi i këtij ajeti është se ju do të arrini diçka më shumë se ajo që kërkuat dhe ajo është dashuria juaj për të dhe dashuria e Allahut ndaj jush e cila është më e madhe se ajo e para, siç kanë thënë disa dijetarë të urtë: **“Nuk është e habitshme që të duash, por e habitshme është të të duan të tjerët.”** Ndërsa Hasen el Basriu e të tjerë nga të parët tanë të mirë thonin: **“Disa njerëz pretenduan se e donin Allahun, por Allahu i sprovoi ata me këtë ajet.”**

4 - Përfitimet e nxjerra nga ky hadith janë:

- 1 - Gjithëpërfshirja e këtij legjislacioni, i cili ruan pasuritë dhe gjakun e njerëzve.
- 2 – Shpjegimi që u bëri Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) rrugëve, të cilat japin zgjidhje mes dy palëve kundërshtare.
- 3 - Nëse i akuzuari nuk pranon, atëherë paditësi duhet të sjellë provat për pretendimet e padisë së tij.
- 4 - Nëse nuk parashtrohen provat, atëherë të akuzuarit i kërkohet që të betohet dhe në këtë mënyrë ai konsiderohet i pafajshëm, e nëse nuk betohet atëherë gjykatësi gjykon kundër tij.

34 - Kush sheh një të keqe le ta ndryshojë me dorën e tij.

Ebu Seid el Hudri (radijAllahu ‘anhu) thotë: E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) të ketë thënë: **“Kur të shihni ndonjë të keqe ndryshojeni me dorën tuaj! Nëse nuk mundeni ndryshojeni me fjalë,**

e nëse përsëri nuk mundeni, ndryshojeni me zemër, por ky konsiderohet besimi më i dobët.” Trasmeton Muslimi.

1 - Ky hadith ka përmbledhur shkallët e ndryshimit që duhet t'i bëhen një veprë të keqe. Gjithashtu, ai se ai që mundet të ndryshojë me dorë, i kërkohet që ta bëjë një gjë të tillë dhe kjo është e specifikë për prijësat dhe zëvendësit e tyre nëpër provinca. Këtë mund ta bëjë dhe i zoti i shtëpisë me familjarët e tij, pra në rrethin e ngushtë shoqëror dhe familjar. **“Kur sheh një të keqe”** mund të jetë për qëllim kur e sheh me sytë e tu ose kur ke dijeni për të. Por nëse ai nuk është prej atyre që kanë të drejtë ta ndryshojnë të keqen me dorë, kjo gjendje kalon në fazën tjetër që është: ndryshimi i të keqes me gjuhë **(duke folur apo shkruar)** nëse ka mundësi ta bëjë atë, në të kundërtën nuk i mbetet vetëm se ta ndryshojë atë të keqe me zemër, e ky është besimi më i dobët. Ndryshimi i të keqes me zemër bëhet duke e urryer atë dhe gjurmët që lë ai mëkat në zemër. Nuk ka kundërthënie mes asaj që erdhi në këtë hadith në urdhërimin për të ndryshuar të keqen dhe fjalës së Allahut të Madhëruar që thotë: **“O besimtarë! Ju keni përgjegjësi vetëm për veten tuaj! Ai që është i humbur nuk mund t'ju dëmtojë nëse jeni në rrugë të drejtë.”** (Suretu Maide, 105)

Kuptimi i këtij ajeti është: **“Nëse ju veproni atë që u kërkohet në urdhërimin për të mirë dhe ndalimin nga e keqja, e keni kryer atë që ju kërkohet, sepse ai që është i humbur nuk mund t'ju dëmtojë, nëse jeni në rrugë të drejtë.. Shejhu ynë Muhamed Emin Shenkiti mbi këtë ajet ka studime të mira, po ashtu edhe rreth çështjes së urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja, ndaj ia vlen që t'i kthehemi dhe të përfitojmë prej tij.”**

2 - Përfitimet që nxjerrim nga ky hadith janë:

1 - Domosdoshmëria e urdhërimit për mirë dhe ndalimit nga e keqja, me qëllim që të përmirësohen njerëzit dhe vendet.

2 - Ndryshimi i të keqes bëhet me shkallë, cilido që i ka mundësitë për ta bërë, i kërkohet që të veprojë.

3 - Ndryshimi i njerëzve në nivelin e besimit, ku prej tyre ka të fortë, të dobët dhe më të dobët.

35 - Mos kini zili njëri tjetrin, mos u armiqësoni, mos u konfliktoni.

Ebu Hurejra (radijAllahu ‘anhu) transmeton se i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Mos e kini zili njëri - tjetrin, mos e rrisni artificialisht çmimin ose vlerën e artikujve (që të mendohet se janë të mira), mos e urreni njëri - tjetrin, mos i ktheni shpinën njëri - tjetrit, mos ndërhyjni në tregtinë e njërit – tjetrit, duke pretenduar atë që po e blen një tjetër, por jini vëllezër, o robër të Allahut! Muslimani është vëlla i muslimanit, nuk i bën padrejtësi, nuk e lë në baltë, nuk e gënjen dhe nuk e poshtëron. Devotshmëria është këtu,”** dhe bëri me shenjë nga kraharori i tij tri herë duke thënë: **“Një njeriu i mjafton si mëkat të poshtërojë vëllanë e tij musliman. Muslimani e ka të ndaluar gjakun, pasurinë dhe nderin e muslimanëve.”** Transmeton Muslimi.

1 - **“Mos e kini zili njëri - tjetrin, mos e rrisni artificialisht çmimin ose vlerën e artikujve (që të mendohet se janë të mira), mos e urreni njëri - tjetrin, mos i ktheni shpinën njëri - tjetrit, mos ndërhyjni në tregtinë e njëri - tjetrit, duke kërkuar diçka që po e blen një tjetër.”** Në të vërtetë zilia ekziston në çështjet e kësaj bote dhe po ashtu, në çështjet që kanë të bëjnë me botën tjetër. Zilia është ajo ndjenjë kur njeriu urren një të mirë që Allahu ia ka dhuruar dikujt tjetër dhe shpreson që kjo mirësi t’i largohet tjetrit , me çdo kusht dhe shpreson që ta ketë vetëm për vete. Nëse ai shpreson që të ketë një mirësi të ngjashme me atë që i ka dhuruar Allahu një tjetri, pa pasur urrejtje që atë ta ketë edhe dikush tjetër dhe pa shpresuar që t’i shkatërrohet atij, në këtë rast kjo quhet lakmi dhe nuk është diçka e nënçmuar. Përsa i përket çmimit është nënkuptohet rritja e çmimit të mallit artificialisht, ndërkohë që nuk do ta blejë. Ajo që kërkon ai është që shitësi të ketë dobi me rritjen e çmimit dhe t’i shkaktojë dëm blerësit me rritjen e këtij çmimi. Me urrejtjen nënkuptohet gjurmimi i shkaqeve që sjellin urrejtjen, si dhe kryerja e veprave që e nxisin atë. Me kthimin e shpinës nënkuptohet braktisja dhe bojkoti, pra kur nuk dëshiron ta takojë vëllanë e tij, por secili ia kthen shpinën tjetrit për shkak të urrejtjes që ekziston mes tyre. Ndërhyrje në tregtinë e tjetrit do të thotë: Kur dy persona (**shitësi dhe blerësi**) janë në fjalë për një artikull dhe është koha kur blerësi kërkon të bëjë zgjedhjen e duhur, atëherë aty vjen një

tjetër (**tek ky blerës**) dhe i thotë: Lëre këtë artikull sepse unë do të të jap të njëjtin artikull por me çmim më të lirë nga çmimi i tij. Ky veprim në realitet shkakton urrejtje mes njerëzve.

2 - **“...por jini vëllezër, o robër të Allahut! Muslimani është vëlla i muslimanit, nuk i bën padrejtësi, nuk e lë në baltë, nuk e gënjen dhe nuk e poshtëron. Devotshmëria është këtu”,** - dhe bëri tregoi nga kraharori i tij tri herë duke thënë: **“Një njeriu i mjafton si mëkat të poshtërojë vëllanë e tij musliman.”** Pas ndalimit që i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) u bëri disa veprave të papaëlqyeshme, ku prej tyre ishte urrejtja mes muslimanëve dhe gjurmimi i shkaqeve që e sjellin atë, më pas ai na udhëzoi drejt disa veprave që u kërkojnë muslimanëve. Ai kërkoi që muslimanët të jenë vëllezër, të dashur për njëri - tjetrin, ta mëshirojnë njëri - tjetrin duke menduar mirë, pra, duke u mundësuar dobitë e duke larguar prej tyre çdo dëm. I Dërguari i Allahut e pohoi këtë kuptim edhe më shumë me fjalët: **“Muslimani është vëlla i muslimanit”** që do të thotë se prej detyrimeve që kërkon vëllazëria është që të dojë për të tjerët, atë që do për vete dhe të urrejë për të tjerët atë që urren për vete. Ndaj nuk duhet t’u bëjë padrejtësi të tjerëve dhe as të hyjë në të drejtat e tyre, për t’u shkaktuar ndonjë dëm. Gjithashtu, nuk duhet ta lërë në baltë kur kërkon ndihmë dhe ai i ka mundësitë që ta ndihmojë, nuk duhet t’i flasë gënjeshtër, nuk duhet ta poshtërojë dhe as ta nënvlerësojë atë. Pas kësaj, i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) shfaqti neverinë e poshtërimit që muslimani i bën vëllait të tij, duke thënë: **“Një njeriu i mjafton si mëkat të poshtërojë vëllanë e tij musliman”** që do të thotë se i mjafton si e keqe poshtërimi që ai i bën vëllait të tij edhe nëse nuk posedon ndonjë të keqe tjetër veç saj. Ndërmjet ndalimit të poshtërimit dhe sqarimit të së keqes që përmban ky veprim, i Dërguari i Allahut përmendi devotshmërinë duke thënë: **“Devotshmëria është këtu, - dhe bëri me shenjë tek kraharori i tij tri herë”,** që do të thotë se ajo (devotshmëria) është në zemër. Me këtë ai do të tregojë se vlerësimi bëhet sipas asaj që mbajnë zemrat prej besimit dhe devotshmërisë, sepse mundet që zemra e atij që po poshtërohet të jetë e mbushur me devotshmëri, ndërsa zemra e atij tjetrit që tregoi mendjemadhësi të mos jetë e tillë. Përsa i përket asaj që shprehin disa njerëz që bien në mëkate të qarta, të cilët kur kritikohen për ndonjë mëkat, menjëherë bëjnë me shenjë nga kraharori duke thënë: Devotshmëria është këtu, - ne u themi: Kur devotshmëria arrin në zemër atëherë gjurmët e saj patjetër do të shfaqen në gjymtyrë, siç është shprehur Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“Vini re, në trup qëndron një organ që kur është i shëndoshë i tërë trupi bëhet i shëndoshë, e kur ai priset atëherë priset i tërë trupi. Ajo është zemra!”** Gjithashtu ka thënë: **“Vërtet Allahu nuk**

shikon fizionominë dhe as pasurinë tuaj, përkundrazi, shikon zemrat dhe punët tuaja.” (E transmeton Muslimi me nr. 2 564) Ndërsa disa nga të parët thonin: **“Besimi nuk është me shpresa dhe ëndërrime, por është diçka që zë vend në zemër dhe që vërtetohet nga veprat.”**

3 - Fjalët e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“Muslimani e ka të ndaluar gjakun, pasurinë dhe nderin e muslimanit”**, tregojnë se marrja e jetës së njeriut padrejtësisht (**gjymtimi apo shkaktimi i plagëve**) është i ndaluar. E njëjta gjë thuhet edhe për pasurinë, pra është e ndaluar që t’i merret pasuria me anë të vjedhjes, zaptimi i saj, etj. Gjithashtu, nuk lejohet të nëpërkëmbet nderi i tij me sharje, përgojime, etj. Ndalimin e këtyre tri veprave i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e ka pohuar edhe më shumë në Haxhin e lamtumirës, duke bashkangjitur shenjtërinë e tyre me shenjtërinë e vendit dhe kohës: **“Vërtet jeta juaj, pasuria dhe nderi juaj, janë të shenjta për ju si shenjtëria e kësaj dite, në këtë muaj dhe në këtë vend.”**

4 - Përfitimet e nxjerra nga ky hadith janë:

1 - Zilia, rritja e çmimeve artificilaisht dhe ndërhyrja në tregëtinë e tjetrit, madje çdo gjë që nxit urrejtje dhe armiqësi mes muslimanëve është e ndaluar.

2 - Ndalohet nxitja e shkaqeve që krijojnë urrejtjen dhe çdo gjë tjetër që rrjedh nga kjo, të tilla siç janë bojkoti dhe braktisja mes muslimanëve.

3 - Hadithi i nxit muslimanët që të jenë vëllezër dhe të shkojnë mirë.

4 - Vëllazërimi mes muslimanëve kërkon që t’u bësh mirë atyre dhe të largosh dëmet prej tyre.

5 - Ndalohet që muslimani t’i bëjë padrejtësi muslimanit, ta lërë në baltë, ta poshtërojë, apo ta gënjejë.

6 - Në hadith tegohet rreziku i poshtërimit të një muslimani dhe se kjo e keqe i mjafton si atij që e poshtëron, edhe nëse nuk ka të këqija përveç kësaj.

7 - Peshorja që tregon për gradën e besimit të njerëzve është devotshmëria, siç thotë Allahu i Madhëruar: **“Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij.”** (Suretu Huxhurat, 13)

8 - Vendi i devotshmërisë është zemra, sikurse thuhet në hadith dhe ashtu siç thotë Allahu i Madhëruar: **“Po, kështu është! Ndërsa kush madhëron shenjat e fesë së Allahut tregon përkushtimin e zemrës së tij.”** (Suretu Haxh, 32)

9 - Gjurmët e devotshmërisë që gjendet në zemra i shfaqin gjymtyrët dhe me përmirësimin e zemrës, përmirësohet i gjithë trupi.

10 - Ndalohet dëmtimi i muslimanëve, pasuria dhe nderi i tyre.

36 - Kush ia lehtëson një brengë vëllait të tij në këtë dunja.

Ebu Hurejra (radijAllahu ‘anhu) transmeton se I Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Kush e çliron muslimanin nga një shqetësim, atë do ta çlirojë Allahu nga një shqetësim Ditën e Gjykimit. Kush e lehtëson një njeri në vështirësi, Allahu do ta lehtësojë në këtë botë dhe në botën tjetër. Kush i mbulon të metat një muslimani, Allahu do t’ia mbulojë atij të metat Ditën e Gjykimit. Allahu do ta ndihmojë robin e Vet, për sa kohë që ky ndihmon vëllanë e vet. Ai që merr një rrugë për të kërkuar dituri, Allahu do t’i lehtësojë një rrugë për në Xhenet. Sa herë që të mblidhen njerëz në një nga shtëpitë e Zotit për të lexuar Kuranin dhe për ta studiuar atë mes tyre, mbi ta do të zbresë qetësia dhe do t’i mbulojë mëshira, do t’i rrethojnë engjëjt dhe Zoti do t’i përmendë tek të zgjedhurit e Tij. Atë që e lënë pas veprat e tij, nuk mund ta shpjerë përpara prejardhja e tij!”** Me këto fjalë e transmetoi Muslimi.

1 - Në fjalët e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“Kush e çliron muslimanin nga një shqetësim, atë do ta çlirojë Allahu nga një shqetësim Ditën e Gjykimit”**, me shqetësim është për qëllim ankthi dhe fatkeqësia, ndërsa çlirimi prej saj është largimi i saj plotësisht. Shpërblimi për atë që e çliron muslimanin nga një vështirësi në këtë botë është që Allahu ta çlirojë atë nga një vështirësi, prej vështirësive të Ditës së Gjykimit, sepse shpërblimi merret në bazë të punës. Nuk ka dyshim se shpërblimi që merr atë ditë është më i madh, kjo për shkak të vështirësive që ka ajo ditë dhe dobive të mëdha që përfiton njeriu kur t’i largohen vështirësitë.

2 - Në fjalët e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“Kush e lehtëson një njeri në vështirësi, Allahu do ta lehtësojë në këtë botë dhe në botën tjetër”**, tregohet se shpërblimi merret në bazë të punës. Në këtë rast puna ishte lehtësimi i një njeriu në vështirësi, e kjo duke e ndihmuar në largimin e vështirësive të tij. Kështu që, nëse borxhliu e ndihmon duke i dhënë atij që

shlyen borxhin që i përket atij, atëherë i jep afat edhe nëse nuk ia fal atë, edhe pse e faluara është më e mirë se pritja. Ky fakt bazohet në fjalën e Allahut që thotë: **“Nëse e dini se borxhliu është ngushtë, shtyjani afatin (e shlyerjes së borxhit), derisa ta përmirësojë gjendjen, por është më mirë për ju që t’ia falni borxhin, veç sikur ta dinit.”** (Suretu Bekare, 280) Ndërsa Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) shpjegoi se shpërblimi për atë që lehtëson është lehtësimi në këtë botë dhe në botën tjetër.

3 - “Kush ia mbulon të metat një muslimani, Allahu do t’ia mbulojë atij të metat Ditën e Gjykimit”, edhe ky veprim është mbulim i të metave në këtë botë, ndërsa shpërblimi për të është mbulimi i tyre në këtë botë dhe në botën tjetër. Mbulimi është të fshehësh një të metë dhe të mos e shfaqësh atë. Ndaj, cilido që është njohur si njeri i rregullt, por ndodh që bie në mëkate, ai duhet të këshillohet dhe mëkati i tij të mos tregohet, ndërsa të mbulosh të metat e atij që njihet si i prishur dhe kriminel, ndoshta e ndihmon në nënvlerësimin e mëkatit që bën e kështu vazhdon dhe stërgjartet më shumë. Mënyra më e mirë në këtë rast është që mëkatet e tij të mos mbulohen, me qëllim që të bjerë ndëshkimi mbi të dhe ta pengojë një herë e mirë nga mëkatet dhe krimet që bën.

4 - Në fjalët e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“Allahu do ta ndihmojë robin e Vet, për sa kohë që ky ndihmon vëllanë e vet”**, vihet re inkurajimi që muslimani të ndihmojë vëllanë e tij musliman, sepse sa herë që ai ndihmon vëllezërit ai arrin ndihmën dhe udhëzimin nga Allahu. Pra, kjo është një nga fjalët përmbledhëse që përdorte i Dërguari i Allahut.

5 - **“Kush merr një rrugë për të kërkuar dituri, Allahu do t’i lehtësojë një rrugë për në Xhenet.”** Në këto rreshta Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nxit për kërkimin e dijes fetare dhe gjetjen e rrugëve që shpien në marrjen e saj, si p.sh. me anë të udhëtimit, apo duke vepruar punët që të mundësojnë marrjen e saj: me anë të librave të dobishëm, duke i lexuar dhe përfituar prej tyre, ndjekja e dijetarëve dhe përfitimi nga ata, etj. Shpërblimi i Allahut për këtë është që t’i lehtësojë rrugën që e shpie drejt Xhenetit. Kjo duke i mundësuar atij përfitimin nga dija që kishte si qëllim, madje kështu ia lehtëson edhe më shumë marrjen e diturisë. Gjithashtu i mundëson ta praktikojë dijen që ka në dispozitat e sheriatit, gjë e cila gjithashtu e shpie në Xhenet.

6 - **“Sa herë që të mblidhen njerëz në një nga shtëpitë e Zotit për të lexuar Kuranin dhe për ta studiuar atë mes tyre, mbi ta do të zbresë qetësia dhe do t’i mbulojë mëshira, do t’i rrethojnë engjëjt dhe Zoti do t’i përmendë tek të zgjedhurit e Tij.”** Shtëpitë e Allahut janë xhamitë, të cilat i kushtohen

Allahut në formë nderimi. Xhamitë janë vendet më të dashura tek Allahu, ky fakt bazohet në fjalën e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) që thotë:

“Vendet më të dashura tek Allahu janë xhamitë, ndërsa vendet më të urryera tek Ai janë tregjet.” (E transmeton Muslimi me nr. 671) Në hadith vërehet inkurajimi për tubimin nëpër xhami për të lexuar dhe studiuar Kuranin, librin e Allahut. Kjo arrihet në këtë formë; njëri lexon dhe të tjerët dëgjojnë ose duke lexuar me rradhë dhe duke korrigjuar njëri - tjetrin gjatë gabimeve. Në këtë mënyrë, secili përfiton nga tjetri, arrihetpërmirësimi i leximit dhe korrigjimi i gabimeve nëse ndodhin. Nëse mes tyre qëndron ndonjë dijetar që ka njohuri rreth komentimit, ai mund t’i mësojë, por nëse të gjithë kanë dituri, atëherë mund t’i mësojnë të gjithë së bashku kuptimet e tij, duke iu referuar librave të komentit si në trasmetime, ashtu edhe në tekstet që janë ndërtuar mbi rrugën që kanë ndjekur të parët e këtij umeti. Shpërblimi për ata që mblidhen në xhami për të lexuar dhe studiuar Kuranin shpaloset në katër forma: zbritja e qetësisë, mbulimi i mëshirës, rrethimi i engjëjve dhe përmendja nga Allahu tek paria e engjëjve.

7 - Fjalët e tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“Atë që e lënë pas veprat e tij, nuk mund ta shpjer përpara prejardhja e tij!”** tregojnë se atë që e lë pas puna e tij për të hyrë në Xhenet, atë nuk mund ta shpjerë përpara prejardhja e tij në hyrjen në Xhenet. Ajo që merret në konsideratë është vetëm besimi dhe devotshmëria, siç thotë Allahu i Madhëruar: **“Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij.”** (Suretu Huxhurat, 13)

Ibn Rexhebi në librin e tij Xhamiul Ulumi uel Hikem (2/308) thotë: “Kjo do të thotë se puna është ajo që e çon njeriun në gradët më të larta të ahiretit, ashtu siç thotë Allahu i Madhëruar: **“çdo kush do t’i ketë gradët e tij sipas asaj që ka vepruar.”** Ndaj, atë që e lë pas puna e tij që të arrijë gradët e larta tek Allahu, nuk mund ta çojë përpara prejardhja e tij për t’i arritur ato grada. E themi këtë sepse Allahu e ka vendosur shpërblimin për punët dhe jo për prejardhjen, siç thotë Allahu i Madhëruar: **“Kur të fryhet në Sur (Ditën e Ringjalljes), atëherë midis tyre nuk do të ketë lidhje farefisnore dhe ata as që do të pyesin për njëri - tjetrin.”** (Suretu Muminun, 101) Ibn Rexhebi vijon duke thënë: **“E mbi këtë kuptim ndërtoheshin vargjet e disa poetëve që thonin: Betohem se njerëzit vlerësohen vetëm për fenë që kanë, Mos e lër devotshmërinë duke u mbështetur në prejardhje.”**

Islami e ngriti Selmanin që ishte Persian, e shirku poshtëroi atë (Ebu Lehebin) që gëzonte prejardhje.

8 - Përfitimet e nxjerra nga ky hadith janë:

- 1 - Inkurajimi për të kontribuar në largimin e vështirësive një muslimani në këtë botë, sepse Allahu për këtë i largon atij nga vështirësitë e Ditës së Gjykimit.
- 2 - Shpërblimi jepet në varësi të punës. Nëse puna është largim i një vështirësie, atëherë edhe shpërblimi është largim vështirësie.
- 3 - Inkurajimi për t'ua lehtësuar punët atyre që janë në vështirësi dhe shpërblimi për këtë është lehtësimi që ata do të përfitojnë në këtë botë dhe në botën tjetër.
- 4 - Inkurajimi për të mbuluar të metat, nëse ka dobi që të mbulohen dhe shpërblimi për këtë vepër është mbulimi i tyre në këtë botë dhe në botën tjetër.
- 5 - Hadithi nxit në ndihmën reciproke mes muslimanëve dhe duhet që gjithmonë të ndihmohen. Me këtë ata do fitojnë ndihmën dhe udhëzimin e Allahut.
- 6 - Në hadith tregohet vlera e kërkimit të diturisë fetare.
- 7 - Tregohet vlera e tubimeve në xhami për të lexuar dhe studiuar Kuranin.
- 8 - Besimi dhe punët e mira konsiderohen shkak që e fusin njeriun në Xhenet dhe me anë të tyre njeriu arrin grada të larta tek Allahu i Madhëruar.
- 9 - Njeriut nuk i vlen prejardhja e ndershme, pa bërë punë të mira që e afrojnë tek Allahu i Madhëruar.

37 - Allahu i ka ndarë të mirat dhe të këqijat.

Ibn Abasi (radijAllahu ‘anhu) transmeton se profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i është transmetuar nga Zoti i tij i Madhëruar se ka thënë: **“Vërtet Allahu i ka përcaktuar veprat e mira e të këqija, pastaj i ka sqaruar ato. Kush dëshiron me zemër të bëjë një vepër të mirë, por nuk mund ta kryejë atë, Allahu në tërësi do t'ia shkruajë si vepër të kryer, e nëse dëshiron të bëjë një vepër të mirë dhe e kryen, Allahu do t'ia shkruajë dhjetë, deri në shtatëqind herë më tepër. E, nëse dëshiron të bëjë ndonjë vepër të keqe dhe nuk e kryen atë të keqe, Allahu do t'i shkruajë një vepër të mirë të plotë, por nëse dëshiron të bëjë ndonjë vepër të keqe dhe e kryen atë,**

atëherë Allahu ia shënon vetëm një vepër të keqe.” Transmeton Buhariu dhe Muslimi në librat e tyre.

1 - Me fjalët e tij: **“Vërtet Allahu i ka përcaktuar cilat janë veprat e mira e cilat të këqija, pastaj i ka sqaruar ato”**, mundet që qëllimi të jetë paracaktimi që Allahu i Madhëruar u ka bërë veprave dhe shpërblimit të tyre sipas këtyre detajeve. Mundet që qëllimi të jetë edhe shkrimi që engjëjt u kanë bërë punëve të mira dhe të këqija me urdhër nga Allahu i Madhëruar, siç thotë Allahu në librin e Tij: **“Dhe për çdo fjalë që ai thotë, ka pranë vetes një mbikqyrës të gatshëm (për ta shënuar atë).”** (Suretu Kaf, 18) Këtë kuptim e pohon edhe më tej hadithi i Ebu Hurejras i shënuar në kapitullin e teuhidit në Sahihun e Buhariut ku thuhet: **“Kur të dojë rob i Im që të bëjë një të keqe mos ia shkruani atij, derisa ta bëjë atë, e kur ta bëjë shkruajeni vetëm një të tillë. Por nëse largohet prej saj për hirin Tim, atëherë shkruajeni si vepër të mirë.”** Kjo gjë nuk bie ndesh mes dy të shkrimeve sepse secila prej tyre është e realizueshme.

2 - **“Kush dëshiron me zemër të bëjë një vepër të mirë, por nuk mund ta kryejë, Allahu në tërësi do t'ia shkruajë atë vepër si të kryer, e nëse dëshiron të bëjë një vepër të mirë dhe e kryen, Allahu do t'ia shkruajë dhjetë, deri në shtatëqind herë më tepër.”** Këtu ai pohoi shkrimin e një veprë të mirë nëse e dëshiron me zemër, por që nuk e kryen atë, duke e quajtur si sevap të plotë me qëllim që të mos mendojë ndonjë se ajo pakësohet sepse ka të bëjë me dëshirën dhe jo me veprimin. Nga ana tjetër, ai sqaroi se shumëfishimi i sevapeve ka lidhje me veprimin, shumëfishim që arrin deri në dhjetëfish, madje edhe më shumë se kaq. Kjo është një mirësi e Allahut që ia dhuron kujt të dojë prej robërve të Tij. Në këtë hadith pohohet shumëfishimi i shpërblimit për atë që punon dhe një shpërblim të tillë nuk mund ta ketë ai që ka vetëm dëshirën, siç duket qartë në hadith. Përsa i përket hadithit: **“Qëllimi i besimtarit është më i mirë se puna e tij”**, duhet ditur se ky hadith është i dobët dhe atë e ka përmendur hafidh Ibn Haxheri në librin e tij Fet’hul Bari (4/219). Për më tepër shih librin Vargu i haditheve të dobëta me autor Albanin me nr. 2 789.

3 - **“Por nëse dëshiron të bëjë ndonjë vepër të keqe e nuk e kryen, Allahu do t'ia shkruajë një vepër të mirë në tërësi, e nëse dëshiron dhe kryen një vepër të keqe, atëherë Allahu ia shënon vetëm një vepër të keqe.”** Sevapi për braktisjen e një mëkati kur dëshiron ta veprojë, u cilësua si i plotë me qëllim që të mos mendohet se ai është sevap i mangët. Ndërsa mëkati i kryer quajti një mëkat i vetëm, me qëllim që të mos mendojë dikush se ai do merret në llogari si i shumëfishuar. Kjo është mirësi e Allahut dhe drejtësi nga ana e

Tij. Shpërblimi për braktisjen e një mëkati që ke dashur ta praktikosh arrihet atëherë ku e lë atë për hir të Allahut. Nëse ai tregon kujdes për ta bërë atë mëkat, zemrën e ka të lidhur pas tij dhe është i vendosur që ta kryer nëse i gjen mundësitë, në këtë rast ai ngarkohet me mëkat. Ibn Kethiri në komentin e fjalës së Allahut që thotë në suren Enam: **“Kush bën një vepër të mirë do të shpërblehet dhjetëfish. Kush bën një vepër të keqe do të dënohet vetëm sipas gjynahut që ka bërë dhe nuk do t’i bëhet kurrfarë padrejtësie.”**

(Suretu Enam, 160) Thotë: **“Dije se ata që largohen prej një mëkati dhe nuk e veprojnë atë ndahen në tri kategori: “Ndonjëherë e lënë për hir të Allahut, e këtij njeriu i shkruhet një e mirë, për shkak se u largua prej saj për hir të Allahut. Kjo është punë dhe qëllim e për këtë arsye është thënë se i shkruhet një e mirë, siç është transmetuar në disa fraza të sakta: “Ai e la atë mëkat për hirin Tim.”** Nganjëherë e lë nga harresa dhe hutimi prej saj, e ky njeri nuk merr as sevape e as mëkate sepse ai nuk kishte qëllim që të bënte mirë, apo keq. Nganjëherë e lë nga pamundësia, apo nga dembelizmi pasi që mundohet në arritjen e shkaqeve dhe gjërave që e afrojnë pranë këtij mëkati. Ky njeri në këtë rast është sikur ta ketë praktikuar atë, siç është transmetuar në një hadith të saktë se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Kur dy muslimanë përleshën me shpatat e tyre (për të vrarë njëri - tjetrin), edhe vrasësi edhe i vrari janë në zjarr.”** Ata i thanë: **“O i Dërguari i Allahut, për vrasësin është e qartë, por si qëndron puna me të vrarin?”** Profeti atëherë tha: **“Sepse edhe i vrari dëshironte ta vriste shokun e vet.”**

4 - Përfitimet e nxjerra nga ky hadith janë:

- 1 - Pohimi i shkrimit të të mirave dhe të këqijave.
- 2 - Prej mirësisë së Allahut të Madhëruar është shumëfishimi i shpërblimeve.
- 3 - Prej drejtësisë së Allahut është se Ai nuk i shton mëkatet.
- 4 - Allahu shpërblen me një sevap atë që dëshiron të veprojë një të mirë edhe nëse nuk e vepron atë dhe se ky sevap i shkruhet i plotë.
- 5 - Ai që dëshiron të bëjë një mëkat dhe e lë për hir të Allahut, me këtë gjest atij i shkruhet një sevap i plotë.
- 6 - Inkurajimi për kryerjen e veprave të mira dhe kërcënimi për kryerjen e veprave të këqija.

38 - Kush e armiqëson një nga të dashurit e Mi, i kam shpallur luftë.

Ebu Hurejra (radijAllahu ‘anhu) transmeton se i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Vërtet Allahu i Madhëruar ka thënë: **“Kushdo që tregon armiqësi ndaj ndonjë veliu (i dashur tek Allahu), Unë do t'i shpall luftë. Me asgjë më të mirë nuk mund të më afrohet rob Im pos me atë me çfarë Unë e kam obliguar. Robi Im vazhdon duke u afruar tek Unë me vepra vullnetare derisa Unë ta dua atë, e kur ta dua, Unë bëhem veshi i tij me të cilin dëgjon; syri i tij me të cilin sheh; dora e tij me të cilën sulmon fuqishëm; dhe këmba e tij me të cilën ec. Nëse më kërkon diçka, do t'ia jap, e nëse kërkon mbrojtje nga Unë, do ta mbroj atë.”** Transmeton Buhariu.

1 - **“Kushdo që tregon armiqësi ndaj ndonjë veliu (i dashur tek Allahu), Unë do t'i shpall luftë.”** Ky është njëri nga hadithet e shenjta, të cilin Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e transmeton nga Zoti i tij. Sheukani ka shkruar një libër të veçantë ku ka sqaruar këtë hadith dhe e ka titulluar Katrul ueli bi sherhi hadithil uelij. Evlijatë e Allahut të Madhëruar janë besimtarët e devotshëm, siç thotë Allahu i Madhëruar: **“Padyshim, miqtë e Allahut nuk do të kenë arsye për t'u frikësuar dhe as për t'u dëshpëruar. (Të tillë janë) Ata që besojnë dhe që (i) frikësohen (Allahut).”** (Suretu Junus, 62-63) Kuptimi i fjalës: **“do t'i shpall luftë”** do të thotë; Unë i jap shenjë se jam në luftë me të, - dhe kjo tregon rrezikshmërinë e shfaqjes së armiqësisë ndaj evlijave **(të dashurve)** të Allahut, dhe se kjo armiqësi është prej mëkatve të mëdha.

2 - **“Me asgjë më të mirë nuk mund të më afrohet rob Im, pos me atë me çfarë Unë e kam obliguar.”** Në këtë fjali dhe në fjalitë pasardhëse tregohet se dashuria e Allahut arrihet duke iu afruar Atij me praktikimin e detyrimeve **(farzeve)** dhe me praktikimin e nafilëve. Hadithi pohon se afrimi tek Allahu me anë të farzeve është më i dashur për Të se me anë të nafilëve, sepse kjo nënkupton praktikimin e asaj që ka urdhëruar dhe distancimin nga ato që ka ndaluar. Ai që praktikon detyrimet dhe i lë të ndaluarat quhet mesatar, ndërsa ai që i praktikon këto vepra dhe atyre u shton nafilët, ky njeri konsiderohet si i përparuar në të mira.

3 - “Robi Im vazhdon të afrohet tek Unë me vepra nafile (vullnetare) derisa Unë ta dua atë.” Nafilet janë ato vepra të mira që bëhen shtesë ndaj farzeve dhe se praktikimi i tyre dhe vijueshmëria në to sjell dashurinë e Allahut. E kur njeriu arrin dashurinë e Allahut ai me këtë fiton udhëzimin e Allahut në punët e tij, kështu që dëgjon vetëm të vërtetën, sheh vetëm të vërtetën, fiton vetëm atë që është e drejtë dhe ecën vetëm drejt asaj që është e drejtë. Gjithashtu, Allahu e begaton duke i pranuar lutjet e tij dhe duke e mbrojtur në kohën kur kërkon mbrojtje nga Ai.

4 - Përfitimet që nxirren nga ky hadith janë:

1 - Hadithi sqaron vlerën e evlijave të Allahut dhe rrezikshmërinë e armiqësisë kundër tyre.

2 - Dashuria e Allahut arrihet, duke kryer detyrimet dhe duke praktikuar nafilet.

3 - Prej gjërave më të dashura që njeriu afrohet tek Allahu është praktikimi i farzeve.

4 - Pohimi i cilësisë së dashurisë për Allahun e Madhëruar.

5 - Punët që do Allahu kanë gradë të ndryshme nga njëra - tjetra.

6 - Zbatimi i nafileve pas zbatimit të farzeve sjell dashurinë nga Allahu i Madhëruar.

7 - Ai që fiton dashurinë e Allahut të Madhëruar, atë Allahu e udhëzon në dëgjimin, shikimin, lëvizjet dhe të ecurin e tij.

8 - Dashuria e Allahut ndaj një robi i mundëson atij pranimin e lutjeve dhe mbrojtjen nga gjërat që ka frikë.

9 - Shpërblimi i Allahut të Madhëruar që ia jep një njeriu arrihet duke iu përgjigjur kërkesave të tij dhe duke u larguar nga të ndaluarat e tij.

39 - Allahu ia ka falur umetit tim ato që bëhen nga gabimi dhe harresa.

Ibn Abasi (radijAllahu ‘anhu) transmeton se i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Me të vërtetë Allahu nuk ia merr në konsideratë umetit tim gabimet e paqëllimshme, harresën dhe veprat që i kryejnë nën presion.”** Hadithi është i saktë. Transmeton Ibn Maxheh, Bejhakui

1 - Umeti i profetit tonë Muhamedit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) është dy llojesh: umeti që duhet ftuar në fe dhe umeti që i është përgjigjur kësaj ftese. Në umetin që duhet ftuar në fe përfshihet çdo njeri dhe xhind, që nga koha kur u dërgua Muhamedi e deri në Ditën e Kiametit. Ndërsa umeti që i është përgjigjur kësaj thirrjeje janë ata që Allahu u ka dhënë sukses për të hyrë në fenë e pastër, duke u bërë muslimanë. Qëllimi me umetin që përmendet në hadith është umeti që i është përgjigjur thirrjes. Prej shembujve që flasin për umetin që duhet ftuar në Islam është hadithi i Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ku thotë: **“Betohem në Allahun se çdo njeri që dëgjon për mua, qoftë çifut apo I krishterë dhe nuk i beson asaj, me të cilën u dërgova, ai do të jetë nga banorët e zjarrit.”** (E transmeton Muslimi me nr. 153)

Gabim konsiderohet kryerja e një vepre pa qëllim, ndërsa harresa është kur e di diçka por e harron në kohën kur të është kërkuar që ta veprosh. Ndërsa presioni është imponimi që i bëhet dikujt me anë të fjalëve apo veprave. Që do të thotë se njeriu nuk ngarkohet me mëkat në këto tri raste. Argumentet nga libri i Allahut janë përmendur në pohimin e këtij fakti. Allahu i Madhëruar duke përmendur lutjen e besimtarëve thotë: **“Zoti ynë, mos na ndëshko për atë që harrojmë ose veprojmë pa qëllim!”** (Suretu Bekare, 286) Pas kësaj Allahu i Madhëruar tha: **“Po, e pranova.”** Transmeton Muslimi me nr. 126. Gjithashtu thotë: **“Ju nuk ngarkoheni me mëkat për gabimet e paqëllimshme, por ngarkoheni për gjërat e qëllimshme.”** Dhe: **“Përveç atij që është i detyruar me forcë ndërkohë që zemra e tij është plot besim. Ndërsa ata që ia hapin zemrën mosbesimit, do të kenë mbi vete zemërimin e Allahut dhe një dënim të madh.”** (Suretu Nahl, 106) Përsa i përket gjërave që i dëmton tjetrit, ai ngarkohet dhe është përgjegjës, siç është rasti kur vret dikë gabimisht. Në këtë rast, ai urdhërohet që ta shpaguajë dhe ta shlyejë atë **(duke agjëruar)**. Nga ana tjetër, nëse nën presion, kryen imoralitet apo vret dikë të pafajshëm, kjo nuk i lejohet që ta bëjë sepse nuk duhet të ruajë jetën e tij, duke vrarë të tjerët.

2 - Përfitimet që nxirren nga ky hadith janë:

1 - Mëshira e madhe e Allahut dhe mirësia e Tij ndaj robërve, e kjo duke mos i ngarkuar ata me mëkat në këto tri gjëra.

2 - Mosmarrja në konsideratë e gabimit të paqëllimshëm, por nëse gabimi bëhet në lënien e një detyrimi, apo duke hyrë në të drejtat e një tjetri, në këtë rast është përgjegjës.

40 - Të jesh në këtë dunja si i huaj apo udhëtar.

Ibn Umeri (radijAllahu ‘anhu) transmeton duke thënë: “Një herë i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) më kapi te krahu dhe më tha: **“Jeto në këtë botë si të ishe i huaj apo udhëtar.”** Ibn Umeri pas këtyre fjalëve thoshte: **“Kur të ngrysesh mos e prit mëngjesin, e kur të gdhiesh mos e prit mbrëmjen. Merr nga shëndeti yt për rastet e sëmundjeve (që do të vijnë) dhe nga jeta jote për vdekjen (që do të vijë).”** Transmeton Buhariu.

1 - Në mënyrën se si Profeti e kapi Ibn Umerin për krahu, me këtë ai e inkurajon për t’i kuptuar gjërat që do i thuhesh në ato çaste. Ndërsa lajmërimi i Ibn Umerit me këtë hadith tregon dëgjimin e tij të vëmendëshëm ndaj fjalëve të Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), sepse aty ai përmend edhe atë që i ndodhi me Profetin kur i tregoi këtë hadith.

2 - Në fjalët e tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“Jeto në këtë botë si të ishe i huaj apo udhëtar”**, tregohet se i huaj është ai njeri që nuk qëndron në vendin e tij për të kryer ndonjë nevojë, por që përgatitet për ta lënë atë vend në çdo kohë që të ketë mundësi. Ndërsa udhëtar i është mysafiri i cili kalon nëpër vende kalimthi pa qëndruar aty, derisa të mbarojë udhëtimin e tij. Vendi i huaj dhe udhëtimi që përmenden në hadith, simbolizojnë këtë botë dhe ecjen në të drejt ahiretit. E gjithë kjo realizohet duke kujtuar vdekjen, duke pakësuar shpresat si dhe duke u përgatitur për ahiretin me punë të mira, siç thotë Allahu i Madhëruar: **“Pajisuni për gjërat që u nevojiten për rrugë dhe dijeni se pajisja më e mirë është devotshmëria.”** (Suretu Bekare, 197) Buhariu në sahihun e tij (11/235) ka përmendur nga Ali bin Ebi Talibi se ai ka thënë: **“Kjo botë u nis për t’u larguar ndërsa ahireti u nis për të ardhur, dhe secili prej tyre ka fëmijë. Bëhuni djemtë e ahiretit e mos u bëni djem të kësaj bote. Sot njeriu mund të punojë dhe nuk merret në llogari, por nesër do ketë llogari e jo më punë.”** I Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) na i ka treguar shembullin e kësaj bote dhe fundin e saj, duke na thënë se ajo nuk është e përhershme. Në këtë mënyrë ai shprehet duke thënë: **“Çfarë kam unë me dunjanë? Në këtë botë unë ngjasoj me një udhëtar i cili pushon në**

hijen e një peme, pastaj largohet dhe e lë atë.” (E transmeton Tirmidhiu etj. i cili për këtë hadith ka thënë: Hadithi është i saktë)

3 - “Ibn Umeri pas këtyre fjalëve thoshte: Kur të ngrysesh mos e prit mëngjesin, e kur të gdhiesh mos e prit mbrëmjen.” Në këto fjalë del në pah angazhimi i shokëve të Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) në praktikimin e këshillave që u jepte i Dërguari i Allahut. Gjithashtu, aty del në pah vlera e Abdullah bin Umerit, sepse ai jo vetëm që e praktikoi këshillën e Profetit, por nisi t’i udhëzonte edhe të tjerët në zbatimin e saj. Kjo do të thotë se muslimani duhet ta ketë vdekjen para syve, kështu që duhet të përgatitet me punë të mira, pa u dembelosur dhe pa u vonuar. Të bëjë vepra të mira gjatë ditës me mendimin se nuk do e zërë mbrëmja, gjithashtu të bëjë vepra të mira gjatë natës me mendimin se nuk do e zërë agimi. Në biografinë e Mensur bin Zadhanit në librin Tehdhibul kemal thuhet: **“Hushejm bin Beshir el Uasiti thoshte: “Sikur t’i thuhej Mensur bin Zadhanit se meleku i vdekjes po të pret tek dera, ai nuk do kishte më ç’të shtonte në veprat e tij.”**

4 - “Merr nga shëndeti yt për rastet e sëmundjeve (që do të vijnë) dhe nga jeta jote për vdekjen (që do të vijë).” Kjo do të thotë se muslimani duhet të angazhohet me punë të mira atëherë kur ta ketë të mundur diçka të tillë dhe kjo kur është mirë me shëndet para se t’i vijë ajo që e pengon nga këto vepra; sëmundja dhe pleqëria. Ai duhet ta ndërtojë jetën e tij me punë të mira, para se ta zërë vdekja në befasi, e kështu të kalojë nga bota e punës në botën e shpërblimit.

5 - Përfitimet që nxirren nga ky hadith janë:

1- Inkurajimi që njeriu të ndihet si i huaj në këtë botë, me qëllim që të përgatitet në të me punë të mira.

2 - Mësuesi mund të bëjë ndonjë veprim që tërheq vëmendjen e nxënësit, me qëllim që ai të kuptojë më mirë ato që i thuhet, kjo duke u bazuar në fjalën e Ibn Umerit: **“Një herë i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) më kapi tek krahu.”**

3 - Iniciativa që kishin sahabët në kryerjen e porosive profetike.

4 - Vlera e Abdullah bin Umerit, i cili e mori këshillën e Profetit dhe i nxiti të tjerët në praktikimin e saj.

5 - Nxitja për inisjativa rreth punëve të mira, pa treguar dembelizëm apo vonesë.

41 - Nuk beson dikush derisa dëshirat e tij të pasojnë sheriatin tim.

Ebu Muhamed Abdullah bin Amr bin Asi (radijAllahu ‘anhu) transmeton se i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Askush nga ju nuk beson, derisa dëshirat (pasionet) e tij të jenë në përputhje me fenë që solla.”** Hadithi është i saktë. Ai na është transmetuar në librin El Mehaxhe me zinxhir të saktë transmetimi.

1 - Hadithin e ka saktësuar Neveviu duke iu referuar librit El Mehaxhe. Ibn Rexhebi në librin e tij Xhamiul Ulumi uel Hikem (2/293) thotë: **“Ai ka për qëllim autorin e librit El huxheh, Shejh Ebu el Fet’h Nasr bin Ibrahim el Makdesi esh Shafi, juristin dhe asketin e njohur që jetonte në Damask. Libri i tij titullohet El huxheh ala tariki el mehaxhe, në përmbajtjen e të cilit gjenden bazat e fesë sipas rregullave të vëna nga pasuesit e hadithit dhe Sunetit. Këtë hadith e ka përmendur dijetari i hadithit Ebu Nuajmi në librin e tij “El Arbain” dhe në fillimin e tij kushtëzoi se libri i tij do të përmbante vetëm hadithe të sakta dhe thënie të mira prej atyre që transmetuesit janë në unanimitet për besueshmërinë e atyre burrave që i transmetojnë. Këtë hadith e kanë shënuar edhe imamët e mëdhenj në mesanidet (Mesanid është shumësi i fjalës Musned, i cili nënkupton librin e haditheve të radhitur sipas emrave të Sahbëve. Sh p) e tyre.”** Pas kësaj hafidh Ibn Rexhebi e konsideroi këtë hadith si të dobët dhe sqaroi shkaqet e dobësisë së tij, por hafidh Ibn Haxheri në librin e tij Fet’hul Bari (13/289) jep të kuptojmë se hadithi është i saktë, duke e konsideruar si hadith, të cilin e transmeton Ebu Hurejra. Në këtë mënyrë ai shprehet duke thënë: **“Bejhakui në librin Med’hal dhe Ibn Abdul Berri në librin Bejanul ilmi e kanë transmetuar këtë hadith nga një grup tabiinësh si: Haseni, Ibn Sirini, Shurejhi, Shabiu dhe Nehaiu me zinxhir të mira dhe kjo kur ata flasin për nënçmimin e të folurit vetëm sipas logjikës. Këtë që thanë e përmbledh hadithi i Ebu Hurejrës ku Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) thotë: “Askush nga ju nuk beson derisa dëshirat (epshet, passionet) e tij të jenë në përputhje me fenë të cilën solla.”** Këtë hadith e transmetoi Hasen bin Sufjani etj., dhe burrat e zinxhirit të transmetimi janë të besueshëm. Atë e saktësoi edhe Neveviu në fund të librit El Arbain.

2 - Mohimi i besimit që përmendet në hadith është për qëllim mohimi i besimit të plotë të detyrueshëm. Neveviu në komentin e librit Dyzet hadithet thotë:

“Kjo do të thotë se njeriu duhet ta parashtojë punën e tij te Kurani dhe Suneti, të kundërshtojë dëshirat e tij dhe të ndjekë atë që solli i Dërguari i Allahut. Kjo që thamë është e ngjashme me fjalën e Allahut që thotë:

“Nuk i takon asnjë besimtari apo besimtareje të vërtetë, që kur Allahu dhe i Dërguari i Tij vendosin për një çështje, ata të kenë të drejtë të zgjedhin në atë çështje të tyre.” (Suretu Ahzab, 36) Ndaj nuk i përket askujt veç Allahut të Lartësuar dhe Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) të ketë në dorë ndonjë çështje, apo dëshirë.”

3 - Ibn Rexhebi në librin e tij **“Xhamiul Ulumi uel Hikem”** (2/398-399) thotë:

“Ajo që njihet nga përdorimi i fjalës haua (dëshirë, epsh, pasion) është animi drejt kundërshtimit të së vërtetës, siç thuhet në fjalën e Allahut të Madhëruar: “E mos ndiq dëshirat që të humbasin nga rruga e Allahut.” Në

një ajet tjetër Allahu i Madhëruar thotë: **“Kurse ai që i është frikësuar madhërisë së Zotit të tij dhe e ka frenuar veten nga dëshirat, pa dyshim që do të ketë për strehë Xhenetin.”** (Suretu Naziat, 40 - 41) Por ndodh që fjala haua të ketë si kuptim dëshirën dhe animin tek diçka e këtui përfshihet animi nga e drejta apo diçka tjetër. Por ndoshta ajo përdoret dhe me kuptimin e dëshirës për të vërtetën në veçanti dhe ndjekjen e saj. Safuan bin Asali është pyetur: **“A ke dëgjuar që Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) të ketë përmendur huanë?”** Ai u përgjigj: **“Atë e pat pyetur një beduin për një njeri që e do një popull por që nuk u është bashkangjitur atyre, dhe Profeti i tha: “Njeriu do jetë me atë që ka dashur.”** E në momentin kur zbriti fjala e Allahut: **“Ti mund të largosh kë të duash prej tyre e të afrosh kë të duash”** (Suretu Ahzab, 51), Aisha i tha Profetit: **“Shoh se Zoti yt po ta shpejton dëshirën tënde.”** Ndërsa Umeri në ndodhinë e diskutimit rreth robërve të luftës në Bedr, thotë: **“Atëherë Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e pëlqeu atë që tha Ebu Bekri dhe nuk e pëlqeu atë që thashë unë.”** Në këtë hadith është përdorur fjala haua por është përdorur me kuptimin e pëlqimit të lavdëruar.”

4 - Prej dobive të nxjerra nga ky hadith janë:

1- Domosdoshmëria e ndjekjes së Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) në atë me të cilën ka ardhur.

2- Njerëzit nuk janë të njëjtë në besimin e tyre.

42 - O biri i Ademit! Per sa kohë që me lutesh dhe shpreson tek Unë.

Enesi (radijAllahu ‘anhu) transmeton duke thënë: “E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) duke thënë: **“Allahu i Madhëruar thotë: “O biri i Ademit, nëse ti më lutesh Mua dhe shpreson tek Unë, do të t’i fal të gjitha ato që ke vepruar dhe këtë gjë nuk e kam të vështitrë. O biri i Ademit, nëse mëkatet e tua arrijnë deri lart në qiell dhe ti kërkon falje nga Unë, atëherë Unë do të të fal ty. O biri i Ademit, nëse vjen tek Unë me mëkate në madhësi të tokës, e më pas më drejtohesh duke mos më shoqëruar asgjë, Unë do të vij ty me falje po aq të madhe.”** Tirmidhiu i cili thotë se hadithi është i saktë.

1 - Ky është hadithi i fundit të cilin Neveviu, Allahu e mëshiroftë, e ka përmendur në librin e tij **“Dyzet hadithet.”** Mbi dyzet hadithet ai shtoi edhe dy hadithe, kështu që emërtimi i librit me **“Dyzet hadithet”** bëhet për vështirësi të shprehuri dhe për shkak të fshirjes së zanores i gjatë numërimit. Hadithi që teguam i përket haditheve kudsije të cilat i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i përcjell nga Zoti i tij i Madhëruar.

2 - Fjalët në hadith u drejtohen bijve të Ademit, ndërsa hadithi përmbledh se prej arsyeve që fshijnë mëkatet është lutja ndaj Allahut dhe shpresa ndaj Tij për t’i falur ato gabime. Gjithashtu këtu përfshihet edhe kërkimi i faljes, sinqeriteti ndaj Allahut dhe largimi nga shirku. Me faljen e mëkateve është për qëllim mbulimi i tyre ndaj krijesave, falja e tyre dhe mosndëshkimi për to.

3 - **“O biri i Ademit, nëse ti më lutesh Mua dhe shpreson tek Unë, do të t’i fal të gjitha ato që ke vepruar dhe këtë gjë nuk e kam të vështitrë.”** Lutja që njeriu i drejton Zotit të tij për t’i falur mëkatet dhe shpresa e tij për këtë pa u shoqëruar me pesimizëm, shtoi kësaj dhe pendimin nga ato mëkate, me të gjitha këto arrihet shlyerja e mëkateve edhe nëse ato janë të mëdha, të shumta në numër dhe që përsëriten shpesh. Për këtë arsye në hadith ai tha: **“do të t’i fal të gjitha ato që ke vepruar dhe këtë gjë nuk e kam të vështitrë.”**

Ngjashëm me këtë është fjala e Allahut që thotë: **“Thuaj: “O robërit e Mi që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbisni shpresën në mëshirën e**

Allahut! Allahu, me siguri i fal të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëploti.” (Suretu Zumer, 53)

4 - **“O biri i Ademit, nëse mëkatet e tua arrijnë deri lart në qiell dhe ti kërkon falje nga Unë, atëherë Unë do të të fal ty.”** Nëse mëkatet e robit shtohen dhe arrijnë deri lart në qiell, këtu përfshihet dhe ajo që është poshtë qiellit; retë, apo deri aty sa shkon shikimi i një njeriu, e më pas ky njeri kërkon falje dhe pendohet nga të gjitha këto mëkate, me këtë Allahu i Madhëruar ia fal mëkatet dhe i anashkalon ato. Pendimi realizohet duke braktisur mëkatën, duke u penduar për atë që ka kaluar, si dhe të kesh ambicje që në të ardhmen të mos u kthehesh më atyre. Këto tri gjëra duhen të praktikohen nëse mëkati i është bërë Allahut të Madhëruar, e nëse kërkon ndonjë shlyerje atëherë ai duhet ta shlyej atë. Por nëse është bërë në dëm të njerëzve atëherë duhet t’ua kthejë detyrimet dhe t’u kërkojë falje për atë që u ka bërë.

5 - **“O biri i Ademit, nëse vjen tek Unë me mëkate në madhësi të tokës, e më pas më drejtohesh duke mos më shoqëruar asgjë, Unë do të vijë ty me falje po aq të madhe.”** Shirku ndaj Allahut të Madhëruar është mëkati të cilin Allahu nuk e fal. Çdo mëkat përpos shirkut mbetet nën dëshirën e Allahut; nëse do e fal atë që e ka bërë dhe nuk e dënon, por nëse do e dënon dhe e fut në zjarr por nuk qëndron përjetësisht në të siç ndodh me jobesimtarët. Ai do dalë prej aty dhe do hyjë në xhenet siç thotë Allahu i Madhëruar: **“Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Atij, por gjynahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë.”** (Suretu Nisa, 48) Pra në dy vende në suren Nisa. Ky hadith sqaron se nëse mëkatet arrijnë sa arrijnë në numrin e tyre të madh, Allahu i fal ato por me kusht që robi të jetë i sinqertë në adhurimin e tij ndaj Allahut, si dhe i ruajtur nga shirku ndaj Tij.

6 - Prej dobive të nxjerra nga ky hadith janë:

- 1 - Gjerësia e mirësive të Allahut të Madhëruar dhe falja që Ai u bën mëkateve të robërve të Tij.
- 2 - Prej shkaqeve që shlyejnë mëkatet është lutja ndaj Allahut dhe shpresa në mëshirën e Tij pa pezimizëm.
- 3 - Vlera e kërimit të faljes së bashku me pendimin, dhe se Allahu e fal atë që kërkon falje për mëkatet e tij edhe nëse arrijnë shumë në numër.
- 4 - Shirku ndaj Allahut është mëkati të cilin Allahu nuk e fal, ndërsa mëkatet janë nën dëshirën e Tij.
- 5 - Vlera e sinqeritetit dhe se Allahu me anë të tij fal mëkatet.

43 - Jepini të drejtat atyre që u takojnë.

Ibn Abasi (radijAllahu ‘anhu) transmeton se i Dërguari I Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Jepuni atyre që u takon (me ligj) pjesën e caktuar të trashëgimisë, dhe çfarë të mbetet jepjani burrit mashkull që e meriton më tepër.”** Buhariu dhe Muslimi.

1 - Ky është hadithi i parë nga tetë hadithet që ka shtuar hafidh Ibn Rexhebi, duke plotësuar kështu numrin e pesë dhjetë haditheve si shtojcë ndaj haditheve të Neveviut, Allahu i mëshiroftë. Hafidh Ibn Rexhebi kur i transmeton hadithet nga imamët e mëdhenj shprehet duke thënë; e nxori atë, - e nganjëherë përdor shprehjen; e transmetoi. Ndërsa Neveviu përdorte shprehjen; e transmetoi, - e megjithatë nuk ka dallim mes dy shprehjeve sepse kuptimin e kanë të njëjtë.

2 - Ky hadith është bazë për ndarjen e trashëgimisë. Me trashëgiminë është për qëllim pjesa e caktuar në librin e Allahut e që janë janë gjashtë në numër; dy të tretat, një e treta, një e gjashta, gjysma, një e katërta, një e teta. Në formë të shkurtuar i thuhet; dy të tretat dhe gjysma, gjysma e tyre dhe gjysma e gjysmës. Ose ndryshe thuhet; një e teta, një e gjashta, dyfishi i tyre dhe dyfishi i dyfishit të tyre. Por edhe mund të thuhet; një e treta, një e katërta, dyfishi i secilës dhe gjysma e tij. Gjithsesi me këto kemi për qëllim hiset e detyrueshme, pjesët fikse dhe ato jo fikse që janë përmendur në Kuran në rastin kur fëmijët janë të përzier meshkuj dhe femra, e në këtë rast mashkulli merr pjesë sa për dy femra. Por nëse të gjitha janë femra dhe nuk kanë mes tyre ndonjë mashkull, atëherë dy e sipër marrin dy të tretat e trashëgimisë, ndërsa vajza e vetme merr gjysmën e saj. Këto fjalë thuhet nëse ato janë të një kategorie, siç janë vajzat apo vajzat e djemve. Nëse janë në gradë të ndryshme dhe vajzat janë dy e më shumë, atëherë vajzave të djalit nuk u takon asgjë sepse vajzat marrin dy të tretat. Nëse vajza është e vetme atëherë asaj i takon gjysma, ndërsa vajza e djalit apo vajzat e vajzës marrin një të gjashtën, plotësimin e dy të tretave.

Kjo duke u bazuar në sunetin e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e pikërisht në hadithin që transmeton Buhariu me nr. 6736. Por nëse fëmijët janë vetëm meshkuj sido qofshin; djemtë e tij apo djemt e djemve nëse nuk i kanë prindërit, në këtë rast njëri prej tyre merr të gjithë trashëgiminë. Ndërsa kur janë shumë atëherë e ndajnë atë mes veti në mënyrë të barabartë. Të

njëjtat fjalë thuhet dhe kur trashëgojnë vëllezërit nga gjaku dhe vëllezërit nga babai, njësoj me fjalët që u thanë në trashëgiminë e fëmijëve. Vetëm se këtu u jepet përparësi vëllezërve nga gjaku para vëllezërve nga babai, kështu që meshkujt që nuk kanë femra në mes tyre e ndajnë atë në mënyrë të barabartë. Nëse janë të përzier meshkuj dhe femra, atëherë mashkulli merr pjesë sa për dy femra ndërsa njëra prej tyre merr gjysmën, por nëse janë dy e më shumë atëherë u takon dy e treta. Trashëgimia e vëllezërve nga babai bëhet e njëjtë si trashëgimia e vëllezërve nga gjaku nëse këta të fundit nuk ekzistojnë, por nëse mes tyre gjendet një motër nga gjaku ajo duhet të marrë gjysmën ndërsa motrat nga babai marrin një të gjashtën plotësimin e dy të tretave, sido qofshin në numër; një apo më shumë.

Kur trashëgojnë prindërit secili prej tyre merr një të gjashtën nëse i vdekuri ka fëmijë mashkull, por nëse fëmija i tij është femër atëherë babai merr pjesën e mbetur pas ndarjes së pjesëve fikse. Nëse i vdekuri nuk ka patur fëmijë në këtë rast nëna e tij merr një të tretën, ndërsa pjesa e mbetur i takon babait. Vetëm se në këtë rast nëse me dy prindërit është njëri nga dy bashkëshortët, atëherë nëna merr një të tretën e mbetur pasiqë i jepet njërit prej bashkëshortëve. Këtyre dy çështjeve u thuhet; çështje umerite, sepse në këtë mënyrë gjykoi prijësi i besimtarëve Umer bin Hatabi (radijAllahu ‘anhu).

Nëse i vdekuri ka vëllezër sido qofshin ata; nga gjaku, nga babai apo nëna, në këtë rast trashëgimia që i takon nënës është një e gjashta, ndërsa gjyshi; babai i babës merr pjesën e babait nëse ai nuk ekziston. Gjithashtu edhe gjyshja merr një të gjashtën nëse e bija e saj mungon, sido që të jetë gjyshja; nga nëna apo babai. Në kohën kur bashkohen gjyshet që trashëgojnë atëherë të gjitha marrin pjesë në një të gjashtën. Pjesa e trashëgimisë së vëllezërve nga nëna është një e gjashta nëse i vdekuri nuk ka ndonjë nip, mbesë apo edhe djem që e trashëgojnë. Nëse janë më shumë se një sido qofshin; vetëm meshkuj, vetëm femra apo të përzier meshkuj e femra, në këtë rast ata marrin në një të tretën në mënyrë të barabartë, pra nuk ka dallim mes meshkujve të tyre dhe femrave. Përsa i përket trashëgimisë së dy bashkëshortëve duhet ditur se burri trashëgon gjysmën nëse i vdekuri nuk ka dikë që ta trashëgojë, e nëse ai ekziston atëherë burri merr një të katërtën. Ndërsa gruaja merr një të katërtën nëse i vdekuri nuk ka njeri që ta trashëgojë, e nëse ai ekziston atëherë gruas i takon vetëm një e teta. Nëse ato janë më shumë se një bashkëshorte, atëherë bëhen pjesmarrëse në një të katërtën dhe një të tetën. Allahu i Madhëruar e ka përmendur në librin e Tij fisnik ndarjen e trashëgimisë në tri ajete. Ajeti i parë është fjala e Tij që thotë: **“Allahu ju urdhëron për trashëgiminë tuaj...”** (Suretu Nisa, 11), këtu flitet për trashëgiminë e lidhjes së gjakut ku bëjnë pjesë

trungu familjar dhe pasardhësit e të vdekurit. Në ajetin e dytë është fjala e Allahut që thotë: **“Juve ju takon gjysma e pasurisë nga ajo që kanë lënë bashkëshortet tua.”** (Suretu Nisa, 12) Ky ajet flet për trashëgiminë e dy bashkëshorteve dhe vëllezërve nga nëna. Ndërsa ajeti i tretë është fjala e Allahut në fundin e sures Nisa ku thotë: **“Ata kërkojnë nga ti (Muhamed) gjykim (për dikë që vdes pa pasur trashëgimtarë). Thuaju: “Allahu ju udhëzon juve për një njeri të tillë.”** (Suretu Nisa, 176) Ky ajet flet për trashëgiminë e vëllezërve nga gjaku dhe vëllezërve nga babai.

3 - Nga ajo që sqaruar më parë del në pah se djemtë dhe djemt e djemve e kështu me rradhë, nëse kanë mes tyre femra ato bëhen pjesmarrëse me ta në trashëgimi por mashkulli merr pjesë sa për dy femra. E njëjta thuhet për vëllezërit nga gjaku dhe vëllezërit nga babai; bashkë me ta bëhen pjesmarrëse edhe motrat e tyre por mashkulli merr pjesë sa për dy femra. Djemve të vëllezërve nga nëna nuk u takon asgjë nga trashëgimia, ndërsa fëmijëve të vëllezërve nga gjaku dhe vëllezërve nga babai apo xhaxhallarët e kështu me rradhë, apo fëmijët e xhaxhallarëve e kështu me rradhë, në këtë rast meshkujt e tyre veçohen në marrjen e trashëgimisë nga femrat, sepse femrave nuk u jepet pjesë kur janë të veçuara. Gjithashtu nuk u takon pjesë edhe kur bashkohen, pra në këtë rast veçohen vetëm meshkujt në marrjen e kësaj trashëgimie, e kjo duke u bazuar në fjalën e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) që thotë: **“Jepuni atyre që u takon (me ligj) pjesën e caktuar të trashëgimisë, dhe çfarë të mbetet jepjani burrit mashkull që e meriton më tepër.”** Por nëse i vdekuri ka një vajzë apo shumë vajza dhe motër apo motra nga gjaku, e gjithashtu ka vëllezër nga babai, në këtë rast vëllezërit nga babai nuk marrin gjë ndërsa motra apo motrat nga gjaku trashëgojnë tepricën e pjesëzës së vajzave, të lidhur bashkë me të tjerët. Këtë që thamë e pohon suneti i Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), hadith të cilin e transmeton Buhariu me nr. 6741 dhe 6742, kështu që veçohet nga hadithi tjetër që thotë: **“Jepuni atyre që u takon (me ligj) pjesën e caktuar të trashëgimisë, dhe çfarë të mbetet jepjani burrit mashkull që e meriton më tepër.”** Sepse motrat nga gjaku janë më të afërta tek i vdekuri se vëllezërit nga babai.

4 - Dobia e përmendjes së gjinisë mashkull pas fjalës burrë, kur thotë: **“jepjani burrit mashkull që e meriton më tepër”**, është se burri është ai që ka mbushur një moshë në të cilën gëzon forcë dhe ndihmë. Atij iu bashkangjijt fjala mashkull për të treguar se trashëgimia është e lidhur me gjininë dhe jo me burrërinë dhe forcën, kështu që barazohen të gjithë; si i madhi në moshë ashtu dhe i vogli fare.

5 - Prej dobive të nxjerra nga ky hadith janë:

1 - Përsosmëria e legjislacionit dhe gjithëpërmbledhja e tij e rregullave tërësore të përgjishme, siç u pohua në këtë hadith.

2 - Atij që trashëgon i jepet prioritet me anë të ajetit kuranor kështu që i jepet pjesa e tij, ndërsa ajo që mbetet u jepet të tjerëve pa ndonjë llogaritje.

3 - Bazuar mbi këtë hadith, përfitojmë se mendimi më i saktë përsa i përket trashëgimisë së gjyshit dhe vëllezërve është veçimi i gjyshit në këtë trashëgimi dhe jo vëllezërve, sepse gjyshi i përket trungut ndërsa vëllezërit trashëgojnë sepse ai nuk ka lënë trashëgimtarë. Edhe gjyshi është i njëjtë me babain i cili veçohet prej tyre në këtë trashëgimi, gjithashtu mendimi më i saktë mbetet të jetë prioriteti i vëllezërve nga nëna ndaj vëllezërve nga gjaku përsa i përket çështjes së pjesmarrjes. Vëllezërit nga nëna trashëgojnë me tekst kuranor, ndërsa vëllezërit nga gjaku trashëgojnë për shkak të trungut familjar. Atij që trashëgon me tekst kuranor duhet t'i jepet pjesa, ndërsa të tjerët të marrin pjesën e mbetur; nëse mbetet diçka e marrin, në të kundërtën mbeten pa të.

44 - Gjithënia bën të ndaluar njësoj si nga gjaku.

Aisha (radijAllahu ‘anha) transmeton se profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Taisja (gjithënia) ndalon atë që ndalon edhe afërsia e gjakut.”** Buhariu dhe Muslimi.

1 - Në Kuranin Famëllartë është përmendur ndalimi i rreptë i martesës me nënat nga gjiri dhe motrat nga gjiri. Ky ndalim përmendet në fjalën e Allahut që thotë: **“...me nënat (gratë) që ju kanë dhënë gj, me motrat tuaja që kanë thithur prej një gjiri.”** (Suretu Nisa, 23) Ndërsa suneti ka sjellë këtë hadith që do të thotë se taisja ndalon atë që ndalon dhe afërsia e gjakut. Çdo gjë që është ndaluar me afërsi gjaku është ndaluar edhe me anë të taijses. Prandaj nëse një fëmijë ushqehet me qumësht gjiri nga një grua ajo konsiderohet nënë për të nga gjiri, ndërsa babai dhe gjyshërit e saj për të bëhen baballarë nga qumështi. Gjithashtu nëna e gjyshet e saj bëhet nëna për të nga qumështi, vëllezërit e saj bëhen dajallarë për të nga qumështin ndërsa motrat e saj për të bëhen teze nga qumështi. Edhe fëmijët e saj sido qofshin; me një burrë apo me burra të ndryshëm, konsiderohen vëllezër për të nga qumështi. Edhe burri i gjithënesës që e ushqe me shpenzimet e tij konsiderohet baba qumështi për foshnjën, ndërsa babai dhe gjyshërit e tij konsiderohen baballarë qumështi për të. Nëna dhe gjyshet konsiderohen për të nëna nga qumështi, edhe vëllezërit dhe motrat

e tij konsiderohen xhaxhallarë dhe halla për të nga qumështi. Fëmijët e tij qofshin dhe nga gra të ndryshme konsiderohen vëllezër për të nga qumështi, edhe gratë e tij konsiderohen gra të babait nga qumështi, e kështu me rradhë. Pra çdo gjë që ndalohet me afërsi gjaku ndalohet edhe me taisje.

2 - Taisja që ndalon martesën është kur fëmija arrin të pijë qumësht pesë herë ose më shumë, dhe kur mosha e fëmijës nuk i ka kaluar dy vjeç. Nëse ai nuk pi pesë herë me këtë nuk realizohet ndalimi i martesës, ashtu sikurse taisja e të rriturit nuk e realizon këtë ndalim. Përsa i përket ndodhisë së Salim meula ebu Hudhejjes të cilën e ka transmetuar Muslimi me nr. 1453, ai gjykim është i veçantë për të dhe nuk kalon tek të tjetrët. Prej arsyeve që sqarojnë se taisja e të rriturit në moshë nuk merret parasysh, është fakti se ai me këtë nuk është se po ushqehet sepse çdo grua i ka mundësitë që nëse do të largohet prej burrit të saj të nxjerrë në një enë qumështin e pesë herëve, e më pas t'ia japë burrit të saj pa e ndier ai e më pas t'i thotë: Unë nuk jam e lejuar për ty sepse je fëmija im nga qumështi!

3 - Prej dobive të nxjerra nga ky hadith janë:

1 - Përsosmëria e legjislacionit dhe gjithëpërmbledhja e tij mbi rregullat tërësore të përgjishme, siç u pohua në këtë hadith.

2 - çdo grua që bëhet e ndaluar nga afërsia e gjakut, bëhet e ndaluar edhe me anë të taisjes.

45 - Allahu dhe i Dërguari i Tij e kanë ndaluar shitblerjen e alkoolit.

Xhabir bin Abdilahu (radijAllahu ‘anhu) transmeton se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) në Meke vitin e çlirimit të saj duke thënë: **“Vërtet Allahu dhe i Dërguari i Tij e kanë ndaluar shitjen e alkoolit, gjësë së ngordhur, derrit dhe idhujve.”** I thanë: **“O i Dërguari i Allahut! Çfarë mendon për dhjain e të ngorshurës me të cilin lyhen anijet, dhe lëkurat që njerëzit i përdorin edhe për ndriçim? Ai tha: “Jo! Ato janë të ndaluara.”** Më pas Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) tha: **“Allahu i vraftë çifutët! Allahu ua ndaloi atyre dhjain, por ata e shkrinë e më pas e shitën dhe hëngrën fitimin e tij.”** Buhariu dhe Muslimi.

1 - Në fjalët e tij: **“Vërtet Allahu dhe i Dërguari i Tij e kanë ndaluar”**, shprehja e foljes erdhi në numrin njëjës por është përmendur dhe në numrin shumës. Gjithashtu në një version ka ardhur vetëm: **“Allahu e ka ndaluar.”** Ndërsa numri shumës ku përemri i kthehet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, është hadithi ku Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) thotë: **“Nëse ndodhen tri gjëra tek një person, ai e ka gjetur ëmbëlsinë e besimit: Nëse Allahu dhe i Dërguari i Tij janë më të dashur për të se çdokush tjetër...”** Këtë hadith e transmetoi Buhariu me nr. 16 dhe Muslimi me nr. 67. Në bazë të kësaj kuptohet dhe mënyra se si erdhi në këtë hadith me formën **“kanë ndaluar”** sepse ajo i kthehet edhe Profetit, ndërsa ndalimi që i dedikohet Allahut mbetet i fshirë dhe do të thotë: Me të vërtetë Allahu ka ndaluar dhe Profeti i Tij ka ndaluar. Kjo që u tha është e ngjashme me fjalën e Allahut të Madhëruar që thotë: **“Allahu dhe i Dërguari i Tij janë më të meritueshëm që t’i kënaqin”**, që do të thotë: Allahu e meriton më shumë që ta kënaqin si dhe Profeti i Tij e meriton më shumë që ta kënaqin, dhe i ngjashëm me këtë është vargu i një poeti i cili thotë:

Ne të vijmë me atë që kemi dhe ti eja me atë që ke, Të gëzuar mbetemi e pse mendimet s’të përputhen me ne. Kjo do të thotë se ne jemi të gëzuar me atë që kemi dhe ti je i gëzuar me atë që ke.

2 - Xhabiri tregoi se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) t’i ndalonte këto gjëra. Ai e kishte dëgjuar në vitin e çlirimit në Meke. Ky sqarim në atë kohë dhe në atë vend u bë për shkak të pranimi të Islamit nga jobesimtarët, të cilët merreshin me këto gjëra të ndaluara. Ai i mësoi ata se këto gjëra janë të ndaluara, por kjo nuk e pengon që ndalimi për ato gjëra të ketë qenë edhe më parë.

3 - E ndaluara e parë në këto katër të ndaluara është alkooli; nëna e të këqijave sepse ai që e pi e rreshton veten e tij me budallenjtë, e si rrjedhojë kjo e shpie në çdo vepër të ndaluar. Ky veprim mund të shkaktojë edhe sulm ndaj afërsisë së gjakut, pra ajo sjell çdo të keqe dhe shpie drejt çdo belaje prandaj alkoli u quajt; nëna e të këqijave. E dyta është e ngordhura e cila ndalohet të hahet me përjashtim në raste nevojë të theksuar për të mbajtur shpirtin gjallë, në një kohë kur nuk gjen gjë tjetër për të ngrënë. Nga e ngordhura përjashtohet lëkura e saj nëse ajo regjet. E themi këtë duke u bazuar në hadithin e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) të cilin e transmeton Buhariu me nr. 2221 dhe Muslimi me nr. 366. E treta është derri i cili nuk lejohet të hahet e as të shitet, dhe çdo gjë e cila ndalohet të hahet nga kafshët ajo ndalohet si e ngordhur ashtu dhe e prerë.

E katërta janë idhujt të cilët nuk lejohet të shiten apo të mbahen sepse janë bërë për tu adhuruar, madje kërkohet që të prishen dhe të thyhen dhe nuk ka mëkat nëse ato përdoren pasi të thyen, qoftë në ndërtim apo diçka tjetër, sepse ajo nuk quhet më idhull.

4 - Hafidh Ibn Haxheri në librin e tij **“Fet’hul Bari”** (4/425) thotë: **“Përsa i përket fjalës së Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): Çfarë mendon për dhjamin e të ngorshurës me të cilin lyhen anijet, dhe lëkurat që njerëzit i përdorin edhe për ndriçim?”** do të thotë; a është e lejuar t’i tregtojmë për shkak të dobive që u përmendën dhe që përmbajnë ligjshmërinë e tregëtimit. Fjala e tij: **“Ai tha: Jo! Ato janë të ndaluara”**, pra tregëtimi. Kështu e komentuan disa dijetarë si Shafiu dhe ndjekësit e tij, por disa të tjerë fjalën e tij: **“Ato janë të ndaluara”**, e kuptuan për ndalimin e përdorimit të tyre dhe thanë: Është e ndaluar që të përfitohet prej tyre, - dhe ky është mendimi i shumicës së dijetarëve. Prandaj nuk duhet të përfitojmë nga e ngordhura që në origjinë, përveçse në gjërat që janë veçuar me argument si është rasti i lëkurës së regjur.”

5 - **“Allahu i vraftë çifutët! Allahu ua ndaloi atyre dhjamin, por ata e shkrinë e më pas e shitën dhe hëngrën çmimin e tij.”** Këto janë disa nga dredhitë që përdornin çifutët, sepse kur Allahu ua ndaloi dhjamin ata e shkrinë dhe e shitën atë dhe u ushqyen me fitimin e tyre. Kur Allahu e ndalon diçka e ndalon dhe fitimin e saj, dhe kjo ishte arsyeja që e nxiti Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) të lutej kundër tyre.

6 - Prej dobive të nxjerra nga ky hadith janë:

1 - Hadithi pohon ndalimin që Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) u bëri këtyre katër gjërave.

2 - Këtë sqarim e bëri në vitin e çlirimit në Meke me qëllim që të distancoheshin ata që sapo ishin bërë musliman nga këto katër gjëra, si në përdorimin ashtu dhe në tregëtimin e tyre.

3 - Atë që Allahu e ka ndaluar, edhe tregëtimi dhe fitimi prej saj është i ndaluar.

4 - Ndalimi i dredhive të cilat shpien në lejimin e asaj që Allahu e ka ndaluar.

5 - Përçmimi i çifutëve dhe sqarimi se ata janë njerëz dredhacak që mundohen të arrijnë në lejimin e gjërave të ndaluara.

6 - Në këtë hadith i tërhiqet vëmendja këtij umeti që të mos bien në gjërat në të cilat ranë çifutët prej këtyre dredhive.

46 - Çdo pije dehëse është e ndaluar.

Ebu Burde transmeton nga babai i tij Ebu Musa el Eshari (radijAllahu ‘anhuma) të cilin Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e kishte dërguar në Jemen, dhe e pyeti për pijet që prodhoheshin atje duke i thënë: **“Çfarë pijesh janë ato?”** Ai i tha: **“El Bitu dhe El Mizru.”** Ebu Burde u pyet: **“Çështë El Bitu?”** Ai tha: **“Është vera që prodhohet nga mjalti, ndërsa El Mizru është vera që prodhohet nga elbi.”** Atëherë Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) tha: **“Çdo gjë që deh është e ndaluar.”** Buhariu.

1 - Prej pijeve që përdorëshin në Jemen në kohën kur i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) kishte dërguar atje Ebu Musa el Eshariun, ishin El Bitu që ishte vera e nxjerrë nga mjalti, dhe El Mizru që ishte vera e nxjerrë prej elbit. Ebu Musa e pyeti të Dërguarin e Allahut për këto dy lëngje, dhe profeti iu përgjigj me një përgjigje përmbledhëse në të cilën përfshihen dhe shumë lloje të tjera. Ai i tha: **“çdo gjë që deh është e ndaluar”**, pra ai e lidhi ndalimin me dehjen që tregon se çdo pije që deh është e ndaluar, ndërsa ato që nuk e dehin njeriun janë të lejuara. Në sahihun e Buhariut me nr. 5598 Ebu Xhuejria transmeton: E pyeta Ibn Abasin për Badhikun, dhe më tha: Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e ka përmendur më parë Badhikun, sepse çdo pije që deh është e ndaluar. Tha: Pija e lejuar dhe e mirë. Tha: **“Pas të lejuarës së mirë nuk ka vetëm se të ndaluar të keqe.”** Ibn Sejide në librin **“El Muhkem”** ka përmendur se Badhiku është prej emrave të alkoolit, për më tepër shih **“Fet’hul Bari”** (10/63). I Dërguari i Allahut në fillim e pati ndaluar që vera të mbyllej në enë të posaçme, siç është transmetuar në hadithet e delgatëve të fisit Abdul Kajs të cilin e transmeton Buhariu me nr. 53 dhe Muslimi me nr. 23. Më pas është transmetuar nga ai një hadith që e anullos të parin, e ai është hadithi i Burejde bin Husajbit i cili transmeton se i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Unë u kisha ndaluar nga vizita e varrezave por ju i vizitoni ato, gjithashtu u kisha ndaluar nga përdorimi i mishit të kurbanëve mbi tri ditë por ju tani mbani sa ta shihni të arsyeshme. Gjithashtu u kisha ndaluar nga vera përpos asaj që prodhohet në enë e ju tani mund ta pini të gjithë enën, por mos pini lëng që deh.”** (E transmeton Muslimi me nr. 977) Pra çdo gjë që deh është e ndaluar sido që të

jetë; lëng apo ushqim, lëndë e rrjedhshme, e ngurtë apo diçka tjetër, sepse të gjitha këto përfshihen në fjalën e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) që thotë: **“çdo gjë që deh është e ndaluar.”**

2 - Vera është ajo që pushton trurin dhe e mbulon atë, dhe çdo send tjetër i ngjashëm me të përfshihet në fjalën e Profetit që thotë: **“çdo gjë që deh është e ndaluar.”** Çdo send që teprica e saj të deh atëherë edhe sasia më e vogël e saj është e ndaluar, kjo për të prerë rrugën e cila shpie drejt dehjes. Ajo ndalohej ngado që të jetë bërë; nga rrushi apo diçka tjetër. Disa dijetarë të Kufes kanë pohuar se të pish pak prej saj duke mos u dehur dhe nëse nuk është e prodhuar nga rrushi, nëse e pi kjo është e pranueshme.

Duhet ta dini se këto fjalë nuk janë të sakta, sepse është saktësuar nga Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) në hadithin e Xhabirit etj. se ai ka thënë: **“Sasia e madhe e asaj që deh e ndalon edhe masën më të vogël të saj.”** (E transmeton Ebu Daudi me nr. 3681, Tirmidhiu me nr. 1 865, dhe Ibn Maxheh me nr. 3 393) Ky është një term i përgjithshëm i cili përfshin çdo gjë që deh, sido që të jetë prodhuar; nga rrushi apo diçka tjetër, prandaj nuk lejohet të përdoren gjërat dehëse me përjashtim të rastit kur njeriu është i detyruar nga mungesa e ujit, në këtë rast ai mund të pijë pak.

3 - Prej dobive të nxjerra nga ky hadith janë:

1 - Kujdesi që tregonin sahabët për të njohur dispozitat fetare.

2 - Përsosmëria e legjislacionit dhe gjithëpërmbljedhja e tij mbi rregullat tërësore të përgjishme, siç u pohua në këtë hadith.

3 - Ndalimi i çdo gjëje që deh i çfarëdo lloji qoftë ai.

47 - S`ka mbushur biri i Ademit enë më të keqe se barkun e tij.

Mikdam bin Mead Jekreb (radijAllahu ‘anhu) thotë: E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) duke thënë: **“Ena më e keqe që mbush njeriu është barku i tij. Atij i mjaftojnë disa kafshata për të mbajtur veten. Por po deshi më tepër; një të tretën e stomakut ta lërë për ushqim, një të tretën për të pirë dhe një të tretën për ajër (bosh).”** Hadithin e transmeton Ahmedi, Tirmidhiu, Nesaiu dhe Ibn Maxheh. Tirmidhiu tha: Hadithi është i mirë.

1 - Fjalët e tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“Ena më e keqe që mbush njeriu është barku i tij”**, tregojnë se ena është ai vend ku vendosen gjërat, dhe ena më e keqe që mbushet është barku për shkak të pasojave që vijnë prej tij, siç është dyspepsia dhe sëmundje të tjera. Gjithashtu dembelizimi, dobësia dhe pushimet e gjata si pasojë e këtij problemi.

2 - **“Atij i mjaftojnë disa kafshata për të mbajtur veten”**, që do të thotë se birit të Ademit i mjaftojnë disa kafshata me të cilat ai mund të jetojë, dhe ky është shpjegimi i fjalës: **“për të mbajtur veten.”** Këtu del në pah nxitja për pakësimin e të ngrënit dhe mos zgjerimin e tij me qëllim që njeriu të gëzojë zell, shkathtësi dhe mbrojtje nga çdo sëmnudje që vjen nga të ngrënit e tepërt.

3 - **“Por po deshi më tepër; një të tretën e stomakut ta lërë për ushqim, një të tretën për të pirë dhe një të tretën për ajër (bosh).”** Kjo do të thotë: Nëse njeriut nuk i mjaftojnë ato kafshata për të mbajtur veten dhe kërkon patjetër diçka më shumë se kjo sasi, atëherë le të jetë sasia e asaj që ha dhe pi në kufijtë e dy të tretave të stomakut, me qëllim që një e treta të mbetet për frymarrje më të lehtë.

4 - Prej dobive të nxjerra nga ky hadith janë:

1 - Në hadith dalin në pah normat fetare me të cilat duhet të pajiset çdo njeri që ushqehet me sasinë e ushqimit që ha.

2 - Qortimi i mbushjes së stomakut sepse kjo gjë sjell sëmundje, dembelizëm dhe dobësi.

3 - E mjaftueshmja arrihet me gjërat nëpërmjet të cilave realizohet të qenit gjallë.

4 - Nëse kërkohet patjetër që njeriu të shtojë masën e ushqimit, atëherë le ta llogarisë që të jetë në sasinë e dy të tretave të stomakut.

48 - Katër cilësitë e hipokritit.

Abdullah bin Amr (radijAllahu ‘anhu) transmeton se profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Tiparet e hipokrizisë (nifakut) janë katër të cilat po u mblodhën tek ndonjëri është vërtet hipokrit, ndërsa ai që zotëron një prej tyre ka në vetvete cilësi hipokrizie derisa të heqë dorë. Këto tipare janë: Kur flet gënjen, kur premton nuk e mba fjalën, kur ka një konflikt e shkel të drejtën, dhe kur zotohet nuk e përmbush zotimin.”** Buhariu dhe Muslimi.

1 - **“Tiparet e hipokrizisë (nifakut) janë katër të cilat po u mbledhën tek ndonjëri është vërtet hipokrit, ndërsa ai që zotëron një prej tyre ka në vetvete cilësi hipokrizie derisa të heqë dorë.”** Kjo do të thotë se ai që i ka të gjitha këto tipare ka bërë hipokrizi në vepra, ndërsa ai që ka njërin cilësi atëherë ai është i mveshur me një tipar hipokrizie, dhe ashtu do i mbetet derisa të heqë dorë prej saj. Kjo tregon për sqarimin e përsosur të Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), sepse në fillim ai përmendi numrin e më pas filloi ti sqaronte një për një. Kjo metodë e nxiti dëgjuesin të përgatitet dhe të kuptojë ato që i thuhën prej këtyre tipareve, me qëllim që t’i kërkojë vetes numërimin e këtyre tipareve, e nëse nuk përputhen atëherë e kupton se diçka i ka kaluar.

2 - Tipari i parë ishte gënjeshtria në të folur e kjo duke u treguar të tjerëve fjalë që nuk janë të vërteta, pra tregon për lajme jo reale. Me këtë gjest ai dëmton veten sepse cilësohet me këtë moral të ulët, nga ana tjetër dëmton njeriun të cilit i jep të kuptojë se është i sinqertë në atë që thotë. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Jini të sinqertë, sepse sinqeriteti shpie drejt mirësisë ndërsa mirësia të çon në xhenet. Njeriu vazhdon të thotë gjithnjë të vërtetën dhe ta kërkojë vazhdimisht atë derisa të shkruhet te Zoti sidik (tepër i vërtetë dhe i sinqertë). Nga ana tjetër kini kujdes nga gënjeshtria sepse gënjeshtria shpie drejt shthurjes e cila të çon në zjarrin e xhehenemit. Njeriu gënjen e gënjen dhe e kërkon vazhdimisht atë, derisa të shkruhet te Zoti kedhab (gënjeshtar shumë i madh).”** (E transmeton Muslimi me nr. 2 607)

Tipari i dytë ishte thyerja e premtimit. Kjo ndodh kur ai premtim për diçka dhe në brendësinë e tij synon që të mos e mbajë atë. Nga ana tjetër, nëse njeriu premtim dhe është i vendosur që ta mbajë premtimin dhe befas i del diçka që e ndalon nga përmbushja e këtij premtimi, në këtë rast ai konsiderohet i justifikuar. Ebu Daudi transmeton me nr. 4991 nga Abdullah bin Amir i cili thotë: **“Një ditë më foli nëna ime ndërkohë që Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) qëndronte në shtëpinë tonë, duke më thënë: “Eja të të jap diçka.”** Profeti iu drejtua nënës duke i thënë: **“çfarë deshe t’i jepje?”** Ajo tha: **“Deshi t’i jepja hurmë.”** Atëherë Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i tha: **“Nëse ti nuk do i jepje asgjë, kjo do të shkruhej gënjeshtër për ty.”** (Për më tepër shih librin Vargu i haditheve të sakta me autor Albanin me nr. 748)

Tipari i tretë ishte shkelja e të drejtave gjatë konfliktit e cila ndodh kur një njeri është në konflikt me një tjetër, ai zemërohet dhe i kalon caqet duke kaluar nga drejtësia në padrejtësi. Allahu i Madhëruar thotë: **“Mos t’u pengojë armiqësia që keni ndaj një populli që të tregoheni të padrejtë.”** Dhe: **“Mos tu pengojë**

armiqësia ndaj një populli i cili u ndaloi nga xhamia e shenjtë që të tregoheni të padrejtë.”

Hafidh Ibn Haxheri në librin e tij **“Fet’hul Bari”** (1/90) thotë: **“Shkelja e të drejtave është; të distancohesh nga e drejta dhe të bësh dredhira për ta kundërshtuar atë.”**

Ndërsa Ibn Rexhebi në librin e tij **“Xhamiul Ulumi uel Hikem”** (2/486) thotë: **“Nëse njeriu posedon pushtet gjatë një konflikti, sido që të jetë ngryrimi i tij; fetar apo në çështjet e kësaj bote, dhe ai i del në ndihmë të kotës duke ia mveshur atij që e dëgjon sikur ajo është e vërteta dhe e përçmon të drejtën duke e nxjerrë në pamjen e të kotës, veprimi i tij është prej të ndaluarave më të mëdha dhe prej tipareve më të ndyra të hipokrizisë.”**

Tipari i katërt është mos përmbushja e zotimit. Allahu i Madhëruar thotë: **“Dhe përmbushni zotimet. Me të vërtetë, për zotimet do të jeni përgjegjës.”**

(Suretu Isra, 34) Dhe: **“Kur të zotoheni përmbushini zotimet që i keni dhënë Allahut, dhe mos i prishni ato pasi që i keni pohuar, ndërkohë që Allahun e keni lënë dorëzan në këtë gjë.”** Ibn Rexhebi në librin **“Xhamiul Ulumi uel Hikem”** (2/487-488) thotë: “Prishja e zotimit është e ndaluar për çdo zotim që ndodh mes muslimanëve apo të tjerëve, edhe nëse ai që e merr nën mbrotje është jobesimtar. Për këtë arsye në hadithin e Abdullah bin Amrit Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) thotë: **“Kush vret një njeri muahid (të cilin shteti musliman e ruan që të jetojë në vendet Islame) pa të drejtë, ai nuk do ta ndiej erën e xhenetit edhe pse era e tij ndihet dyzet vjet larg.”**

(E transmeton Buhariu) Allahu i Madhëruar na urdhëron në librin e Tij që t’i përmbushim zotimet edhe ndaj idhujtarëve, nëse ata u qëndrojnë besnik zotimeve të veta dhe nuk i thyejnë ato. Ndërsa zotimet e muslimanëve mes njëri - tjetrit nuk ka dyshin se janë edhe më të forta, dhe mos përmbushja e tyre është mëkat edhe më i madh.

Prej thyerjeve më të mëdha të zotimeve është kur dikush thyen zotimin dhe besën që i ka dhënë prijësit. Në dy sahihet e Buhariut dhe Muslimit, Ebu Hurejra (radijAllahu ‘anhu) transmeton se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Tri personave Allahu nuk do u flasë ditën e gjykimit, nuk do i pastrojë dhe ata do kenë dënim të dhembshëm...”** - dhe në mesin e tyre përmendi; **“dhe një njeri që i zotohet një prijësi në çështjet e dunjasë, e nëse ai zotohet e mba zotimin, në të kundërtën e thyen atë.”** Tek zotimet të cilat i kemi detyrë që t’i përmbushim dhe na ndalohet t’i thyejmë përfshihen të gjitha aktet e muslimanëve që kryejnë mes tyre nëse ata i pranojnë, siç është shitblerja, martesë etj. prej akteve të domosdoshme të cilat duhen

përmbushur. Këtu bën pjesë edhe përmbushja e zotimit që robi e bën për Zotin e tij, siç është zotimi në veprimin e një gjëje etj.”

3 - Prej dobive të nxjerra nga hadithi janë:

1 - Prej mësimdhënies së mirë është kur mësuesi përmend radhitjen me numra para se t'i sqarojë ato.

2 - Në hadith tregohet rrezikshmëria e tipareve të hipokrizisë për njeriun.

3 - Qortimi ndaj gënjeshtërsisë në të folur dhe se ajo është tipar hipokrizie.

4 - Qortimi ndaj mosmbajtjes së premtimit dhe se ai është tipar hipokrizie.

5 - Qortimi ndaj shkeljes së të drejtave gjatë konfliktit dhe se ajo është tipar hipokrizie.

6 - Qortimi nga mos përmbushja e zotimeve dhe se ajo është tipar hipokrizie.

49 - Sikur t'i mbështeteshit Allahut me bindje të patundur.

Umer bin Hatabi (radijAllahu ‘anhu) transmeton se profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Nëse ju do ti mbështeteshit Allahut ashtu siç duhet, Ai do t’ju furnizonte ashtu siç i jep zogut, i cili del i urtitur në mëngjes dhe në mbrëmje kthehet i ngopur.”** Këtë hadith e transmetojnë: Ahmed, Tirmidhiu, Nesaiu, Ibn Maxheh, Ibn Hibani në Sahihun e tij dhe Hakimi. Tirmidhiu për këtë hadith tha se është i mirë dhe i saktë.

1 - Ky hadith është parim bazë në mbështetjen tek Allahu i Madhëruar, pa harruar dhe përdorimin e shkaqeve të lejuara. Gjithashtu përdorimi i këtyre shkaqeve nuk bie ndesh me mbështetjen tek Allahu i Lartësuar, sepse i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem); njeriu më i mirë që iu mbështet Allahut, kur hyri në Meke vitin e çlirimit të saj mbi kokë mbante përkrenare. I Dërguari i Allahut na ka mësuar se si të bashkojmë mes përdorimit të shkaqeve dhe mbështetjes tek Allahu i Madhëruar. Kjo duket qartë në fjalën e tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) në hadithin që transmeton Muslimi me nr. 2664 ku thotë: **“Kujdesu për gjërat që të bëjnë dobi dhe kërko ndihmë tek Allahu.”** Ky hadith të cilin e transmeton Umeri bashkon mes përdorimit të shkaqeve dhe mbështetjes tek Allahu. Përdorimi i shkaqeve vihet re tek përmendja e zogut i cili në mëngjes del i uritur, pra me barkun

bosh del të kërkojë rizkun e tij dhe kthehet me barkun plot e i ngopur. Edhe pse njeriu i përdor shkaqet kjo nuk do të thotë që ai të mbështetet tek ato, përkundrazi ai duhet t'i mbështetet Allahut dhe të mos neglizhojë në përdorimin e shkaqeve duke pretenduar se në këtë mënyrë ai i mbështetet Allahut, sepse Allahu i ka paracaktuar shkaqet dhe rezultatet.

Ibn Rexhebi në librin **“Xhamiul Ulumi uel Hikem”** (2/496-497) thotë: **“Ky hadith është parim bazë në mbështetjen tek Allahu dhe se ajo është arsyeja më e madhe nëpërmejt së cilës arrihet rizku. Allahu i Madhëruar thotë: “Atij që i frikësohet Allahut, Ai do t'i gjejë rrugëdalje (nga çdo vështirësi) dhe do t'i japë rizk prej nga nuk e pret. Allahu i mjafton kujtdo që mbështetet tek Ai.”** (Suretu Talak, 2-3) **Më poshtë ai vijon duke thënë: “Mbështetja reale tek Allahu është singëriteti në mbështetjen e zemrës tek Allahu i Madhëruar, për të arritur interesat dhe për të larguar gjërat e dëmshme të cilat kanë të bëjnë me të gjitha problemet e kësaj bote. Në këtë mënyrë të gjitha problemet ia lë Atij duke realizuar besimin se nuk jep apo ndalon, nuk bën mirë apo keq dikush tjetër përpos Allahut të Madhëruar.”**

2 - Prej dobive të nxjerra nga ky hadith janë:

1 - Domosdoshmëria e të mbështeturit tek Allahu në arritjen e çdo kërkesë dhe largimin e çdo të keqe.

2 - Përdorimi i shkaqeve nuk bie ndesh me mbështetjen tek Allahu i Lartësuar.

50 - Të mos pushojë gjuha jote nga të përmendurit e Allahu.

Abdullah bin Busr (radijAllahu ‘anhu) thotë: “Erdhi një njeri tek Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe i tha atij: O i Dërguari i Allahut, vërtet dispozitat Islame janë të shumta, prandaj na trego diçka përmbledhëse të cilën mund ta bëjmë rregullisht? Profeti i tha: **“Të mos pushojë gjuha jote nga të përmendurit e Allahut.”** Këtë hadith e transmetoi Imam Ahmedi me këto fjalë, ndërsa Tirmidhiu, Ibn Maxheh dhe Ibn Hibani e transmetuan të përafërt me këtë kuptim. Tirmidhiu tha se hadithi është i mirë dhe garib.

1 - Pyetja që ky njeri i bëri Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) është një prej shembujve të shumtë, të cilët tregojnë se si shokët e Profetit e pyesnin atë në çështjet e fesë. E gjithë kjo pohon edhe më shumë vlerën dhe personalitetin e

tyre në kujdesjen që tregonin sahabët për çdo të mirë dhe garimin drejt tyre. Qëllimi i dispozitave që janë shtuar janë nafilet dhe ky sahab deshi të mësonte një rrugë prej rrugëve të hajrit, për të cilën do tregonte kujdes të madh me qëllim që të arrinte shpërblime nga Allahu i Madhëruar.

Përsa u përket farzeve, ato të gjitha janë të kërkuara dhe muslimani duhet të kapet fort pas tyre. I Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) iu përgjigj atij me vijueshmërinë në përmendjen e Allahut, dhe që gjuha e tij të ishte gjithmonë e angazhuar me përmendjen e Tij.

Dhikri është i përgjithshëm dhe i përvetshëm. Në dhikrin e përgjithshëm përfshihen; namazet, këndimi i Kuranit, marrja e mësimave, mësimdhënia, falënderimi ndaj Allahut dhe lavdërimi i Tij, pastrimi dhe shenjtërimi i Tij larg çdo gjëje që nuk ka lidhje me Të. Dhikri i përvetshëm përfshin; falënderimin e Allahut dhe lavdërimin e Tij, tesbihun, tehlilin, tekbirin dhe tahmidin. Ky lloj dhikri lidhet ngushtë me lutjet, prandaj dhe thuhet; dhikri dhe lutjet, ose; lutjet dhe dhikret. Kjo vepër është e lehtë për njeriun dhe gëzon shpërblime të mëdha tek Allahu.

Në dy librat e saktë të hadithit shënohet një hadith i cili është hadithi i fundit në sahihun e Buhariut, ku Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) thotë: **“Dy fjalë janë të dashura te Mëshiruesi, të lehta për t’u shqiptuar dhe të rënda në peshojë. Ato janë; subhanAllahi ue bihamdihi dhe subhanAllahil adhim.”**

2 - Prej dobive të nxjerra nga ky hadith janë:

1 - Kujdesi që tregonin sahabët për të pyetur rreth çështjeve që kishin të bënin me fenë e tyre.

2 - Vlera e përmendjes së Allahut të Madhëruar dhe vijueshmërisë në këtë vepër.

Ky ishte fundi i këtij shpjegimi. Falënderimet i perkasin vetëm Allahut, Zotit të botrave, paqja dhe nderimet e Allahut qofshin mbi robin dhe të Dërguarin e Tij Muhamedin, familjen dhe shokët e tij!